



# ISLAMOFOBIA

Duket se ky term është tepër i gjerë, ashtu siç ndodh shpesh me terme të cilët zgjerohen nga rrahjet farkëtuese të çekanëve përdorues, që godasin nga të gjitha anët. Si i tillë elementet që përfshihen në të nga grupe dhe këndvështrime të ndryshme e bëjnë shpesh atë një term të debatueshëm ndërmjet palëve përdoruese. Gjithsesi, i parë me syrin e një muslimani dhe nën një këndvështrim islam, islamofobinë do ta përkufizoja si një sjellje negative karshi Islamit dhe muslimanëve, që buron nga ndjesia e urrejtjes, neverisë apo alergjisë ndaj Islamit ose muslimanëve për shkaqe nga më të ndryshmet. Sipas këtij përkufizimi islamofobia është një fenomen i vjetër sa vetë Islami, shfaqje të tij të hershme Allahu na i ka përjetësuar në Librin e Tij në ajete të tilla si: **“Urrejtja shfaqet në gjithçka që del prej gojës së tyre, kurse ajo që fshihin në zemrën e tyre është edhe më e madhe.”** (3:118) dhe **“Ata vazhdimisht do të luftojnë kundër jush, që të mund t’ju kthejnë nga besimi juaj.”** (2:217)

Duket se qarqe të caktuara në Perëndim e në botë nuk mundet dot të jetojnë pa peshkuar dhe pa provokuar njëkohësisht armiq nga kultura të ndryshme nga ajo e tyre dhe duke i stigmatizuar ato si burimi i së keqes. Kjo nuk është diçka e re në historinë e Perëndimit, fobia ndaj mbulesës së femrës muslimane, referendumi kundra minareve të xhamive dhe ksenofobia ndaj prezencës në rritje të vetë muslimanëve në këtë pjesë të botës duket se në një farë mase të kujton rritjen e urrejtjes antisemite në Evropën e viteve 30'. Ashtu si atëherë qarqe fashiste edhe sot qarqe të djathta ekstremiste dhe konservatore duket se tentojnë që për arsye pragmatiste dhe politike ta shndërrojnë Islamit dhe muslimanët në kupën e zemërimit ku ata do të derdhin arsyet e krizave të tyre, që kjo botë po përjeton. Kjo tendencë duket se ka pasur rritje në veçanti pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, që për ta paska qenë pikërisht precedenti i munguar për të penalizuar një fe dhe kulturë të tërë. Në fakt duket se historikisht njerëz dhe kultura që tentojnë të jenë monolite, egocentrike dhe nuk pranojnë kontributin e të tjerëve priren që forcën e jetës dhe të zhvillimit ta gjejnë pikërisht tek armiqësia ndaj tjetrit dhe të projektojnë tek ai qoftë edhe një pjesë të fatkeqësive të tyre. Në mjaft raste duket se një mekanizëm i tillë ka funksionuar mjaft mirë.

Përkundrajt kësaj islamofobie të niveleve të larta, që përjeton sot perëndimi duket se edhe muslimanët shpesh reagojnë keq, së pari duke stigmatizuar të gjithë Perëndimin si islamofob dhe për rrjedhojë duke projektuar qoftë edhe një pjesë të fatkeqësive të tyre tek këta rivalë shekullorë. Natyrisht që kjo bie ndesh me mësimet islame, të cilat thonë se: **“Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj një pjesë të njerëzve për të qenë të padrejtë. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë.”**

Dhe **“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.”** Ndërsa parimet islame për asnjë moment nuk bëjnë fajtor për fatkeqësitë të tjerët, qofshin këta edhe armiq të më të ashpër: **“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet është si pasojë e asaj që keni bërë vetë.”** (30:42).

Dhe së dyti, tek një pjesë tjetër e muslimanëve islamofobia duket se ka prodhuar ndjenjën e të qenit inferior si dhe vetëpenalizimin e kulturës dhe fesë që ata mbartin, kjo për rrjedhojë është duke çuar drejt zhveshjes identitare islame të këtyre muslimanëve dhe drejt asimilimit në kulturat ofensive.

Duke e mbyllur do të shprehësja se islamofobia nuk është gjë tjetër vetëm se “një verë e vjetër në fuçi të re”, e cila duket se ka dehur keq shumë prej atyre që nuk jetojnë dot pa e pirë atë, ashtu siç edhe aroma e saj duket se ka trullësuar ca më keq akoma ata të cilët e kanë të ndaluar ta pinë atë. Le ta lusim Zotin që të mos shtohen të dehurit andej dhe kënde!

**Në emër të redaksisë: Justinian TOPULLI**

**AKTUALE**

**3-6** | LUFTA BOTËRORE KUNDËR HIXHABIT

**6-9** | ISLAMOFOBI APO KOKËFORTËSI?!

**10-12** | BLIC LAJME

**SFIDA**

**12-16** | GLOBALIZIMI DHE BASHKËSIA MUSLIMANE SHQIPTARE

**AKIDE**

**17-20** | XHELOZIA PËR FENË E ALLAHUT (1/2)

**DRITARE**

**21-22** | SEGREGACIONI I ARDHSHËM

**23-26** | “DËSHIROJ TË JETOJ VETËM PËR ZOTIN”

**FIKH**

**26-29** | XHAMITË, ATO VENDE TË DASHURA

**EKONOMI**

**30-32** | SHITBLERJA ME KËSTE

**FAMILJA**

**33-36** | FEMRA MUSLIMANE DHE PUSHIMET VERORE

**37-41** | KËMBËNGULJA NË VEPRA TË MIRA

**42-45** | FAMILJE QË U DOGJËN ME KËTË ZJARR

**45** | ZËRA TË MOHUAR

**TEFSIR**

**46-48** | A MUND TË KËNAQEN JEHUDITË DHE TË KRISHTERËT ME NE?

**HADITH**

**49-52** | JAM DALLUAR NGA PROFETËT E TJERË

**THESARE**

**53-54** | FIKU, NË KURAN DHE NË SHKENCË

**AVANCIMI PERSONAL**

**55-56** | PËRHAPNI HARENË DHE LAJMET E MIRA

**FETVA DHE KONSULTIME**

**57-60** | MISHI I BËN MUSLIMANËT AGRESIVË?!

**REDAKSIA**

*Kryeredaktor: Omer BERISHA*

*zv. kryeredaktorë: Agron TERZIQI dhe Justinian TOPULLI*

*Anëtarë të redaksisë:*

Ismail BARDHOSHI, Bledar HAXHIU, Lulzim SUSURI, Talha KURTISHI, Genc PLUMBI, Ali SHABANI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Llokman HOXHA, Rashit ZYLFIU dhe Hajrush MANI

*Bashkëpunëtorë: Ahmed KALAJA, Ekrem AVDIU dhe Enis RAMA*

*Redaktor gjuhësor: Roald HYSA*

*Redaktor teknik: Halil BERISHA*

*Ballina: Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio)*

*Shpërndarje dhe marketing: Sedat RAMADANI*

**Boton: Albislam**

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: [albislam@gmail.com](mailto:albislam@gmail.com)

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro  
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: [albislam.abonues@gmail.com](mailto:albislam.abonues@gmail.com)

ALBISLAM DOOËL

Xhironlogaria: 30000002770453

Komercijalna Banka A. D. - Skopje

Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit  
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në [www.albislam.com](http://www.albislam.com)

# LUFTA BOTËRORE KUNDËR HIXHABIT



Nëse Lufta e Parë Botërore nisi në Sarajevë në vitin 1914 dhe Lufta e Dytë Botërore në vitin 1939-1945 filloi me rastin e okupimit të Polonisë nga Gjermania, atëherë Lufta e Tretë Botërore kundër hixhabit (dhe Islamit në përgjithësi) nisi nga Tunizia, që shumë herët ka qenë pikënisje për çlirimet islame në shumë vende, dhe nga Turqia, e cila ka qenë kalaja e kalifatit islam

## ABDULBAKI HALIFE

Për një kohë të shkurtër pushteti tunizian i pktehet pjekurisë dhe po e kupton, se është duke luftuar shpirtin e njeriut, dëshirat dhe bindjet e tij, si dhe është duke shkëlur të drejtat e femrës, edhe pse këto i vesh me petkun e mirë dhe i quan “emancipim”. Emancipimi doemos duhet të vijë nga dëshira personale, hapa konkrete dhe kërkesa nga qarqe që synojnë ndihmesën për ndryshe do të quhej ndërhyrje në çështje personale dhe kjo ka të bëjë me individët, grupet, popujt madje edhe shtetet.

Historia na mëson se shumë krime kundër njerëzimit janë arsyetuar duke u dhënë një ngjyrë humane. Okupimi është quajtur “mbrojtje”, rrënimi “ndërtim”, vjedhja e resurseve natyrore të popujve është quajtur

“zhvillim”, rrëzimi i shteteve “liri” dhe këtë gjë vazhdimisht do ta hasni nëpër librat e historisë, madje edhe në ato shkolloret, siç është rasti në Tunizi, ku këto gënjeshtra paraqiten si “mbrojtje franceze”.

Ngjashëm me këtë u luftuan shumë vlera dhe të drejta të veçanta apo të përgjithshme, duke përdorur fjalë të shkëlqyera, edhe pse ato binin në kundërshtim me të drejtat njerëzore, madje shkelnin njerëzinë në emër të mbrojtjes së “revolucionit egjiptian, sirian, libian...”, apo “sistemeve”, apo ndoshta edhe në emër të “vazhdimit të shtetit siç ishte rasti me Algjerinë, Tunizinë, Marokun...”, apo në emër të “luftës kundër terrorizmit” dhe kështu Rusia arsyetoi krimet e saj në Kaukaz, sidomos në Çeçeni, njësoj është edhe rasti i bëmave kineze në Turkestanin lindor, hindusët në Kashmir, serbët në Ballkan, të cilët

masakruan muslimanët dhe vranë dhjetëramijëra, duke shtypur me tanke, duke gjuajtur me plumba dhe duke therur me thika nën parullën “lufta kundër terrorizmit islamik”.

#### **Lufta botërore kundër hixhabit nisi nga Tunizia:**

Nëse Lufta e Parë Botërore nisi në Sarajevë në vitin 1914 dhe Lufta e Dytë Botërore në vitin 1939-1945 filloi me rastin e okupimit të Polonisë nga Gjermania, atëherë Lufta e Tretë Botërore kundër hixhabit (dhe Islamit në përgjithësi) nisi nga Tunizia, që shumë herët ka qenë pikënisje për çlirimet islame në shumë vende, dhe nga Turqia, e cila ka qenë kalaja e kalifatit islam për më shumë se pesë shekuj. Aktualisht lufta kundër pamjes islame në këto dy vende e sidomos lufta kundër hixhabit është e pashoqe në krahasim me çdo vend tjetër me një dallim të madh mes këtyre dy vendeve e që është se luftën kundër pamjes islame në Turqi e udhëheq ushtria, e cila ende nuk është pastruar nga logjika e diktaturës ataturkiane dhe e sistemit të gjykatës, që llogaritet si një prapambetje për shek. XXI, ndërsa në Tunizi shohim se të gjitha instrumentet shtetërore marrin pjesë në këtë luftë. Pra, përfshihet ushtria, gjykata, arsimi e sidomos ai universitar, institucionet shëndetësore madje edhe sektori privat. Kjo luftë në Tunizi bëhet nën parullat “veshje sektariane”, madje edhe “veshje e importuar” për të ushtruar krimet më skandaloze kundër femrave të mbuluara nën parullën mashtruese “lufta kundër ekstremizmit”, që nënkupton se pamja islame konsiderohet ekstremizëm. Në disa vende kemi parë se ekstremist është konsideruar edhe ai që nuk pinte alkool dhe nuk hante mish derri.

Në këtë mënyrë pushtetet despotike ju japin kuptime që janë jashtë çdo logjike termeve dhe që bien ndesh me vlerat, të drejtat dhe liritë njerëzore, në mënyrë që të arsyetojnë diktaturën. Nuk është vetëm pushteti despotik që u jep termeve këto kuptime të

**“Në disa vende kemi parë se ekstremist është konsideruar edhe ai që nuk pinte alkool dhe nuk hante mish derri...”**

gabuar, por edhe disa laikë, të cilët frikësohen nga liria dhe kafazet e zëvendësojnë me disa kafaze të tjera, kafazet e tyre i vendosin përballë kafazeve të tjera dhe në kohën kur thërret që të gjykohen kafazet e të tjerëve ai vendos kafazet e veta përballë dhe i thërret të tjerët për t'i pranuar. Pra, ka disa njerëz që e vendosin veten në pozita për të vlerësuar të tjerët dhe ushtron një atësi të urryer për të arsyetuar shtypjen apo propozon ligje për të përcaktuar uniformat shkollore, siç është rasti nëpër disa shkolla.

#### **Propagandë e pareshtur kundër hixhabit:**

Kohëve të fundit është shtuar guximi i diskriminimit kundër femrave të mbuluara, siç ishte propaganda në një shkollë të mesme në bashkëpunim me organizatën “Liri dhe drejtësi” në të cilën administrata e kësaj shkolle zhvilloi kundër nxënësve të mbuluara një javë të tërë propagandë, detyrimin e tyre për të hequr hixhabet dhe ndalimin që të hyjnë nëpër klasa. Shumë nxënës u detyruan t'i thërrasin prindërit e tyre dhe si duket sistemi gjykues harroi se e ka “emancipuar femrën” dhe ajo nuk është e detyruar t'i bindet prindit të saj! Mirëpo nëse femra rebelohet dhe shkel vlerat, prindin e të tjerët, atëherë ajo nuk detyrohet t'i bindet askujt përveç sistemit gjykues që dominon, i cili e “emancipon” kur është me të dhe e diskriminon kur nuk është me të.

Rasti tjetër është me vajzën nga jugu, në krahinën Napol. Shoqata për mbrojtjen e femrave të mbuluara deklaroi: “Përgjegjësi i përgjithshëm në shkollën e mesme Mahmud Mesudij i bëri presion nxënësës Selma Abdul-

hamid dhe tentoi ta detyrojë atë të heqë hixhabin. Në të njëjtën ditë drejtori i kësaj shkolle i quajtur Salih Xhemeli e nxori nxënësen nga rreshti dhe e urdhëroi të heqë hixhabin, pastaj e dërgoi në zyrën e tij dhe e detyroi të nënshkruajë, se nuk do t'i mbulojë flokët e saj... vuajtjet e nxënëses nuk mbarojnë me kaq, duke u kthyer në shtëpi disa policë e morën vajzën dhe e dërguan në një qendër policore për të realizuar një bisedë hetimore në lidhje me praktikimin e saj të fesë dhe është pyetur për të vëllanë...”

Kjo organizatë thekson se organet shtetërore sjellje të këtilla nuk i nuk i kanë ndërprerë asnjëherë.

### Kontrolle shtetërore kundër hixhazit:

Në një raport tjetër nga “Organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e të burgosurve politikë” thuhet: “Më 3 Mars 2010 nxënësjë Takva Hasenij, viti i katërt, gjimnazi matematiko-naturor, i ekspozohet një rasti të shëmtuar nga ana e drejtorit të shkollës. Nxënësjë tregon: “Isha duke shkuar në shkollë në ora 8 të mëngjesit dhe në rrugë më ndaloi policia, dhe më urdhëroi të hiqja hixhabin. Pasi refuzova me forcë më detyroi të shkojmë te drejtori i shkollës Murad Musa dhe më goditi me duar e këmbë në fytyrën dhe trupin tim, dhe pasi arritëm në zyrën e drejtorit, rrobat më ishin shqyer, më rrëzoi për tokë dhe më thoshte fjalë të shëmtuara, duke sharë Allahun dhe duke më kërcënuar se do më çnjerëzonin. U alivanosa dhe s’mbaj

**“Pasi arritëm në zyrën e drejtorit, rrobat më ishin shqyer, më rrëzoi për tokë dhe më thoshte fjalë të shëmtuara, duke sharë Allahun dhe duke më kërcënuar se do më çnjerëzonin...”**

mend asgjë tjetër derisa më kthjellën më një gotë uji në fytyrë. E gjithë kjo ndodhi përpara një laboranti të shkollës dhe sekretarit.”

Këto shkolla në vend që të jenë qendra edukative janë shndërruar në vende dënimi, shkeljes së të drejtave të njeriut dhe lirisë së femrës. Këto raste inkurajojnë shtetet perëndimore dhe organizatat fundamentaliste, që të arsyetojnë diskriminimin e femrave të mbuluara. Një inkurajim ishte deklarata e ministrit të brendshëm të Italisë R. Maroni, i cili deklaroi se parlamenti i shtetit të tij po shikon mundësinë e ndalimit të ferexhesë, duke ndjekur shembullin e Francës dhe duke e konsideruar një gjë të tillë si rrezik për Italinë.

Hixhabi dhe ferexheja konsiderohen si kërcënim për kulturën perëndimore, meqë në Tunizi konsiderohet si “veshje sektariane” e që në fakt fshihet ajo që dëshiron Evropën.

### Tunizia mostër botërore për diskriminimin e femrave të mbuluara:

Franca dhe disa shtete evropiane gurmajnë për arsytetime për të ndaluar pamjet islame dhe nuk gjetën ndonjë argument më të fortë, se sa praktikën e pushtetit tunizian. Kjo praktikë bëri që komisioni parlamentar francez të kërkojë me ngulm nga qeveria të ndalojë ferexhenë, ashtu siç ia ndërtoi rrugën presidentit francez Sarkozy në qershor të vitit 2009 të thotë: “Ferexheja nuk është e mirëseardhur në këtë vend.”

Nëse në Perëndim megjithatë ekzistojnë njerëz me të vërtetë të lirë, madje edhe brenda partisë së Sarkozisë, popullit francez, UNESCO-s etj., të cilët e kundërshtojnë ndalimin e ferexhesë e jo hixhazit, atëherë Tunizia sot konsiderohet një xhungël nëpër të cilën shëtisin bishat më të rrezikshme së bashku me njerëz, të cilët nuk kanë votë të lirë dhe zëri i tyre nuk dëgjohet. ■

*nga arabishtja: Agim BEKIRI*

# ISLAMOFABI APO KOKËFORTËSI?!

## A MUND TË PRETENDOJMË PËR ISLAMOFABI NË NJË VEND MUSLIMAN?

Gjuha e përdorur nga gazetarët në përcjelljen e lajmit kur ka qenë fjala për të realizuar tituj bombastikë dhe tekste po aq të forta, ka qenë ajo e trendit global anti-islam. Pra, mund të themi hapur dhe pa doreza se ka qenë një gjuhë shumë e ashpër dhe agresive.

SHKRUAN: ROALD A. HYSA

**T**i përdorësh gjërat dhe termet pa i ditur kuptimin dhe përdorimin e tyre është injorancë. Islamofobi është një nga termet më të fundit i përcaktuar nga Perëndimi kryesisht pas 11 shtatorit 2001 kundrejt Islamit apo personave që mund të kenë lidhje me Islam. Ky term dhe fenomen ka një histori të vetën në Perëndim, por që kohët e fundit është shfaqur edhe në jetën tonë publike. Gjithashtu mund të themi se ky fenomen u sponsorizua gjerësisht nga ana mediatike për të arritur në praktikë disa synime. Kështu ka pasur përpjekje që këtu në Shqipëri të gjejë përdorim dhe funksionim ky term dhe fenomeni që e pason atë. Por ne nuk mund të jemi dakord me aplikimin e verbër të këtij termi, cilado qofshin arsyet për ta bërë këtë, politike apo personale. Një nga arsyet kryesore të mospranimit tonë është vetëm një fakt i thjeshtë, popullsia e vendit tonë është me shumicë muslimane, ndërsa elementet e tjera do të mundohem t'i shpjegoj në vijim.

### Termi ISLAMOFABI

Ky term përbëhet nga dy fjalë: Islam dhe Fobi. Pak a shumë të gjithë që jemi të pranishëm këtu e dimë në vija të përgjithshme, se çfarë është Islami, prandaj edhe nuk do të fokusohemi në këtë drejtim.

Kjo edhe pse do të duhej shumë kohë për të gjetur një shpjegim të shkurtër dhe të saktë për ta karakterizuar Islam. Kështu ne do ta drejtojmë vëmendjen tek FOBIA, pra, në pjesën e dytë. Pjesa e dytë e këtij termi është edhe përcaktuese ndaj pjesës së parë. Fobi do të thotë frikë e fortë ose mosdashje: mosdashje shumë e fortë apo frikë



irracionale kundrejt diçkaje, si fjala vjen merimangave apo hapësirave të mbyllura. Pra, kemi të bëjmë me një frikë irracionale dhe të vazhdueshme kundrejt një objekti të specifikuar, siç është situata apo aktiviteti.

Na duhet ta kemi parasysh anën irracionale si përbërëse e rëndësishme të këtij termi, sepse do të na vlejë shumë për shpjegimin dhe kuptimin e situatave të mëposhtme, për të bërë dallimin ndërmjet armiqësisë, kokëfortësisë apo mosndryshimit të pozicionit. Pra, ata që janë islamofobë kanë një frikë irracionale kundrejt Islamit dhe muslimanëve dhe njëkohësisht mundohen vazhdimisht ta përhapin e ta mbjellin këtë fenomen në shoqëritë e tyre përkatëse, ku edhe ata jetojnë. Por trendi i globalizimit të gjithçkaje e bën këtë mesazh shumë të ndjeshëm në Perëndim, i cili po e përdor edhe për efektet frenuese të tij. Në thelb fenomeni islamofobi nuk është thjesht një sulm propagandistik, por gjithashtu është përdorur edhe si frenues kundrejt ekspansionit të Islamit. Një gjë të tillë deri në vitet 1990 e kishin bërë dy blloqet më të rëndësishme politike: ai perëndimor

kapitalist me atë lindor komunist, ku me protagonizmin e tyre dominonin në skenën botërore, duke bërë ndarjen në kampet e së mirës dhe të së keqes. Më pas Islamofobia në Perëndim është nxitur në forma të ndryshme. Një gjest tejet i ulët dhe krejt i pavend ishte ai i gazetës daneze **“Jylland Posten”** dhe i botimit të karikaturave për Profetin, i cili zgjoi zemërimin e të gjithë muslimanëve në mbarë botën. Mund të përmendim këtu edhe shumë ngjarje apo fenomene të tjera mediatike, të cilat mund të shihen si kontribuuese në rritjen dhe kultivimin e Islamofobisë në të gjithë Perëndimin, nga pikëpamja mediatike. Si shkak i kësaj fushate globale antiislame kanë rrjedhur edhe shumë keqkonceptime mbi Islamin, të cilat praktikisht janë synuar me kohë dhe synohen akoma, ku mund të numërojmë këtu disa prej tyre: 1. Muslimanët janë të dhunshëm, terroristë, ekstremistë, 2. në vendet islame gruaja shtypet, 3. Muslimanët adhurojnë një zot të ndryshëm nga ai i tyre 4. Islami është përhapur me dhunë dhe nuk i toleron fetë e tjera, 5. Të gjithë muslimanët janë arabë, 6. “Nation of Islam” është një grup musliman,





7. Muslimanët martohen me 4 gra, 8. Muslimanët janë njerëz të pazhvilluar e barbarë, 9. Muhamedi është themelues i Islamit dhe Muslimanët e adhurojnë atë dhe 10. Muslimanët nuk e besojnë Jezusin apo ndonjë profet tjetër.

### **A mund të pretendojmë për Islamofobi në një vend musliman?**

Siç e përmenda edhe më sipër: Një nga arsyt kryesore të mospranimit tonë është vetëm një fakt i thjeshtë, popullsia e vendit tonë është me shumicë muslimane, por në këtë pikë tashmë na duhet të ndalemi më shumë dhe ta shtjellojmë seriozisht. Kjo për arsye se shumë fakte dhe ngjarje antiislame të shfaqura gjatë rrjedhës së historisë nuk mund të merren dhe të na shërbejnë si ISLAMOFOBI. Ato mund të merren si kundërshtim i hapur, kokëfortësi, opozitë, injorancë, mospëlqim dhe çdolloj forme tjetër të hapur apo të fshehtë të këtyre epiteteve që përmendëm. Kështu si fillim duhet të hedhim një herë shikimin të shkurtër në të shkuarën tonë e më pas në të tashmen.

Në fillim të shek. XVI Osmanët i kishin futur nën sundimin e tyre pjesën më të madhe të trojeve shqiptare dhe sundimi i tyre do të merrte fund në dekadën e parë të shek. XX. Për më tepër se katër shekuj sundimi osman pati aq kohë sa edhe të ndikonte në jetën e shqiptarëve. Pa hyrë shumë në hollësi mund të vërehen ndikimet osmane e kjo jo vetëm te shqiptarët, por edhe tek fqinjët tanë sllavë, maqedonas, bullgarë e grekë. Në zgjerimin e kësaj teme do të shërbente libri i autores bullgare **Maria Todorova** "Ballkani imagjinar". Ky ndikim nuk vërehet vetëm tek muslimanët, por edhe tek të krishterët katolikë e ortodoksë, të cilët meqenëse jetuan në fqinjësi të mirë me muslimanët huazuan shumë nga zakonet e tyre. Këto zakone

vërehen në veshje dhe në fjalorin e përditshëm, ku tashmë numërohen mbi 4500 fjalë të huazuara nëpërmjet osmanishtes në gjuhën shqipe.

Mbiemra të tillë si Haxhijani, Haxhillazi, Veqilharxhi etj., janë të zakonshëm në pjesën ortodokse të popullsisë në jug të vendit tonë. Madje në shëmbëllim me haxhilerët muslimanë, edhe ortodoksët vetë kur vizitonin vendet e shenjta në Jerusalem i quanin njerëzit e tyre haxhinj. Po ashtu ngjashmëri vërehen edhe në gatime etj. Një fenomen tejet interesant mbi ndikimin osman në veshje janë veshjet e grave katolike të Shkodrës, të cilat nuk kanë asnjë ndryshim nga ato të një gruaje muslimane të po këtij qyteti të mbarsur me tradita qytetare muslimane. Fjalë dhe frazeologji të përdorimit të përditshëm të fjalorit musliman kanë zënë vend në pjesën e krishtere të popullsisë, si fjala vjen: bismillah, kismet zotit, inshalla, allah-allah etj.

Organizimi qytetar dhe i qytetit vetë konfirmojnë ndikimin osman në strukturën e tij sociale, shpirtërore, arkitektonike dhe urbane. Periudha e viteve 1930-1990 do të ndikohej ndjeshëm nga tendencat e ideologjisë mbizotëruese shtetërore, të cilat në kohën e viteve 1930-1945 do të përlligjej me modernizimin e jetës qytetare, por pa e prekur në thelbin e vet atë fetare-shpirtërore. Në vitet 1945-1990 do të mbizotëronte lufta ideologjike kundër fesë në përgjithësi pa bërë dallim për ndonjërin. Xhamitë u shkatërruan dhe ushtrimi i fesë islame dhe i feve të tjera u ndalua me ligje të posaçme. Në mbyllje të këtij vështrimi të shpejtë mund të themi, se nuk mund të mbështetet në trullin e së shkuarës fenomeni islamofobi. Gjithashtu gjatë gjithë kësaj periudhe kohore që përmendëm një gjë pohohet nga të gjithë studiuesit, fenomeni i respektimit dhe i jetesës në



## “Fjalë dhe frazeologji të përdorimit të përditshëm të fjalorit musliman kanë zënë vend në pjesën e krishtere të popullsisë, si fjala vjen: bismilah, kismet zotit, inshalla, allah-allah etj... ”

harmoni të të gjitha palëve fetare dhe sekteve të ndryshme.

### Tranzicioni post-demokratik

Gjatë periudhës së viteve 1990 kur për herë të parë rihapet një xhami në Shkodër pas një errësire totale dhe pason me rihapjen e xhamive të Et'hem beut dhe Kokonozit në muajt e parë të vitit 1991 në kryeqytet, e deri në fillim të vitit 1998 pason një periudhë ringjallje e Islamit. Fillimisht kemi sulmet e **Kastriot Myftarajt**, i cili ka shkruar dy libra me frymë tejet anti-islame dhe më pas ka marrë si kundërpërgjigje artikuj, si dhe një libër nga **Abdi Baleta**. Pas vitit 1998 fillojnë edhe sulmet e para në shtypin vendas me tituj bombastikë të orkestruar për të fituar edhe terren mediatik, edhe sa më tepër shitje. Ndërkaq vërehet nga titujt dhe nga brendia e shkrimeve dhe e reportazheve, se nuk kemi të bëjmë me injorancë, por me shkrime të përgatitura qëllimisht për të sulmuar. Le të shqyrtojmë pak mënyrën e ligjërimit gazetaresk të autorëve të disa shkrimeve. Gjuha e përdorur nga gazetarët në përcjelljen e lajmit kur ka qenë fjala për të realizuar tituj bombastikë dhe tekste po aq të forta, ka qenë ajo e trendit global anti-islam. Pra, mund të themi hapur dhe pa

doreza se ka qenë një gjuhë shumë e ashpër dhe agresive. Me rastin e **Mirela Bogdanit** nuk mund të përgjithësojmë të gjithë çështjen. Ndërsa nuk mund ta quajmë islamofobi atë të Kastriot Myftarajt, i cili së fundmi në faqet e një të përditshmeje shpalos një program të tërë për deislamizimin e Kosovës. Vetëm një i paditur mund të flasë për islamofobi.

Kështu nuk mund të themi se kemi “Islamofobi” në Shqipëri, sepse pjesa më e madhe e medieve dhe e gazetarëve të paktën kanë një njohje të përciptë të muslimanit dhe deri tashti nuk kanë shfaqur qëndrime që mund t'i interpretojmë si një frikë irracionale. Ata duan të kundërshtojnë kur japin opinionet e tyre dhe ne nuk mund të presim dashamirësi nga njerëz apo organe mediatike të tilla. Po ashtu mund të kujtojmë vizitat e politikanëve më të lartë shqiptarë me rastin e dy bajrameve dhe është vërejtur qartë, se ata para takimit me krerët e KMSH-së kanë lexuar diçka për Islamit dhe kur kanë dalë jashtë janë shprehur për mediet me fjali të tilla që tregonin se kanë marrë njohuri racionale mbi Islamit. Kështu nuk mund të thuash që mbizotëron mosnjohja për Islamit dhe për pasojë të mund të vijë edhe një frikë irracionale, islamofobi. Kjo ndodh rëndom në Perëndimin e Krishterë, ku terreni, kultura, brumi dhe njerëzit janë të mburitur me mësimet e krishtera apo të çdolloj feje tjetër. Islamofobia nuk është problemi jonë, madje do të na shtynte në ndonjë qorrsoak përveç ndonjë përfitimi monetar momental, që mund të kenë njerëzit. Ndërsa neve si muslimanë duhet të priremi drejt të vërtetës dhe të saktës, ashtu si na porosisin mësimet kuranore dhe të Profetit Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të. ■

## NDËRTOHET NJË XHAMI E MADHE NË MARSEJË

Në qytetin e dytë më të madh të Francës, Marsejë, ku jetojnë 250 000 muslimanë do të ndërtohet xhamia më e madhe e vendit. Muslimanët e këtij qyteti deri tani i kanë kryer ritet e tyre fetare nëpër vende të papërshtatshme, si shtëpi, bodrume ndërtesash, garazhe apo vende të tjera të marra me qira.

Xhamia e Madhe e Marsejës do të ketë një hapësirë të mjaftueshme për faljen e namazeve për 7000 njerëz. Në kompleksin e xhamisë do të përfshihet edhe një shkollë e Kuranit, biblioteka, restoranti dhe një dhomë për çaj. Minarja e xhamisë do të arrijë një lartësi prej 25 metrash. Pritet që Xhamia e Madhe e Marsejës të hapet në vitin 2012. Kostoja e ndërtimit të xhamisë do të jetë rreth 22 milionë euro dhe ajo do të financohet nga komuna e qytetit të Marsejës. Leja për ndërtimin e xhamisë ishte kërkuar disa herë gjatë 60 viteve të fundit, ndërsa në vitin 2001 kryetari i komunës së Marsejës më në fund e lëshoi këtë leje.

## AUSTRIAKËT LARGOHEN NGA KISHA

Në Austri në çerekun e parë të këtij viti u regjistruan 42 % më shumë tërheqje nga anëtarësimi nga Kisha Katolike, që do të thotë se rreth 30.000 të krishterë janë çregjistruar deri tani. Për vitin 2010 pritet që numri i atyre që do të tërhiqen nga Kisha do të arrijë në 80.000. Rritjen më të madhe të tërheqjes e ka shënuar rajoni i Vorarlbergut me 1800 çregjistrime. Në vitin 2008 në këtë krahinë ishin çregjistruar gjithsej 1668 persona. Në vitet e kaluara numri i atyre që janë larguar nga Kisha Katolike sillet nga

10.000 deri në 20.000 për vit. Tërheqjet e shumta pritet të sjellin edhe probleme serioze financiare për Kishën Katolike në Austri.

## SHKËNDIJA ELEKTRIKE DJEG XHAMINË E MESMYSELIMIT

Është djegur plotësisht xhamia në fshatin Mesmyselim në komunën Postribë në Shkodër. Sipas banorëve të këtij fshati, xhamia ka qenë si objekt dhe pas rilejimit të ushtrimit të riteve fetare në fillim të viteve '90 ajo është rikonstruktuar me kontributin e banorëve të gjithë fshatit, ndërsa minarja është ndërtuar e re nga dy banorë të këtij fshati në gusht të vitit 2002. Xhamia ka qenë ndër më të bukurat në këtë zonë. Policia ka deklaruar fillimisht se zjarri mund të jetë shkaktuar nga goditja e rrufesë, pasi në zonë ka pasur shi e vetëtima, por kjo është hedhur poshtë nga fakti se minarja nuk është djegur dhe ka pasur rrufepritës. Duke parë xhaminë e djegur banorët nuk i kanë përmbajtur lotët.

## DE MAZIERE: "ISLAMI, PJESË E PANDARË E SHOQËRISË GJERMANE"

Në një konferencë për media në Berlin, ministri i brendshëm i Gjermanisë deklaroi se Feja Islame tashmë është pjesë e pandarë e shoqërisë gjermane. Mediet gjermane njoftuan se Thomas De Maziere në këtë konferencë për shtyp, e cila u organizua pas takimit të tij me krerët e qendrave islame të këtij vendi, të ketë thënë se sot Feja Islame është shndërruar në një realitet në shoqërinë tonë dhe qytetarët muslimanë nuk i takojnë më vetëm shtresave të punëtorëve dhe

studentëve. De Maziere takimin me krerët e shoqërive islame e konsideroi konstruktiv dhe të dobishëm dhe shtoi: Qeveria gjermane po shqyrton disa kërkesa të muslimanëve, siç janë themelimi i një Instituti për trajnimin e imamëve të xhamive dhe përforcimin e unitetit midis jo-muslimanëve dhe muslimanëve, që jetojnë në Gjermani.

## XHAMI NË VENDIN KU U RRËZUAN KULLAT BINJAKE

Nju Jorku do të ndryshojë pamjen, meqë është ofruar një plan për t'u ndërtuar një xhami në të njëjtin vend, ku u rrëzuan kullat binjake. Kjo ka shkaktuar reagime te banorët e Nju Jorkut. Sipas planit, xhamia do të jetë në një ndërtesë 13 katëshe, e cila do të jetë një qendër islame, ku do të ketë banjot dhe terrene sportive. Është interesante se ndërtimi duhet të fillojë me 11 shtator vitin e ardhshëm. Pas rrëzimit të kullave "Ground Zero" është vendi që vizitohet nga shumë njerëz. Drejtoresha e organizatës "Stop islamizimit të Amerikës", Pamela Geler ka paralajmëruar protesta kundër ndërtimit të kësaj qendre.

## FRANCË: KABINETI MIRATON NDALIMIN E FEREXHES

Kabineti francez ka përgatitur "Ligjin për ndalimin e plotë të mbulimit të fytyrës me ferexhe", që shihet si hapi i parë i një ndalesë të tillë në vendet publike. Vendimi vjen një muaj pasi ligjvënësit në Belgjikë u bënë të parët në Evropë, që votuan për një ndalesë të ngjashme. Ligji kundër rrobave që mbulojnë trupin dhe fytyrën, të njohura si burka apo nikab, thotë se "askush nuk mund të mbajë

veshje që e mbulojnë fytyrën në vende publike", përfshirë shërbime publike dhe në rrugë. Duke iu drejtuar kabinetit francez, presidenti Nikolas Sarkozy tha se një ndalesë e tillë është e domosdoshme për të ruajtur dinjitetin e grave dhe për të riafirmuar parimet republikane të Francës. Por legjislacioni i miratuar nga kabineti është kundërthënë. Ligji parasheh dënime prej 150 eurosh për shkelësit e tij dhe mundësisht ndjekje të orëve të qytetarisë. Çdokush që do të detyrojë ndonjë grua të mbajë një vello të tillë mund të dënohet deri me një vit burg dhe 15 mijë euro gjobë. Vlerësohet se Franca ka 5 milionë muslimanë, më së shumti në Evropë. Sipas Ministrisë së Brendshme, rreth 1.900 gra mysli mane mbajnë ferexhe që mbulon fytyrën, por jo sytë. Legjislacione të ngjashme po shqyrtohen edhe në Holandë, Austri dhe Danimarkë. Prandaj, si duket do të shfaqet i kotë pretendimi për ekzistimin e demokracisë në Evropë.

## EZANI NË SHESHIN E SHKUPIT

Muajin e kaluar, më 13 Maj u thirr ezani nga qendra e Shkupit për t'u treguar të gjithëve, se aty ka qenë Burmali xhamia dhe se ajo duhet të rindërtohet mbi themelet e saj. Në manifestimin kulturor "Dëshmi për Burmalinë" morën pjesë qindra qytetarë, të cilët kërkuan edhe një herë nga Qeveria që t'i ndajë 300 metra katrorë tokë për të ndërtuar këtë objekt. "Jemi këtu që të dëshmojmë për dashurinë tonë që kemi ndaj këtij objekti dhe për dëshirën dhe vullnetin për ngritjen e sërishme të këtij nishani të bukurisë së qytetit të Shkupit. E vetmja komponente e protestës, që përmban manifestimi i sotshëm është kërkesa jonë, e cila është që të ndahet trualli për ndërtimin e Burmali xhamisë me kushtet dhe çmimet e njëjta ashtu siç iu nda

kishës ortodokse”,- tha Ramadan Ramadani, nga Këshilli Koordinativ për rindërtimin e Burmalit xhamisë, këshill ky që përbëhet nga 76 shoqata joqeveritare. Ata besojnë se gjithë këto tentativa, të cilat janë me organizim joqeveritar ndihmojnë në mos-politizimin e situatës dhe mostendosjen e marrëdhënieve ndërtnike e as marrëdhënieve ndërkonfesionale. Manifestimi vazhdoi me këndimin e ilahieve në disa gjuhë, si dhe me leximin e disa pjesëve për historinë e Shkupit dhe Burmalisë, ndërsa u mbyll me thirrjen e ezanit dhe me një lutje nga të gjithë të pranishmit. Vlen të përmendet se Bashkësia Fetare Islam në RM e bojkotoi këtë manifestim, thërriti besimtarët ta bojkotojnë dhe publikoi komente të pahijshme ndaj këtij tubimi.

## ULJE NË PAGË PËR VRASJEN E IRAKIANËVE

Një gjykatë ushtarake amerikane u mjaftua me një ulje të pjesshme nga paga e një oficeri në ushtrinë amerikane si masë ndëshkimi për vrasjen e dy civilëve irakianë. Ky është vendimi gjyqësor më i fundit, në lidhje me ushtarët që kanë kryer krime në Irak. Këto vendime kanë çuar në shumë raste në reagime të ndryshme, për shkak të trajtimit të përciptë nga ana e gjyqësorit amerikan të krimeve të kryera ndaj irakianëve. Gjykata dënoi kapitenin Karl Bjork për “parregullsi” dhe e dënoi me uljen e 1/3 të pagës për një vit. Zyrtarët ushtarakë thanë se kapiteni në fjalë u gjend fajtor për akuzat e ngritura kundër tij për vrasjen me paramendim të dy të burgosurve irakianë dhe rrezikimin e njësisë së tij luftarake për shkak të neglizhencës së tij.

Përgatiti: Hajrush MANI

# GLOBALIZIMI DHE BASHKËSIA MUSLIMANE SHQIPTARE

unë mendoj se muslimanët në vendet tona kanë nevojë për një organizëm, që do të duhej të luante rolin e zëdhënësit të muslimanëve. Bashkësitë islame janë më të thirrurat ta bëjnë një gjë të tillë, ndërsa realiteti është dëshmitari më i mirë se sa janë në gjendje për ta bërë një gjë të tillë si duhet.



**SHKRUAN: EKREM AVDIU**

Me bashkësi muslimane nënkuptohet këtu i gjithë elementi etnik shqiptar, si dhe ai gjeografik që ka lidhje me Fenë Islame në aspektin e përkatësisë statistike apo praktike. Kjo lidhje e individëve apo e bashkësive përcakton më vonë edhe qasjen krahasuese dhe studimore. Me elementin gjeografik kam parasysh vendin ku jetojnë ata shqiptarë muslimanë e që do të bëjmë një ndarje duale: trojet amtare dhe diaspora. Fillimisht më duhet të them se për të ndriçuar këtë realitet duhet të bëjmë patjetër një ndarje të muslimanëve shqiptarë në:

praktikues të mësimëve islame dhe

Muslimanë të statistikave (d.m.th., jo praktikues aktivë).

Pastaj në mënyrë të veçantë do të flasim për institucionet islame, të cilët në një mënyrë apo tjetër administrojnë jetën fetare



të shqiptarëve muslimanë kudo qofshin.

Trendët globaliste kur filluan të zhvillohen i gjetën shqiptarët të sapodalë nga sistemet social-komuniste, sepse ata tanimë jetonin në shtete që kishin qenë të këtilla, apo që u formuan nga shkatërrimi i federatave të tilla. Ato shtete janë: Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe së fundi Kosova. Këtu kemi edhe Greqinë në të cilën jeton një komunitet shqiptar musliman me të drejta të përkufizuara apo të cinguara, dhe për këtë gjë edhe nuk do të bëjmë ndonjë qasje të veçantë.

Shoqëritë postkomuniste në masë të madhe e mirëpritën lirim nga prangat e sistemeve në të cilat jetonin, por kjo nuk do të thotë se ishin të përgatitur për t'u përballur me situata, të cilat imponohen natyrshëm në periudhat transitore. Kësisoj vërejmë se ndryshimet, edhe pse i kanë dëshiruar të gjithë, pakkush ka ditur t'i menaxhojë ato në mënyrën më produktive dhe më të dobishme. Në të shumtën e rasteve ato i janë nënshtruar dëshirave dhe ëndjeve të individëve e në raste të tjera është marrë ajo që ka qenë më e kapshme nga ajo që ka ofruar "tregu". Situata të këtilla kanë krijuar iluzione dhe mite të njerëzimit, sepse në të shumtën e rasteve ata i janë nënshtruar stihisë, duke mos pasur vizion lidhur me atë se çfarë dëshirojnë dhe nga duan të shkojnë. Kjo i bëri ata që realitetin ta jetojnë duke parë një ëndërr të paqartë, edhe pse këtë e bënin me sy hapur.

Globalizimi, pavarësisht gjendjes së shoqërive për të cilat flasim, e ka bërë punën e vet dhe ka lënë ndikimin e vet në të tri fushat kryesore të ndikimit të tij: rrafshin ekonomik, kulturor dhe mediatic.

Ekonomikisht, një pjesë e vogël e këtyre shoqërive janë orvatur të kapen pas trendëve globalizuese, duke u munduar që të gjinden sadopak dhe të arrijnë sukses në realizimin e atyre standardeve, që i imponon globalizimi. Pjesa dërrmuese e shoqërisë nuk kanë

## “Ajo që na pikëllon është se të rinjtë tanë në veçanti arrijtjet e shkencës në fushën e teknologjisë informative i shohin si një mundësi për të vrarë kohën, për ta tepruar në argëtim, për të gjetur ndonjë viktimë për orgjitë e shfrenuara ...”

depërtuar suksesshëm në këtë drejtim, jo pse nuk kanë dashur por e kaluara, në të shumtën e rasteve ka qenë pengesa kryesore duke qenë se nuk kanë trashëguar bazë ekonomike e as njohuri e përvojë të mjaftueshme për t'u orientuar në tregjet globale. Kjo gjithashtu ka ndikuar që si pasojë e standardit të ulët ekonomik dhe pasigurisë politike që dominonin në këto vende në zhvillim të rriten ambiciet e njerëzve për të emigruar në vendet e zhvilluara, kryesisht ato evropiane.

Kjo gjendje si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë politik i ka përcjellë këto shoqëri, që prej gati njëzet vitesh, duke mos mohuar trendët, edhe pse shumë të ngadalshëm të përmirësimit. Në vijim do të përmendim disa nga sfidat me të cilat ballafaqohet bashkësia muslimane shqiptare gjithandej, sfida këto që në të shumtën e rasteve janë shqetësime.

### **Të drejtat e njeriut në shoqëritë ku jetojnë muslimanët shqiptarë**

Të drejtat e njeriut janë parullat që brohoriten më tepër dhe trumbetohen gjerësisht sot. Ato janë bërë mekanizmi kryesor për të matur nivelin e demokratizimit të një shoqërie, së paku teorikisht. Bazuar në njohuritë historike mendoj se në kohën kur flitet më tepër për

këto të drejta, ato njëkohësisht shkelen dhe nëpërkëmben më tepër.

Në shoqëritë ku jetojnë shqiptarët muslimanë me dallime fare të vogla që gati nuk vërehen mosrespektimi i këtyre të drejtave është pjesë e përditshmërisë. Kjo ndodh aq shumë, sa që shumica e njerëzve gati edhe nuk dinë se si është të jetohet në shoqëri ku njeriu ka dinjitetin e vet dhe të drejtat e tij janë të paprekshme. Këtu, derisa flitet për muslimanët nuk mund të mos veçoj të drejtën elementare të njeriut, të drejtën e lirisë së besimit. Në shoqëritë tona kjo e drejtë “respektohet” vetëm nëse ajo nuk i tejkalon kufijtë e bindjeve personale, d.m.th. nëse dëshiron individi ka drejtë të besojë në çfarë të dojë, por në momentin që bindja e tij fillon të manifestohet në praktikë, aty urgjentisht paraqiten kufizimet.

Bindja ime është se në këtë fushë nuk janë respektuar trendët globale, në të cilat bota e zhvilluar dhe demokratike, me gjithë vërejtjet dhe jopërsosmërinë e saj ka ecur shumë përpara. Ne edhe pse në vendet tona jetojmë si shumicë dhe udhëhiqemi nga njerëz me përkatësi (statistike apo deklarative) muslimane, megjithatë e ndiejmë veten me të drejta shumë më të cinguara, se sa shumë komunitete muslimane pakicë që jetojnë në vende të zhvilluara. Shkurtimisht mungesa e respektimit të këtyre të drejtave në shoqëritë tona manifestohet me:

Mungesën e hapësirës për të shprehur mendimin e lirë fetar,

Mungesën e hapësirës për të kryer ritet dhe detyrimet fetare pa e prishur rendin shoqëror,

Cungimin e të drejtës për t'u shkolluar të femrave muslimane me veshjet e zgjedhura prej saj, sipas bindjeve të veta (mbulesa islame),

Mungesa e përkujdesjes institucionale për bashkësitë islame dhe objektet e saj (xhamitë,

medresetë etj...),

Mungesa e mbrojtjes institucionale të dinjitetit të muslimanëve (individë apo bashkësi) nga ofendimet, sharjet, akuzat e pabaza dhe etiketimet që u bëhen atyre, sidomos nga disa media dhe njerëz të papërgjegjshëm,

Moslejimi i futjes së lëndës së edukatës fetare në shkollat publike.

Këta janë vetëm disa shembuj, që dëshmojnë për humbjen e ekuilibrit në proceset integruese për të cilat flitet shumë në shoqëritë tona, ndërsa praktikisht qasja është selektive dhe e bazuar në motive tendencioze dhe nënçmuese.

### **Teknologjia e komunikimit, përparësitë dhe përgjegjësitë**

Arritjet në fushën e teknologjisë, e sidomos ato në atë të komunikimit e kanë shndërruar të tërë botën në një fshat shumë të vogël në të cilin të gjithë qysh herët në mëngjes kanë mundësinë të informohen për të gjitha të rejat. Kjo u ka dhuruar njerëzve mundësinë që të njihen mes tyre, dhe të afrohen në kuptimin pozitiv, dhe me këtë janë thyer shumë kufij e barrkada, të cilat kanë ekzistuar për një kohë të gjatë mes njerëzve.

Përparësi tjetër e këtyre arritjeve është se komunikimi i lehtë dhe efikas është bërë paradigme për shumë arritje të tjera në fushën e shkencës, kulturës, ekonomisë, tregtisë, e pse jo edhe në atë të moralit, fesë etj. Një fjalë e mirë e thënë apo e shkruar në Lindje, në moment dëgjohet në Perëndim dhe anasjelltas, pra, pa u vonuar fare njerëzit kanë mundësinë të përfitojnë prej saj. Interneti në ditët e sotme ka zëvendësuar udhëtimet e shumta, të mundimshme dhe me kosto të lartë për të arritur deri te një informatë për të pasuruar ndonjë kërkim shkencor apo të ngjashme. Hulumtimi në këto burime, të cilat na ofrohen nga rrjeti e zëvendësojnë

shkuarjen qoftë edhe në bibliotekën e qytetit, dhe kjo për studiuesit, njerëzit e shkencës dhe të dijes në përgjithësi paraqet një lehtësim më vete.

Do të ishim shumë fatlumë sikur në shoqëritë tona këto arritje të kishin vetëm këtë destinacion dhe përdorim. Ajo që na pikëllon është se të rinjtë tanë në veçanti arritjet e shkencës në fushën e teknologjisë informative i shohin si një mundësi për të vlarë kohën, për ta tepruar në argëtim, për të gjetur ndonjë viktimitë për orgjitë e shfrenuara etj.. Akoma më shqetësues është fakti, se interneti, televizionet kablore e satelitore (me gjithë ofertat e tyre shumë “të pasura”) janë pranë dorës së secilit, që në xhepin e tij ka 50 centë pa marrë parasysh moshën e tij dhe jashtë çdo kontrolli, qoftë institucional apo prindëror. Në shoqëritë tona pornografia me agresivitet ka gjetur rrugën për të trokitur në derën e çdo shtëpie. Kanalet televizive jo vetëm që në mënyrë shumë agresive na i shërbejnë, por ç’është më e keqja këtë e bëjnë në emër të vlerave, kulturës dhe trendëve progresive.

Këtu edhe dalin në shesh përgjegjësitë e të gjithëve: sistemit legjislativ, që këto deformime të rregullohen me ligj. Institucioneve edukativo-arsimore, që të bëjnë më tepër në vetëdijesimin e rinisë, shoqërisë civile, që të ngresh zërin kundër dukurive negative dhe prindërve që të mbajnë nën kontroll të mirëfilltë dhe cilësor fëmijët e tyre.

### **Organizimi i jetës fetare dhe administrimi i saj**

Jeta fetare te muslimanët shqiptarë është e organizuar në dy binarë gati paralelë:

Bashkësitë islame që në mënyrë të pashpallur janë përfaqësuesit legjitimë dhe gati zyrtarë të Islamit dhe muslimanëve në këto troje, dhe

Organizatrat, shoqatat dhe fondacionet që veprojnë ndaras prej këtyre bashkësive, e që



në një farë mënyre përbëjnë shoqërinë civile në këtë drejtim, por që nuk trajtohen si të këtilla akoma.

Këto dy lloj organizimesh jo rrallë e shohin njëra-tjetrën si konkurrentë në kuptimin negativ të fjalës. Fare pak ka bashkëpunim, koordinim veprimesh dhe mbulim të asaj që ka mbetur pa u mbuluar e që përbëjnë zbrazëtira të shumta e të mëdha. Deri më sot nuk di, përveç disa përjashtimeve në nivele lokale, që të jenë marrë iniciativa për të ngritur ura komunikimi e bashkëpunimi mes këtyre dy tërësive të bartësve të përgjegjësive për organizimin e jetës islame ndër shqiptarë. E vërteta është se nevoja për ekzistimin e këtyre urave është permanente dhe se mosekzistimi i tyre ka rezultuar me hutë, çorientim, dhe fragmentarizim të faktorit musliman në vendet tona. Këtë e bën akoma më të rëndë si pasojë fakti, se nevoja për një mobilizim të përgjithshëm është shumë e madhe, sepse muslimanët në këtë moment të kësaj periudhe transitore akoma nuk kanë bërë diçka, që të dëgjohej zëri i tyre.

Ky komunikim i zbehtë mes institucioneve, pastaj ekzistenca e disa shkollave të mendimit dhe metodologjive të aktivitetit islam, si dhe mungesa e debatit konstruktiv mes teologëve ka sjellë si pasojë gjithashtu edhe faktin, që shumica e shohin si përçarje mes muslimanëve e që për mendimin tim, me pak vullnet të mirë do të mund të shndërrohej në llojllojshmëri, e cila do të përjetohej si pasuri në diversitetin e mendimit dhe të aktivitetit legjitim islam. Një gjë e tillë jo vetëm që nuk është duke ndodhur, gjë që do të lehtësonte shumë punën e thirrësve dhe komentuesve të Islamit, por njëkohësisht ajo po bëhet pengesë për të përparuar Islami e me të edhe shoqëria muslimane. Përgjegjësia për këtë bie mbi të gjithë, por në të secili ka hisen e vet, sipas mundësive dhe kompetencave që ka pasur.

**“Të gjithëve na bëhet qejfi kur dëgjojmë, se një figurë publike ka dalë në mbrojtje të asaj që ne e dimë për të vërtetë..”**

### **Organizimi i jetës politike, nevojë apo pengesë**

Pjesëmarrja e muslimanëve në jetën politike, për shkak të intensitetit dhe cilësisë është gati e papërfillshme. Ajo edhe pse aty-këtu është e dukshme prapë se prapë ngjan më shumë me angazhime individuale, se sa me një lëvizje të organizuar dhe të koordinuar. Deri në një gjendje të tillë kemi arritur, për shkak të dallimeve në koncepte dhe qëndrime lidhur me angazhimin e muslimanit në jetën politike në shoqëritë si këto tonat. Pavarësisht asaj se cili është qëndrimi më afër së vërtetës unë mendoj se muslimanët në vendet tona kanë nevojë për një organizëm, që do të duhej të luante rolin e zëdhënësit të muslimanëve. Bashkësitë islame janë më të thirrurat ta bëjnë një gjë të tillë, ndërsa realiteti është dëshmitari më i mirë se sa janë në gjendje për ta bërë një gjë të tillë si duhet.

Në anën tjetër, nëse një zëri ekzistent i bashkëngjitet edhe një zë tjetër, këtu nuk shoh asgjë të keqe. Ky tjetri, a do të jetë parti politike, këshill për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, organizatë joqeveritare si pjesë e shoqërisë civile, apo diçka tjetër, kjo gjë mbetet të diskutohet brenda komunitetit. Një gjë është e vërtetë: të gjithëve na bëhet qejfi kur dëgjojmë, se një figurë publike ka dalë në mbrojtje të asaj që ne e dimë për të vërtetë. Nëse është ndonjë fjalë e mirë për Islamin, gëzimi ynë bëhet më i madh. Kjo ndodh sepse ne akoma nuk kemi arritur të flasim për vetveten dhe në emër të vetvetes. ■



# XHELOZIA PËR FENË E ALLAHUT (1/2)

nuk është aspak e habitshme që besimtari të jetë xheloz për fenë e Allahut dhe ndalesat e Tij, të cilat mund të përdhosen, përkundrazi nëse ai nuk e ndien një gjë të tillë besimi i tij është në një pikë dyshimi, sepse zemërimi i zemrës dhe urrejtja e saj –që është dhe origjina e xhelozisë është besimi më i dobët.

PROF. DR. NASIR EL OMER

Xhelozia është një ndër cilësitë që tregojnë përsosmëri dhe Profeti këtë cilësi e ka pohuar edhe për Allahun e Lartësuar në fjalën e tij, të cilën na e përcjell Abdullah ibën Mesudi: *“Nuk ka më xheloz sesa Allahu, ndaj dhe për këtë Ai i ndaloi veprat e shëmtuara; qofshin të dukshme apo të fshehta”*.<sup>1</sup> Ndërsa njeriu më xheloz ka qenë Profeti Muhamed, *salallahu alejhi ue selem*, sepse ai tregonte xheloz për Allahun

e fenë e Tij dhe asnjëherë nuk hakmerrej për vetveten.

Nëse çështja është e tillë, atëherë nuk është aspak e habitshme që besimtari të jetë xheloz për fenë e Allahut dhe ndalesat e Tij, të cilat mund të përdhosen, përkundrazi nëse ai nuk e ndien një gjë të tillë besimi i tij është në një pikë dyshimi, sepse zemërimi i zemrës dhe urrejtja e saj –që është dhe origjina e xhelozisë është besimi më i dobët.

Kështu që xhelozia për fenë e Allahut në origjinë është diçka e lavdëruar dhe njëkohësisht është adhurim i zemrës ndaj Allahut të Madhëruar. Ndaj meqenëse ajo

<sup>1</sup>Buhariu dhe Muslimi.

është prej adhurimeve patjetër që ka nevojë të disiplinohet me normat e shariatit, në mënyrë që të mos e çojë zotëruesin e saj në ekstremin e ndaluar e ta shkatërrojë, ashtu sikurse ka përmendur Profeti *salallahu alejhi ue selem*: “Janë shkatërruar ekstremistët”.<sup>2</sup> Imam Neveviu –Allahu e mëshiroftë-, ka thënë: “Ata janë njerëzit të cilët zhyten, mbajnë qëndrime ekstreme dhe i tejkalojnë kufijtë qoftë në fjalë apo në vepra”.<sup>3</sup> Shembulli më i mirë për këtë që thamë është vendimi i tre personave, të cilët pyetën për adhurimin e Profetit, *salallahu alejhi ue selem*, në fshehtësi. Enesi –Allahu qoftë i kënaqur me të-, tregon: Kur ata dëgjuan për adhurimin e tij, ai iu duk shumë i madh ndaj dhe thanë: Ku jemi ne me adhurimin e Profetit, *salallahu alejhi ue selem*, të cilit i janë falur mëkatet e shkuara dhe të ardhmet! Njëri prej tyre tha: Unë do të falem gjithë natën,- tjetri tha: Unë do të agjëroj pandërprerë,- ndërsa i treti tha: Ndërsa unë nuk do të martohem asnjëherë. Në këtë kohë erdhi Profeti, *salallahu alejhi ue selem*, dhe u tha: “Ju jeni ata që thatë kështu e ashtu? Pasha Allahun! Unë jam njeriu që i frikësohem më shumë se çdokush tjetër Allahut dhe jam më i devotshmi e megjithatë unë agjëroj dhe ha, falem dhe fle, si dhe jam martuar; kush devijon nga tradita ime, ai nuk është prej meje”.<sup>4</sup>

Është e vërtetë se shumë prej djemve të rinj –sidomos në kohë sprovash dhe vështirësish-, mund t’u shtohet xhelozia, aq sa mund të dalin edhe nga binarët e t’i shkojnë më pas në përfundime të padëshirueshme. E gjitha kjo për shkak të mos-shikimit të qartë të gjërave dhe mungesa e kritereve të Sheriatit nga kujtesa

**“Ndërkohë që idhujtarët kishin fëlliqur dhe njollosur vendin më të pastër në tokë - Qabenë e nderuar-, me idhuj e puta, përsëri Profeti salallahu alejhi ue selem, përpara emigrimit nuk ndërmori thyerjen e tyre...”**

e tyre dhe padyshim që kjo është një çështje e rrezikshme, e cila ka nevojë për tërheqjen e vërejtjes dhe orientimin e njerëzve për dëmin që sjell kundërshtimi, që ata mund t’i bëjnë shariatit të pastër, i cili është dhe shkëndija e pikënisja e çdo xhelozie. Kjo çështje është ashtu sikurse ka thënë Abdullah ibën Mesudi –Allahu qoftë i kënaqur me të-: **“Sa ka prej atyre, të cilët e kërkojnë mirësinë por, nuk e arrijnë atë!”**<sup>5</sup>

Nuk ka dyshim se gjynahu dhe e keqja më e madhe e më e rëndë është shokvënia e Allahut (shirku), dhe kjo është gjëja e parë, për shkak të së cilës lind edhe xhelozia; ndërkohë që idhujtarët kishin fëlliqur dhe njollosur vendin më të pastër në tokë - Qabenë e nderuar-, me idhuj e puta, përsëri Profeti *salallahu alejhi ue selem*, përpara emigrimit nuk ndërmori thyerjen e tyre, as nuk i urdhëroi shokët e vet për një gjë të tillë, edhe pse ai mund ta bënte këtë gjë. Asnjë i mençur nuk mund të thotë, se Profeti, *salallahu alejhi ue selem*, nuk ka qenë xheloz, kur i shikonte këto idhuj, porse ai –e shpagoftë me nënën dhe babanë tim-, nuk mund të kryente diçka apo ta linte atë,

<sup>2</sup> Muslimi.

<sup>3</sup> Sherh Nevevi: 16/220.

<sup>4</sup> Buhariu dhe Muslimi.

<sup>5</sup> Sunen Darimi: 1/79.

përveçse në përputhje me dëshirën e Allahut dhe pëlqimin e Tij.

Po ashtu nga gjërat më të këqija ishte dhe ajo që po përjetonin shokët e tij në Mekë me vrasje, tortura dhe gjenocid, dhe asnjë i mençur nuk mund të thotë, se ai, *salallahu alejhi ue selem*, nuk kishte xhelozia për atë që po përjetonin shokët e tij, madje asnjë i mençur nuk mund të thotë se ai nuk e ka pasur mundësinë që të urdhëronte dikë t'i sillte kokën e Ebu Xhehlit, apo të dikujt tjetër nga kriminelët, të cilët po i mundonin besimtarët e më pas të ndodhte ç'të ndodhte! Porse ai në këtë situatë vetëm i inkurajonte për të qenë të durueshëm, sikurse kemi thënë në të: *“Duron, o familja e Jasirit, sepse vendtakimi juaj është Xheneti”*.<sup>6</sup> Po ashtu ai i ndalonte nga nxitimi, sikurse na tregohet në hadithin e Habab ibën Eretit, i cili ka thënë: U ankuam te Profeti, *salallahu alejhi ue selem*, ndërkohë që ai po rrinte i mbështetur në pelerinën e tij nën hijen e Qabesë, i thamë: O i Dërguari i Allahut! A nuk po kërkon ndihmë për ne, a nuk po lutesh për ne? Ai u tha: *“Në kohët para jush e merrnin personin, i hapnin një gropë në tokë e vendosnin në të e më pas merrnin një sharrë, të cilën e vinin mbi kokën e tij dhe e ndanin më dysh, edhe mishin ia zhvatnin nga kockat me krehër prej hekuri, dhe përsëri kjo gjë nuk e luhaste nga feja e tij. Pasha Allahun, ai do ta plotësojë këtë fe, aq sa kalorësi do të ecë nga Sanaja e deri në Hadrameut dhe nuk do të frikësohet prej askujt tjetër veç Allahut, apo nga ujku se mos i ha bagëtinë, porse ju po nxitoheni”*.<sup>7</sup> Kështu është dhe me disa të rinj sot, ata vërtet janë të nxituar.

Kjo që themi nuk është se ne ftojmë për të kotën dhe as nuk kemi si qëllim, që të

<sup>6</sup> Mustedrek Hakim, hadithin e ka saktësuar shejh Albani.

<sup>7</sup> Buhariu.

<sup>8</sup> Buhariu dhe Muslimi.

## “Ndaj nuk është meritë e askujt, që ta shtyjë xhelozia ndaj fesë së Allahut e t'i tejkalojë kufijtë e saj duke rënë kështu në ndalesa...”

lëshojmë pe ndaj saj, porse ne kritikojmë dhe ndalojmë nxitimin me të cilin nuk arrijmë dot synimin dhe as nuk na mbetet dot mjeti që na transporton! Kështu është edhe realiteti i disa të rinjve, ata nxitohen aq shumë, sa që disa i ka hedhur në rrufeshmëri, dhe shkatërrim, ndërsa disa të tjerë në pesimizëm, i cili më pas i ka shtyrë në izolim dhe mbyllje; e gjitha kjo ka ardhur si shkak i mos-disiplinimit me metodologjinë e sheriatit në ndryshimin e gjërave, dhe si shkak i injorancës rreth traditës hyjnore në përplasjen (mes të mirës e të keqes).

Nga aspektet më të qarta, të cilat e pasqyrojnë domosdoshmërinë e disiplinimit të xhelozisë me rregullin e sheriatit, në mënyrë që të jetë e lavdëruar e jo e urreyer është edhe historia e Sad ibën Ubades. Kur Allahu zbriti ajetin e dënimit të imoralitetit dhe përcaktoi se për përmbushjen e saj duheshin katër dëshmitarë, ai tha: “Nëse shoh ndonjë burrë të shtrirë mbi gruan time do t'ia pres kokën me shpatë. Njerëzit e lajmëruan për këtë Profetin, *salallahu alejhi ue selem*, dhe ai tha: *“Po habiteni nga xhelozia e Sadi? Unë jam më xheloz se ai dhe Allahu është më xheloz se unë”*.<sup>8</sup> Profeti pohoi se ai kishte xhelozia, megjithatë ai e kundërshtoi atë që tha Sadi, sepse kjo xhelozia nuk është e disiplinuar me rregullat

## “Allahu ka zbritur ajetin e mallkimit mes dy bashkëshortëve dhe nuk ia ka dhënë të drejtën bashkëshortit, që të rrahë apo të vrasë bashkëshorten e tij me pretekstin e xhelozisë...” ”

e shariatit dhe se ai që e kishte përcjellë këtë rregull ishte i Dërguari i Allahut, i cili nuk kish më pak xhelozë se Sadi, përkundrazi ai ka qenë njeriu më xheloz. Po ashtu ai që e kishte vendosur këtë rregull ishte Allahu i Lartësuar xhelozia e të Cilit është më e madhe se e Profetit dhe askush nuk mund të jetë më xheloz se Ai. Ndaj nuk është meritë e askujt, që ta shtyjë xhelozia ndaj fesë së Allahut e t'i tejkalojë kufijtë e saj duke rënë kështu në ndalesa. Është përcjellë te imam Ahmedi se kur zbriti ajeti: **“Ata që i akuzojnë gratë e ndershme (për imoralitet), e pastaj nuk sjellin katër dëshmitarë, t'i rrihni me tetëdhjetë goditje dhe të mos ua pranoni më kurrë dëshminë; këta janë njerëz ngatërruar”**.<sup>9</sup> Sad ibën Ubade –i pari i ensarëve- tha: A me të vërtetë, kështu ka zbritur, o i Dërguari i Allahut? Profeti *salallahu alejhi ue selem* tha: *“O Ensarë! A nuk e dëgjoni se ç'thotë zotëria juaj? Ata thanë: O i Dërguari i Allahut! Mos ja vër re, se ai është shumë xheloz; pasha Allahun nuk është martuar veçse me grua të virgjër dhe nuk është ndarë me ndonjë grua e më pas atë ta ketë kërkuar ndonjë burrë, për shkak të xhelozisë së tij! Sadi tha: Pasha Allahun, o i Dërguar i Zotit, e di që ajo është e vërtetë dhe prej*

Allahut, porse habitem si mundem unë, që nëse gjej dikë mbi gruan time e të mos e luaj e as ta trazoj derisa të gjej katër dëshmitarë? Pasha Allahun unë nëse i shoh, nuk kam për t'i lënë ta mbarojnë atë që kanë nisar”.<sup>10</sup>

Disa njerëz mendojnë se xhelozia i jep të drejtën dikujt –si në raste të tilla Zoti na ruajt-, që të vrasë gruan apo burrin, apo të dy bashkë, aq sa në sistemet e disa shteteve një veprim i tillë nuk dënohet ligjërisht, sepse e fusin atë tek mbrojtja e nderit, porse kjo nuk është e drejtë, për faktin se Allahu ka zbritur ajetin e mallkimit mes dy bashkëshortëve dhe nuk ia ka dhënë të drejtën bashkëshortit, që të rrahë apo të vrasë bashkëshorten e tij me pretekstin e xhelozisë. Ky është gjykimi dhe vendimi i Allahut, porse disa njerëz parapëlqejnë më shumë rrahjen, apo vrasjen: **“A mos kërkojnë ata gjykimin (me ligjin) e (kohës së) injorancës (paganizmit paraislamik)?! E kush është gjykatës më i mirë se Allahu për njerëzit që besojnë bindshëm?”**<sup>11</sup> Njerëz të tillë e parapëlqejnë këtë gjë duke menduar se kjo është nga domosdoshmëria e forcës dhe e burrisë, porse çështja nuk është e tillë, përkundrazi ajo është sikurse ka thënë Profeti, *salallahu alejhi ue selem*: **“Nuk është i fortë ai që i mund të tjerët në mundje, porse ai që e përmban veten në raste nervozizmi”**.<sup>12</sup> Ky është rregulli të cilin duhet ta kuptojnë të nxituarit. Duhet patjetër që ndjenjat të disiplinohen me rregullat që vendos të gjykuarit (mendja), ndërsa të gjykuarit disiplinohet me rregullat e fesë, sepse përndryshe mund të ndodhin disfata dhe katastrofa, si ato të cilat ne i dëgjojmë këtu apo atje. ■

**Përktheu dhe përshtati: Bledar HAXHIU**

<sup>9</sup> Nur: 4.

<sup>10</sup> Musned imam Ahmed, hadithin e ka saktësuar shejh Shuajb Arrnauti.

<sup>11</sup> Maide: 50.

<sup>12</sup> Buhariu dhe Muslimi.

# SEGREGACIONI I ARDHSHËM

Nëse si bazë marrim faktin, se përhapësit e islamofobive më së shumti përdorin komunikim emocional, se sa logjik, atëherë me siguri që ndërgjegjja perëndimore është adresa në të cilën duhet të përqendrojmë angazhimin tonë për të pakësuar manifestimet e Islamofobisë

## SHKRUAN: TALHA KURTISHI

**P**amjet e segregacionit dhe aparteidit në Afrikën e Jugut akoma janë të freskëta në kujtesën kolektive botërore. Historia dëshmon se veprimet zyrtare diskriminuese në baza të ndryshme janë pjesë e trashëgimisë së botës perëndimore, e cila pa të drejtë e emërton vetën si bartëse e ideve të lirisë dhe të barazisë. Me këtë bagazh historik kuptimi i islamofobisë dhe i situatës momentale është më i lehtë.

Jeta e muslimanëve në këtë kohë është bërë sfidë e vërtetë. Në relacionet me muslimanët nuk mungojnë shfaqja e frikës irracionale, e etiketimeve, stigmatizimeve madje edhe e akuzave të hapura në llogari të Islamit/muslimanëve. Fyerjet dhe ofendimet të tipit terrorist, fundamentalist, ardhacak, i prapambetur, rrezik për sigurinë, bombë e gjallë janë bërë pjesë e jetës së tyre përditshme. Nëse kësaj i bashkëngjisim edhe luftën legjislative kundër hixhabit, që ka filluar në shumë vende të Evropës, si dhe dukurinë e procedurave të reja të sigurisë (skanimi i trupit), atëherë me plot bindje mundemi të themi, se islamofobia si dikur gjatë historisë segregacioni racial, po legalizohet si pjesë e kodeve ligjore në botën perëndimore. Definicionin e parë të Islamofobisë e jep raporti i organizatës Runnymede Trust në vitin 1997. Sipas këtij raporti, neologjizmi i përmendur ka kuptimin e frikës dhe urrejtjes ndaj Islamit dhe si pasojë të këtij qëndrimi shfaqet me frikë dhe mospëlqim të muslimanëve. Aspekti më i rrezikshëm i islamofobisë është diskriminimi i muslimanëve në jetën e tyre politike,

shoqërore dhe publike në shoqëritë ku ata janë pakicë. Në vitin 2001, në forumin e Stokholmit për luftën kundër jotolerancës termi Islamofobi pranohet si formë e jotolerancës, siç janë ksenofobia dhe antisemitizmi. Nga raporti i dytë rreth islamofobisë (Islamophobia, issues, challenges and action) i publikuar në vitin 2004 në Britani kuptohet se shumë nga rekomandimet e raportit të parë nuk u morën parasysh nga qeveria e Britanisë, madje dhe u injoruan. Lakesë e rëndësishme pas sulmeve të 11 shtatorit ishte edhe fillimi i luftës në Irak në vitin 2003. Ajo nxori në pah keqpërdorimin e saj mediatik të luftës në dëm të muslimanëve, mungesën e pjekurisë tek politikanët perëndimor dhe shkurtpamësinë e popullatës. Qëndrimet zyrtare dhe jozyrtare ndaj muslimanëve në Perëndim ishin të ngjyrosura me armiqësi, dyshime, hidhërim dhe frustrime... Sipas raportit të vitin 2007 shumë muslimanë e jetojnë regjimin e vdekjes, hipokrizisë dhe injorimit që traumatizon dhe radikalizon generata të tëra.

Sipas raportit në fjalë armiqësia ndaj Islamit dhe muslimanëve ka qenë tipar i shoqërive evropiane qysh prej shekullit të



VIII të erës sonë. Kjo armiqësi në periudha të ndryshme shfaqej në forma të ndryshme me funksione të ndryshme. Armiqësia e Spanjës në shekullin e 15 nuk është njësoj me formën e shfaqur dhe të mobilizuar në kohën e kryqëzatave. Forma dallonte edhe në kohën e Perandorisë Otomane, si dhe në erën e perandorive dhe kolonializmit. Si duket emërtimi më i përshtatshëm është “islamofobitë”, si më shumë se një fenomen se sa si fenomen i vetëm.

Islamofobia publike dhe aktive në vitet e fundit është moment shumë i rëndësishëm në programet e partive dhe lëvizjeve djathtiste në Bashkimin Evropian. Partitë, si Partia Liridashëse e Austrisë, Vlaams Belang e Belgjikës, BNP e Anglisë dhe Frontit Kombëtar të Francës i bashkon urrejtja kolektive dhe shpeshherë paranoike ndaj emigrantëve muslimanë. Në aktivitetet e tyre Islamofobia dhe nxitja e urrejtjes ndaj Islamit është pjesë e menysë së përditshme. Momenti relativisht i ri është formimi i një lëvizjeve djathtiste, që mundohet të arsyetojë logjikisht armiqësinë e tyre ndaj Islamit. E tillë është Partia për Liri në Holandë, të cilën e drejton Gert Vilders.

### **Perceptimet që e shkaktojnë dhe e përcaktojnë qëndrimin islamofobik janë:**

Mendimi se Islami është religjion jofleksibël që nuk përkon me ndryshimet/”përparimet” bashkëkohore. Islami perceptohet si diçka e ndarë dhe e huaj prej botës së qytetëruar. Perceptohet si inferior, barbar, irracional, primitiv dhe diskriminues ndaj femrës. Shumica e percepton Islamin, si fe e dhunshme, agresive, që kërcënon qytetërimin dhe si palë në përplasjen mes qytetërimeve. Sipas të tjerëve Islami është ideologji politike, që shfrytëzohet për përparim politik dhe ushtarak.

Format e manifestimit të islamofobisë në këtë periudhë janë diskriminimi (gjatë punësimit dhe sigurimit të shërbimeve),

dhuna (sulme fizike, vandalizmi i pronës dhe abuzime verbale), paragjykimi (në medime dhe në ligjërimitin e përditshëm) dhe përjashtimin e muslimanëve (prej politikës, qeverisjes, punësimit dhe menaxhimit).

Në një situatë të këtillë kur aktet që me të drejtë emërohen si islamofobike kalojnë qindra, madje edhe mijëra, ndoshta çelësi për ta kuptuar më lehtë gjendjen e muslimanëve në botë është pyetja: për ta përmirësuar gjendjen e kujt duhet t’i drejtohem: logjikës së Perëndimit apo ndërgjegjes së tij? Nëse si bazë marrim faktin, se përhapësit e islamofobive më së shumti përdorin komunikim emocional, se sa logjik, atëherë me siguri që ndërgjegjja perëndimore është adresa në të cilën duhet të përqendrojmë angazhimin tonë për të pakësuar manifestimet e Islamofobisë.

Po të ishte në pyetje debati logjik i mbështetur në prova racionale fushata antiislame që zhvillohet nuk do të kishte vend.

Nga kjo që u tha mundemi të përfundojmë, se problemi i Islamofobisë tani po merr përmasa frikësuese. Atë po fillojnë ta përkrahin edhe “intelektualët”, organizohen referendume, dhe në një farë mënyre sikur lëvizim drejtë ligjësimit të saj me ligje të veçanta për muslimanët, që na e kujtojnë të kaluarën e hidhët. Detyra jonë është të angazhohemi deri në maksimum, që Islami me parimet e tij themelore të prezantohet në mënyrën më të mirë. T’i drejtohem arsyes së shëndoshë, por dhe të mos harrojmë t’i drejtohem anës emocionale të ndërgjegjes perëndimore, e cila si deri në skajshmëri po keqpërdoret nga islamofobët.

Kështu së paku do të arrijmë ta pengojmë segregacionin e ardhshëm, që do t’i vendoste muslimanët në një situatë, të cilën e përjetuan zezakët shekuj me radhë, gjatë periudhës së robërisë, që më vonë u shfaq me formën e tij më suptile me segregacionin dhe aparteidin.

Allahu është Dhuruesi i suksesit.



# “DËSHIROJ TË JETOJ VETËM PËR ZOTIN”

Të gjithë u gëzuan dhe motrat muslimane erdhën dhe më përqafojnë. Asnjëherë nuk kam pritur që të jem e pranuar kaq mirë dhe me madhësi. Ishte një përjetim i mrekullueshëm. Atë ditë kurrë nuk do ta harroj. Ishte dita më e gëzuar në jetën time. Të gjitha gratë e pranishme më përqafojnë

*Mariam Elbornsson,  
mjeke, lindur më 1973,  
u bë muslimane në vitin 1998, Suedi*

Unë jam një mjeke suedeze, me prindër suedezë. Babai im është prift, kurse gjyshi ka qenë peshkop. Pra, unë rrjedh nga një familje shumë fetare. Unë isha edukuar me Krishterimin dhe e praktikojta në jetë.

Që në moshën adoleshente kishte disa gjëra që kurrësi nuk mund t'i pranoja rreth Krishterimit: triniteti, mëkati i trashëguar dhe mbi të gjitha viktimizimi. Ishte e vështirë për mua të kuptoja që duhet të vdiste dikush që Zoti t'ua falte të tjerëve mëkatet.

Unë ndihesha shumë keq dhe e kisha ndërgjegjen e vvarë, pasi doktrina e krishterë e paraqet njeriun si shkatërrues dhe mëkatar.

Në rast se bëja ndonjë gabim, më vinte mendimi se natyra ime është shkatërruese dhe mëkatore. Kisha ndërgjegje të vvarë dhe pyesja pse duhet të viktimizohet (të vdesë) dikush për të tjerët. Ky është një pasqyrim i vrazhdë i Zotit dhe njëkohësisht Krishterimi thotë se Zoti është dashuri!

Si mundet që dikush të shpallet si DASHURI e të lejojë që djali i tij të vdesë?

Kjo është në pika të shkurtra jeta ime, para se të njihesha me fenë Islame.



Jeta ime e re filloi në pranverën e vitit 1997, kur isha në Francë. Atje fillova të njihem me Islamin përmes miqve të mi muslimanë. Ishte hera e parë që takoja muslimanë. Islami është diçka krejt tjetër, është besim në një e të vetmin Zot dhe kjo gjë më fle në zemër.

Njeriu u krijua pa mëkatin e trashëguar. Nuk krahasohet njeriu (krijesa) me Zotin dhe gjithashtu nuk krahasohet Zoti me njeriun. Njeriu është njeri dhe asgjë tjetër.

Shkaku kryesor që u bëra muslimane ishin pyetjet teologjike, përgjigjen e të cilave e gjeta në Islam. Aty gjeta se Zoti është Falës, se e tërë jeta inspirohet nga feja. Njeriu nuk bën dallim mes jetës së përditshme dhe asaj fetare. Prej kohësh dëshiroja të jetoja vetëm për Zotin. Zbulova që me Islamin kjo gjë arrihet.

U bëra edhe më e sigurt sa më shumë e

studioja Islamin dhe kur arrita tek pyetja e hixhabit (mbulesa), atëherë i parashtrova disa pyetje një nëne muslimane dhe bijës së saj, që të dyja me mbulesë: Përse mbani mbulesë? Ç'domethënie ka mbulesa për ju? Ato më shpjeguan rreth mbulesës, si e kuptojnë dhe përjetojnë ato.

Doja të dija më tepër dhe sa më shumë që mësoja mbi Islamin, më forcohej ndjenja që kjo fe është për mua. Gjatë asaj kohe iu luta Zotit të më udhëzojë në rrugë të drejtë. Mendoja shumë për gjithçka. Çfarë do të thonë prindërit e mi, shokët e klasës etj...

Kaloi pak kohë e unë vendosa të bëhem muslimane. Një të premte isha në Stokholm dhe po mbahej një konferencë islame. Prita jashtë derisa të përfundonte namazi i xhumasë. Gjatë kohës së namazit u thashë shokëve të mi se pa dyshim pas namazit do të pranoja Islamin.

Njëri prej tyre më tha: "Atëherë le ta pranojmë bashkërisht përnjëherë." Ishim disa të rinj dhe nuk e dinim se çfarë kërkohej prej nesh. E dinim se duhej thënë dëshmia (shahadeti), por nuk dinim nëse kërkohej diçka tjetër.

Ne shkuam në xhaminë Rabita. Pas namazit të xhumasë, xhemati qëndronte ende në xhami dhe unë hyra dhe e thashë shehadetin pas imamit. Ishte një ndjenjë fantastike. Të gjithë u gëzuan dhe motrat muslimane erdhën dhe më përqaфонin. Asnjëherë nuk kam pritur që të jem e pranuar kaq mirë dhe me madhësi. Ishte një përjetim i mrekullueshëm. Atë ditë kurrë nuk do ta harroj. Ishte dita më e gëzuar në jetën time. Të gjitha gratë e pranishme më përqaфонin, këmbenin adresën me mua, më dhuronin mbulesa dhe mbi të gjitha kujtoj gëzimin dhe emocionet e tyre. Ato nuk dinin asgjë për mua, por megjithatë ishin të gëzuara për mua.

Pasi u bëra muslimane, të parët që e morën vesh ishin prindërit e mi. Babai im u

## “Doja të dija më tepër dhe sa më shumë që mësoja mbi Islamin, më forcohej ndjenja që kjo fe është për mua...”

mërzit shumë, kurse nëna u hidhërua pa masë. Ky ishte reaksioni i parë. U desh shumë që të më pranonin. Ata deklaruan se do ta respektonin vendimin tim dhe jetën time si muslimane. Pas një kohe të gjatë filluan të më pyesin rreth asaj se pse zgjodha Islamin. Ishte e vështirë të flisje mbi atë temë. Kur unë u mbulova, babai im sa nuk qau. Ndihehin shumë keq. Unë nuk banoja me ta atë kohe, pasi studioja për mjekë, por i vizitoja dhe isha me mbulesë. Unë dëshiroj që prindërit e mi të bëhen muslimanë. Mendoj që babai im tashmë ka filluar të më kuptojë si muslimane. Verën e kaluar (1999), kur ishim me pushime me dy prindërit e mi, babai im më pyeti mbi Islamin, përse e zgjodha atë dhe disa pyetje të tjera. Unë kam një vëlla, i cili u dëshpërua kur kuptoi se isha bërë muslimane. Nga farefisi im disa ndjenin habi dhe pyesnin sepse u dukej e çuditshme ajo që më kishte ndodhur. Ata kanë paragjykime për Islamin, pasi e shohin si shtypje ndaj grave. Shumica e tyre pyetën si mundet që unë, një perëndimore, të bëhem muslimane?! Si një grua muslimane, unë jam e lirë nga mendimet e ndryshme se si dukem nga jashtë. Sot bëhet një presion i madh mbi femrën rreth pamjes së jashtme të saj. Unë nuk dua të vlerësohem nga pamja ime e jashtme, por nga brendia. Ata nuk dinë shumë mbi Islamin, vetëm aq sa u japin mediet. Unë, elhamdulillah, ndihem krenare dhe e fortë.

Islami më ka dhënë shumë, mes të tjerash siguri dhe bindje. Kam qenë një person që shqetësohesha edhe për imtësitë më të vogla,

por tani si muslimane jam bëra e fortë dhe e vendosur. Kam kuptuar se të gjitha çështjet janë në Duart e Allahut, prandaj falem e lutem dhe të gjitha ia lë Allahut. Tani s'kam probleme me prindërit e mi. Ata e dinë që unë nuk e ha mishin e derrit dhe as nuk pi alkool. Me shokët e punës dhe miqtë është e njëjta gjë. Të jetosh si musliman në Suedi është edhe mirë edhe keq. Has një grumbull paragjykimesh. Jam e vetmja me hixhab dhe që falem në vendin e punës. Shumë suedezë nuk e kuptojnë si mundet që njeriu të jetë musliman. Unë u rekomandoj të lexojnë për Islamin dhe sidomos të lexojnë Kuranin.

Para se të bëhesha muslimane, kisha mendim shumë negativ ndaj Islamit për shkak se nëpër shkolla i jepet një pamje negative. Babai im thoshte se Muhamedi *alejhi salatu ue selam* ka qenë një njeri që i ngjiste devetë ngjashëm me një shofer kamioni që shëtit nga kafeneja në kafene, që kishte mbledhur tregime të ndryshme dhe kishte formuar një fe të re. Kjo ishte pikëpamja e babait tim rreth Islamit. Ne doemos duhet të dalim e t'u tregojmë njerëzve ç'është në të vërtetë Islami. Në shoqëri shumë gjëra janë kundër Islamit. Ne duhet të arsimohemi me Islamin dhe t'u tregojmë të tjerëve se Islamin e praktikojnë të shkolluarit. Unë jam grua e shkolluar suedeze, por nuk ndihem e shtypur siç më paraqesin mediet. Përkundrazi, Islami më dha lirinë. Gjëja më e shkëlqyer në këtë fe është se i jep femrës identitet të saj in dhe siguri. Ne kemi obligime të ndryshme si njerëz, por para Allahut jemi të barabartë. Të gjithë jemi vëllezër dhe motra.

Një kapitull i rëndësishëm në jetën time janë edhe takimet me motrat muslimane. Me disa prej tyre jam aq e afërt, sa që edhe sekretet më të vogla ua tregoj. Ndhimohemi mes nesh në besim e në jetë. Me jomuslimanet nuk guxoj t'i zbuloj fshehtësitë e mia personale, se kanë të bëjnë me imantin

tim.

Islami më jep mbështetje të fortë. Me faljen e pesë kohëve jeta ime ka ndryshuar plotësisht. Për mua Islami, feja ime, vjen e para, pastaj të tjerat. Kudo që të jem, në punë, në rrugë apo diku tjetër, namazi është gjëja më kryesore për mua. Pesë namazet e ditës janë si një puls dhe nuk marrin shumë kohë për t'i falur. Ndodh që në punë ndonjëherë të kujdesem për ndonjë pacient urgjent, por menjëherë pastaj mbetet kohë edhe për t'u falur. Kjo nuk ndeshet me punën time, përkundrazi, më jep çiltërsi dhe përqendrim edhe më të madh. Gjatë dimrit është më e vështirë, pasi koha është shumë e shkurtër. Por prapë ka zgjidhje, e bashkoj drekën me ikindinë ndonjëherë.

Namazi më ka lënë përshtypjen më të madhe sepse jam në kontakt të rregullt me Allahun. Për ta mbajtur gjallë imantin tim, unë lexoj dhe diskutoj me burrin tim. Dashuria për mua është të japësh e të marrësh. Bukuria me Islamin është tërësia e tij, adhurimi i një Zoti që ka çdo gjë në Dorën e Vet, që kontrollon çdo gjë.

### Vështirësitë

Ndonjëherë bie në sprova, por kjo është e mirë për ty sepse vijnë nga Allahu. Kur ke besimin islam, atëherë vjen bindja dhe syçelësia rreth gjërave që ndodhin në ty dhe rreth teje. Gjersa kërkoja punë, por ende nuk e kisha falur namazin e istihares, më ndodhi që nuk u pranova në punë. U mërzi dhe hidhërova shumë, por kjo më doli për mirë sepse ai vend pune s'kishte qenë i mirë për mua. Kjo është e mira e namazit të istihares. Pasi e bëra, m'u plotësua nga Allahu.

Unë hetoj se me kalimin e kohës përparoj çdo ditë në Islam; flas, komunikoj rreth njohurive të reja, lexoj pandërprerë, sidomos Kur'anin.

Dallimi mes Islamit dhe religjioneve të tjera është se Islami ka ardhur për të gjithë,

kurse të tjerat janë vetëm për një popull të caktuar. Islami domethënë paqe, fe që Zotit ua jep atyre që e duan paqen.

Unë mahnitëm me Hatixhen, gruan e parë të Profetit Muhamed *alejhi salatu ue selam*, që e përkrahu me të gjithë fuqinë e saj.

Muhamedi *alejhi salatu ue selam* është udhërrëfyesi im në rrugën e Zotit, se si duhet të jetojmë ne. Jezusi po ashtu është një Profet, bile nga më të zgjedhurit. Vendin që ai zë në Islam e nderon atë si profet dhe jo si djalë i Zotit, e aq më pak si Zot.

Këshilla ime për ata që kërkojnë kuptimin e jetës është të kërkojnë dituri për religjione të ndryshme dhe ta lusin Zotin t'ua tregojë rrugën e vërtetë.

Atyre që nuk e praktikojnë Islamin u them të kujtojnë ajetet kuranore. Ju jeni muslimanë, e dini ç'ju pret pas vdekjes. Çfarë përgjigjeje do t'i jepni Allahut kur do t'ju pyesë.

Këshilla ime për ata që praktikojnë Islamin është: Mësojeni edhe më shumë fenë. Unë i këshilloj fëmijët e mi që në të ardhmen të jetojnë si muslimanë. Jeto vetëm për Allahun dhe mos e harro asnjëherë.

Kam shumë dëshirë t'i ndihmoj njerëzit. Islami më ka ndryshuar krejtësisht.

Më parë e vizitonim Zotin vetëm të dielave në kishë, tani në jetën e përditshme si muslimane jam përherë e lidhur me Zotin. ■

**Përshtati dhe përktheu nga suedishtja: Sabit MULAKU**

**(nga Libri "Të shohësh qëllimin!  
Intervista me 30 perëndimorë që  
përqaftuan Islamin"; autor: Ibrahim  
Abdullah)**

# XHAMITË, ATO VENDE TË DASHURA

**"Vendet më të dashura për Allahun janë xhamitë", ngaqë ato janë shtëpi ku kryhen adhurimet dhe themelet e saj janë ndërtuar mbi devotshmërinë ndaj Allahut. "...dhe vendet më të urryera tek Allahu janë tregjet.", ngaqë ato janë vende të mashtrimit, tradhtisë, kamatës, betimeve të rrejshme,**

**SHKRUAN: RASHID ZYLFIU**

**U**meti i Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, është dalluar me ndërtimin e xhamive, dhënien e kontributit dhe dëshirën për t'i ndërtuar ato.

**Kuptimi i termit xhami:**

Fjala xhami është e huazuar nga gjuha arabe "el-xhami", e cila është cilësi e fjalës "mesxhid", është quajtur kështu për shkak se njerëzit mblidhen në "mesxhid xhami."<sup>1</sup> I thuhet xhamisë ku falet namazi i xhumasë edhe nëse është e vogël, ngaqë mbledh njerëzit në kohë të caktuar.

**Rëndësia e xhamisë në shoqërinë islame:**

Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ndërtoi xhaminë e tij në çastin që mbërriti në Medinë.

Lidhja e Sahabëve me xhaminë.

Xhamia ka qenë vendi kryesor në marrjen e

<sup>1</sup> Në gjuhën arabe bëhet një dallim mes fjalës mesxhid dhe mesxhid xhami. Mesxhid përdoret vetëm për ato vende ku falen pesë kohët e namazit, ndërsa mesxhid xhami është vendi ku falet edhe namazi i Xhumasë.





mësimëve islame.

Shkolla e jetës dhe shtëpia e dytë për muslimanin.

### Tre xhamitë më të mira në dynja:

Xhamia e Haremit (Qabja), Xhamia e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem* dhe Xhamia e Aksasë; këtë e argumenton hadithi i Ebu Dherrit që ka thënë: O i Dërguari i Allahut, cila xhami është ndërtuar e para në tokë?- Ai ka thënë: “*Xhamia e Haremit (Qabja)*”,- i thashë: “E pastaj, cila?”- tha: “*Xhamia e Aksasë*”. I thashë: “Sa ka në mes tyre?”- tha: “*Dyzet vite, aty ku të zë koha e namazit falu, se ajo është xhami*”<sup>2</sup>.

### Xhamia Kuba është më e mira pas tre xhamive të shenjta:

Përcillet nga Abdullah ibën Omeri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se ka thënë: “Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, vinte në xhaminë e Kubasë çdo të shtunë në këmbë apo hipur.”

Të njëjtën gjë vepronte edhe

<sup>2</sup> Shënon Buhariu dhe Muslimi.

<sup>3</sup> Shënon Buhariu dhe Muslimi.

<sup>4</sup> Për çdo pikë që përmendim ka argument të posaçëm, por nuk na lejojnë mundësitë e vendit përmendjen e tyre.

## “Zgjidhe vendin në safin e parë nga ana e djathtë e imamit, pa u shtyrë me askënd, dhe pa penguar njeri...”

Abdullah ibën Omeri. Sipas Muslimit: “Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, vinte në xhaminë Kuba çdo të shtunë në këmbë apo hipur dhe i falte dy rekate.”<sup>3</sup>

### Etika e të shkuarit në xhami<sup>4</sup>

Shkuarja në xhami ka etikën e saj:

1. Marrja abdes në shtëpi,
2. Largimi i erërave të këqija,
3. Veshja e bukur,
4. Thënia e duasë së daljes nga shtëpia me nijetin për namaz,
5. Nuk i kërcet gishtërinjtë gjatë rrugës për namaz e as gjatë namazit,
6. Ecën i qetë dhe ngadalë,
7. Shiko këpucët e tua para se të hysh në xhami e në qoftë se kanë ndonjë papastërti, atëherë i fshin ato për tokë,
8. Hyr me këmbën e djathtë në xhami dhe thuaj duanë e hyrjes në xhami,
9. Jep selam me zë, aq sa dëgjojnë ata që janë afër teje,
10. Fal dy rekate tehijetul mesxhid,
11. Zgjidhe vendin në safin e parë nga ana e djathtë e imamit, pa u shtyrë me askënd, dhe pa penguar njeri,
12. Dil nga xhamia me këmbën e majtë dhe thuaj duanë e daljes nga xhamia.

### Vlera e xhamive dhe mirësitë e tyre:

Vlera dhe rëndësia e xhamive shihet në atë që Allahu i ka përmendur ato në 18

vende në Kuran dhe Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në shumë hadithe. Për pozitën e lartë që ka xhamia Allahu i Lartësuar i nderoi duke i lidhur me veten e tij. Allahu i Madhëruar thotë: **“Vërtet xhamitë janë posaçërisht për ta adhuruar Allahun, e mos adhuroni në to askënd tjetër me Allahun! <sup>5</sup>”**. Edhe pse çdo vend është pronë e Allahut të Lartësuar, por xhamitë kanë specifikat e veta, ngaqë në to kryhen shumë adhurime.

Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: **“Vendet më të dashura për Allahun janë xhamitë dhe vendet më të urryera tek Allahu janë tregjet.”<sup>6</sup>**

Imam Neveviu, Allahu e mëshiroftë, thotë: **“Vendet më të dashura për Allahun janë xhamitë”**, ngaqë ato janë shtëpi ku kryhen adhurimet dhe themelet e saj janë ndërtuar mbi devotshmërinë ndaj Allahut. **“...dhe vendet më të urryera tek Allahu janë tregjet.”**, ngaqë ato janë vende të mashtrimit, tradhtisë, kamatës, betimeve të rrejshme, thyerjes së premtimeve, largimit nga përmendja e Allahut, edhe shumë gjërave të tjera, që bëjnë pjesë në këtë kuptim.<sup>7</sup>

### **Vlera e ndërtimit të xhamive dhe përkujdesja ndaj tyre:**

Shumë argumente aludojnë për vlerën e ndërtimit të xhamive, siç është ajeti kuranor:

**“E drejtë e përkujdesjes së xhamive të Allahut është vetëm e atij që i ka besuar Allahut dhe Ditës së Fundit, që e fal namazin, jep zeqatin e nuk i frikësohet askujt pos Allahut. Të tillët do të jenë të udhëzuarit (në rrugën e drejtë).”<sup>8</sup>**

Përkujdesja ndaj xhamive është e

shumëllojshme. Ajo mundet të jetë me ndërtimin, pastrimin, ndriçimin, ashtu siç bëhet me namaz, qëndrimi në te, mësimi i diturisë së dobishme e nga më të vlefshmet mësimi i Kuranit Fisnik. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i ka nxitur besimtarët në ndërtimin e xhamive. Na përcillet nga Osman ibën Afani, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: **“Kush ndërton një xhami për hir të Allahut, Allahu i ndërton të njëjtën në xhenet.”<sup>9</sup>**

Ibën Haxher, Allahu e mëshiroftë, thotë se thënia: **“Kush ndërton një xhami”** - “në te bënë pjesë qoftë e madhe apo e vogël”<sup>10</sup>.

### **Vlera e pastrimit dhe e parfumimit të xhamive:**

Islami e inkurajon pastrimin e xhamive dhe mbikëqyrjen e tyre dhe për këtë ka shpërblim të madh. Nga Enesi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, na përcillet se ka thënë: Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: **“Më janë ekspozuar shpërblimet e umetit tim, deri edhe një grimcë që njeriu e nxjerr nga xhamia, dhe më janë ekspozuar mëkatet e umetit tim, dhe nuk kam parë mëkat më të madh, se një sure nga Kurani apo një ajet që mëson njeriu e pastaj e harron atë.”<sup>11</sup>**

Nga Ebu Seidi na përcillet, se ka thënë: **“Ka qenë një grua e zezë, që ka mirëmbajtur xhaminë dhe kishte vdekur natën. Kur Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, u gdhi në mëngjes i shkoi lajmi për te dhe tha: “A nuk më treguat për te?”, dhe shkoi me shokët e tij, u ndal tek varri i saj, ia fali namazin e xhenazes dhe të tjerët ishin rreshtuar mbrapa tij, bëri dua dhe u kthye.”<sup>12</sup>**

Përcillet nga Aishja, Allahu qoftë i kënaqur ndaj saj, se ka thënë: **“Na ka**

<sup>5</sup> Xhin, 18.

<sup>6</sup> Shënon Imam Muslimi.

<sup>7</sup> Shpjegimi i Sahihut Muslimit nga Neveviu 5/177.

<sup>8</sup> Teube, 18.

<sup>9</sup> Shënon Muslimi, Buhariu.

<sup>10</sup> Shpjegimi i Buhariut nga Ibën Haxheri, 1/545.

<sup>11</sup> Shënon Ebu Daudi, Ibën Huzejme.

<sup>12</sup> Shënuar nga Ibn Maxhe, Sahih tergibu terhib.

## Tridhjetë vite nuk ka ndodhur që të thirret ezani e unë të mos kem qenë në xhami...

urdhëruar Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, për ndërtimin e xhamive në vendbanimet tona, të pastrohen ato dhe të parfumohen.”<sup>13</sup>

### Vlera e të shkuarit në xhami:

Shkuarja në xhami për të falur namazin me xhemat llogaritet nga ibadetet më të çmuara në Islam dhe për këtë aludojnë shumë argumente ndër to:

**Ai që ka dashuri të madhe për xhamitë do të jetë nën hijen e arshit Ditën e Kiametit.**

Na përcillet nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, e ai nga Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, se ka thënë: “Shtatë grupe njerëzish në Ditën e Kiametit do të qëndrojnë nën hijen e Allahut, kur nuk ka hije pos saj. Një ndër grupet do të jetë edhe: “Njeriu që zemra e tij është e lidhur me xhaminë.”<sup>14</sup>

**Ecja për në xhami i ngre shkallët (e të mirave), shuhen mëkatet dhe shkruhen shpërblimet:**

Nga Abdulla ibën Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, na përcillet se ka thënë: “Nuk ka njeri që pastrohet, pastrohet mirë e pastaj ka si qëllim shkuarjen në xhami, veçse Allahu do t’ia shkruajë për çdo hap që bën një të mirë, e ngre një shkallë, dhe do t’ia shlyej një mëkat...”<sup>15</sup>

**Kush pastrohet dhe del për në namaz me xhemat në xhami ai është në namaz derisa të kthehet në shtëpinë e vet:**

Na përcjell Ebu Hurejra, Allahu qoftë i

<sup>13</sup> Shënon Ahmedi, Albani e ka saktësuar në Sahihun e Ebu Davudit.

<sup>14</sup> Shënon Buhari dhe Muslimi.

<sup>15</sup> Shënon Muslimi.

kënaqur prej tij, se Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: “Kur dikush nga ju merr abdes në shtëpinë e tij pastaj vjen në xhami është në namaz derisa të kthehet...”.

**Nderimi nga ana e Allahut të Madhëruar, që i bën vizitorit të xhamisë:**

Nga hadithi i Selmanit, që përcjell nga Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, se ka thënë: “Kush merr abdes në shtëpinë e tij, pastaj vjen në xhami ai është vizitor i Allahut, e drejta e të Vizituarit<sup>16</sup> është që ta nderojë vizitorin.”<sup>17</sup>

**Drita e plotë në Ditën e Gjykimit për atë që ecën nëpër errësirë për në xhami:**

Na përcjell Burejdeja, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, nga Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, se ka thënë: “Përgëzoi ata që ecin në errësirë për në xhami me dritë të plotë Ditën e Kiametit.”<sup>18</sup>

**Të parët tanë të mirë –selefu salih- dhe përkujdesja ndaj xhamive:**

Ibën Xhurejxhi ka thënë: Xhamia ka qenë vendi i Atasë për njëzet vjet dhe ai ka qene që e ka falur namazin më së miri nga njerëzit.

Sejdi ibën Musejebi ka thënë: Tridhjetë vite nuk ka ndodhur që të thirret ezani e unë të mos kem qenë në xhami.

O Zot, mundësona të përkujdesemi për xhamitë dhe të jemi prej atyre që e falin namazin në to.

**Disa nga referencat e konsultuara :**

a) El-Mesaxhid fi deuv kitab ue suneh, Seid el-Kahtanij.

b) Fusul ue mesail tetealek bilmesaxhid, Abdullah bin Abdurahman el-Xhibrijn.

c) Tehdir mesaxhid fij itihadh el-kubur mesaxhid, Muhamed Nasirudin el-Albanij.■

<sup>16</sup> I Vizituarit në këtë rast është Allahu i Madhëruar.

<sup>17</sup> Taberani fi Muxhemi kebir, dhe Ahmedi.

<sup>18</sup> Shënon Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.



# SHITBLERJA ME KËSTE

Shitblerja në islam ka rregulla dhe kushte të caktuara, përveç tyre shitblerja me këste ka edhe disa rregulla të veçanta, thyerja e të cilave e bën shitblerjen të ndaluar dhe që duhet të kihet parasysh mirë.

## SHKRUAN: LLOKMAN HOXHA

**P**rej mirësive dhe begatave të mëdha të Allahut ndaj nesh është ajo që na ka zbritur një fe në të cilën njerëzimi arrin kënaqësinë dhe lumturinë e të dy botëve. Meqenëse njeriu si krijesë e dobët dhe e varur nga faktorë të ndryshëm i paraqitet nevoja për marrëdhënie reciproke në fusha të ndryshme jetësore, për këtë ligji islam i ka dhënë rëndësi të veçantë rregullimit të marrëdhënieve reciproke, duke vendosur baza të qëndrueshme dhe themele të forta, të cilat garantojnë realizimin e urtësisë hyjnore në njoftimin e njerëzve mes vete dhe përhapjen e dashurisë mes tyre, si dhe zhdukjen e konflikteve, urrejtjes dhe armiqësisë.

Nga shitblerjet më të përhapura në kohën tonë është shitblerja me këste, si rezultat i konkurrencës së madhe në treg në mes prodhuesve nga njëra anë, si dhe rënies së faktorit blerës nga ana tjetër. Nevoja për mallra rritet çdo ditë e më shumë, kurse shumë tregje kanë pësuar rënie të mëdha, kështu që shumë kompani dhe organizata vazhdimisht përpiqen të shpikim metoda të reja marketingu me oferta nga më të ndryshmet me të cilat synojnë një numër sa më të madh konsumatorësh.

Duke qenë se shitblerja me këste nuk llogaritet specifikë e transaksioneve bankare, por ajo zhvillohet në përmasa dhe sfera

shumë më të gjëra, porse dhe shumë nga transaksionet bankare islame që kanë të bëjnë me shitblerjen bazohen në këtë lloj shitblerje, e pashë të udhës që ta shtjelloj këtë temë para se të hyjmë në transaksionet bankare islame.

### Ç'është shitblerja me këste?

Shitblerje me këste është kur shitësi shet mallin me pagesë të menjëhershme (kesh) me një çmim, kurse kur e shet me një pagesë të afatizuar çmimi është më i lartë.

Dijetarët islamë kanë dy mendime për dispozitën e kësaj çështje:

**Mendimi i parë:** kjo shitblerje është e ndaluar, të këtij mendimi janë një pakicë nga dijetarët e hershëm dhe disa nga bashkëkohorët.

**Mendimi i dytë:** shitblerja me këste është e lejuar, të këtij mendimi janë shumica dërrmuese e dijetarëve të hershëm dhe të vonshëm.

Shkaku i kësaj divergjence vjen nga ajo se shtesa që ndodh në çmim për shkak të afatit është njësoj si shtesa mbi borxh, apo nuk është e njëjtë? Ata që mendojnë se nuk ka dallim mes tyre e konsiderojnë shitblerjen të ndaluar, ndërsa ata që bëjnë dallim e pranojnë këtë shitblerje si të lejuar.

Argumentet e mendimit të parë, të cilët e ndalojnë shitblerjen me këste:

1. Fjala e Allahut: **“Allahu e ka lejuar shitblerjen dhe e ka ndaluar kamatën.”** (Bekare: 275).

Ky ajet përfshin të gjitha llojet e kamatës

## “... Rritja e çmimit me shtimin e afatit në shitblerje nuk ka të bëjë asgjë me kamatën, sepse ajo është shitblerje...”

dhe i konsideron të ndaluara dhe ndër të është edhe shitblerja me këste, duke qenë se rritja e çmimit në shitblerjen me afat llogaritet si kamatë, ngaqë nuk ka ndonjë dallim mes kamatës dhe rritjes së çmimit për shkak të afatit.

**Përgjigjja kundrejt këtij argumentimi është si vijon:** Një analogji e tillë nuk është e saktë, ngaqë rritja e shumës në borxh për shkak të afatit dallon nga rritja e çmimit në shitblerjen me këste, sepse kjo është shtesë në çmimin e mallit përballë afatit, kurse rritja e borxhit është shtesë në borxh përballë afatit, e kjo është kamatë. Rritja e çmimit me shtimin e afatit në shitblerje nuk ka të bëjë asgjë me kamatën, sepse ajo është shitblerje, dhe dallimi i çmimit me pagesë të gatshme nga ai me afat nuk llogaritet borxhdhënie (el kard), kjo është njësoj si dallimi i çmimeve në shitblerjen me shumicë dhe pakicë.

Përfundimisht themi se ajeti i famshëm nuk përfshin çdo lloj shtese (rritje çmimi), por një lloj të caktuar prej të cilave nuk është shitja e mallit me afat duke ia rritur çmimin. Pra argumentimi me këtë ajet nuk është në vendin e duhur.

2. Ebu Hurejre përcjell se “i Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem ka ndaluar të bëhen dy shitblerje në një shitblerje.*” Domethënia e kësaj e tregon Es Simaku, ku thotë: “Kjo ndodh kur shitësi thotë: çmimi i mallit me afat është kaq, e në të gatshme kaq.” Ky hadith tregon se është e ndaluar të bëhen dy kontrata në një kontratë, si dhe ndalon të rritet çmimi për shkak të afatit sipas komentit të Es Simakut.

**Përgjigjja kundrejt këtij argumentimi është si vijon:** Hadithi i sipërcituar nuk përputhet me shitblerjen me këste përveçse në një formë, kur shitësi thotë: Ky mall

kushton kaq me afat dhe kaq me të gatshme dhe blerësi pajtohet me këto oferta dhe ndahet prej tij pa e përcaktuar njërin nga dy ofertat. Pra, thjesht në shitblerjen me këste kemi vetëm dy oferta e jo dy kontrata, e kur kontrata bëhet në njërin prej dy ofertave, atëherë shitblerja është në rregull.

**Argumentet e dijetarëve që lejojnë shitblerjen me këste:**

1. Fjala e Allahut: “*Allahu e ka lejuar shitblerjen dhe e ka ndaluar kamatën.*” (Bekare: 275).

Ky ajet madhështor është thënie e përgjithshme dhe përfshin të gjitha llojet e shitblerjeve, përveç atyre llojeve, të cilat janë ndaluar me argumente të tjera, gjë që tregon se shitblerja me këste është e lejuar, sepse nuk kemi argument të saktë dhe të qartë, që e përjashton nga ky përgjithësim i ajetit të sipërcituar.

2. Përcillet se “i Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* e kishte urdhëruar Abdullah ibën Amër ibën Asin ta përgatitë ushtrinë, e ai blinte një deve për t’i kthyer dy sosh, në afatin e caktuar.” Ky është argument i qartë për lejimin e marrjes së shtesës mbi çmimin përballë afatit.

3. Nga Aishja përcillet se i Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* kishte blerë nga një çifut ushqim me afat dhe për të kishte lënë peng mburojën e tij. Është ditur se çifutët nuk mund të shesin diçka me afat, po me atë çmim të cilin e shesin me të gatshme, ngaqë ata janë më lakmitarët dhe egoistët e njohur në botë, e kjo tregon se i Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* ka bërë shitblerje me afat.

4. Tradita e myslimanëve dhe konsensusi i tyre gjatë shekujve tregon vlefshmërinë e kësaj shitblerje, ngaqë nuk dihet se ndonjëherë gjatë historisë është ndaluar përveç mendimeve të disa dijetarëve, të cilët janë në pakicë, edhe pse disa nga ata kanë famë botërore. Pas shtjellimit shkurtimisht të argumenteve të të dy palëve del në pah, se mendimi që e lejon shitblerjen me këste është i saktë, duke u bazuar në

argumentet e tyre dhe përgjigjet kundër argumenteve të ndaluesve, Allahu e di më së miri.

**Disa nga anët pozitive dhe negative të shitblerjes me këste**

a. Anët pozitive:

- Ofrimi nga ana e kompanive dhe organizatave të ndryshme të lehtësimeve për konsumatorët me të ardhura të kufizuara, të cilëve gjendja financiare nuk ua mundëson të paguajnë menjëherë për gjërat që u nevojiten, gjë e cila i inkurajon ata për blerje dhe automatikisht kjo ndikon në qarkullimin e mallrave dhe mos mbetjen e tyre stok në depo.

- Tejkalimi i një problematike me të cilën ballafaqohen shumë njerëz e që është mundësia e depozitimit dhe e kursimit, ngase mangësitë financiare dhe kërkesat e shumta nga një anë dhe mos gjetja e vullnetit -gjë e cila është domosdoshme për njeriun- për depozitim nga ana tjetër, pamundëson realizimin e këtij qëllimi.

b. anët negative

- problemi që mund të ndodhë në mes shitësit dhe blerësit me rastin e pamundësisë për pagesën e kësteve, ngaqë malli nuk mund të kthehet më mbrapsht, ndërsa shitësi shumicën e mallrave e ka në borxh prej konsumatorëve, e kur shumica e konsumatorëve nuk do të kenë mundësi pagese të kësteve, atëherë shitësi dështon dhe kështu reflektohet ky problem në ekonominë e përgjithshme.

- lehtësimi i arritjes së mallrave të ndryshme me anë të pagesave komferte, inkurajon (lexo: mashtron) konsumatorët për blerje edhe të gjërave jo të nevojshme, gjë e cila e fut në borxhe të shumta dhe i shkakton telashe financiare.

Këto anë negative nuk e bëjnë shitblerjen të ndaluar, por konsumatori duhet të jetë i vetëdijshëm që të mos bjeri në grackën e marketingut.

**Rregullat dhe kushtet e shitblerjes me këste**

Shitblerja në islam ka rregulla dhe kushte

te caktuara, përveç tyre shitblerja me këste ka edhe disa rregulla të veçanta, thyerja e të cilave e bën shitblerjen të ndaluar dhe që duhet të kihen parasysh mirë.

- Shitësi dhe blerësi duhet të përcaktohen për njërën nga të dy ofertat.

- Afati duhet të jetë i caktuar, po ashtu edhe çmimi si dhe këstet, ngaqë nëse njëra nga këto janë të papërcaktuara, shitblerja është e pavlefshme.

- Me rastin e skadimit të afatit nuk lejohet të rritet çmimi e as të shtohet borxhi (kjo nuk lejohet as në kontratë, as pas kontratës), ngaqë kjo është nga kamata e injorancës, të cilën e ka ndaluar Kurani.

- Malli i shitur duhet të jetë në pronësi të shitësit para bërjes së kontratës, pra, nuk lejohet që shitësi ta marrë këstin e parë e pastaj, të shkojë e të blejë mallin diku tjetër e t'ia dorëzojë konsumatorit.

- Rritja e çmimit në kontratë duhet të lidhet me mallin e jo me afatin, pra, nuk lejohet të thotë p.sh., ky mall kushton 1500 euro ndërsa interesi mujor është 4%, por duhet treguar çmimi total dhe ndarja e tij në këste të caktuara.

- Çmimi nuk duhet të jetë shumë më i lartë se çmimi i zakonshëm, shitësi duhet të mjaftohet me një fitim normal dhe të zakonshëm e jo të shfrytëzojë gjendjen e konsumatorit duke ia rritur çmimin shumëfish.

- Nuk lejohet që shitësi ta blejë të njëjtin artikull nga blerësi paraprak me çmim më të ulët. Pra nëse blerësi me këste e ka marr mallin për 1000 euro për dhjetë muaj, nuk lejohet që shitësi t'i thotë ma shit mua prapë për 900 euro të gatshme. Kjo është e ndaluar në fenë islame.

**Afati i kështit skadon me njërën nga dy gjëra:**

a. arritja e datës së përcaktuar në kontratë.

b. vdekja e atij që duhet të paguajë këstet (blerësit), pra nëse vdes, atëherë shitësi ka të drejtë të kërkojë tërë pagesën nga trashëgimtarët e tij dhe afati i paracaktuar në kontratë bëhet i pavlefshëm nga momenti i vdekjes së blerësit, por jo edhe të shitësit. ■



# FEMRA MUSLIMANE DHE PUSHIMET VERORE

Gjatë verës ambienti ku jeton është shumë sfidues, ki kujdes mos u shkri në të se pa e kuptuar mund të jesh ndikuar. Pastaj, sheh vepra të këqija, të kënduarit e turpshëm, veshje të pahijshme, fotografime... Vallë, duhet të heshtësh në lidhje me këtë?!

**SHKRUAN: DRITA MALIQI**

**G**ruaja është pjesë e burrit dhe partnere në jetën e tij. Nën strehën e saj rriten burrat e ardhshëm dhe familje të mira. Duke kërkuar ndihmë dhe sinqeritet nga Mbrotjtësi më i Lartë dhe Fuqiptotë, po shkruaj disa këshilla drejtuar motrave të mia muslimane, si të përfitojnë nga pushimet verore, duke shpresuar se do të ndikojnë dhe jehojnë mbi shpirtrat e tyre. Lus Mbajtësin e zemrave, që të hapen portat e zemrave të tyre pas trokitjeve...

## **Motër e dashur muslimane..!**

- Në çdo vend ekzistojnë qendra për mësimin e Kuranit gjatë verës. Shko dhe bëhu e rregullt në këto qendra. Me këtë investon në kohën tënde të verës, aty do të përfitosh shumë të mira, ku do të mësoh

Kuranin dhe rregullat e texhvidit. Mundohu të mësohsh përmendësh ndonjë prej sureve apo ajeteve të Kuranit. Përveç kësaj përcilli ligjëratat dhe tribunat islame, që organizohen në vendin tënd. Pastaj edhe në shtëpi dëgjo ligjëratat të incizuara islame, sidomos të preferoj t'i ndjekësh ato tema që paraqesin një seri ligjëratash. Kjo të ndihmon të jesh më e avancuar dhe e përgatitur në një çështje.

- Gjatë pushimeve të verës ka shumë dasma, takime dhe raste të ndryshme, ku një numër i madh grash mblidhen. Nëse i mbledhim orët e humbura në këto takime do të gjejmë që rreth gjysma e pushimeve verore është humbur në të bërit pothuajse asgjë. Pse nuk i shfrytëzon këto raste dhe takime për të dëgjuar ligjëratat dhe mësimet? Po pse nuk bëhesh ti vetë ligjëruese? Nëse s'mund ta bësh këtë ftoje një motër tjetër, që është ligjëruese ose kërko nga qendrat e

davetit në vend për ta gjetur një ligjëruese për ty.

- Gjatë verës ambienti ku jeton është shumë sfidues, ki kujdes mos u shkri në të se pa e kuptuar mund të jesh ndikuar. Pastaj, sheh vepra të këqija, të kënduarit e turpshëm, veshje të pahijshme, fotografime... Vallë, duhet të heshtësh në lidhje me këtë?! Nëse do që gjendja e femrave tona të përmirësohet, atëherë si mund të jesh e heshtur dhe të mos bësh asgjë, ndërsa në anën tjetër tërë kohën të ankoesh në lidhje me gjendjen e tyre!

- Në mesin tonë ka vajza që përhapin këngë, filma, revista, telenovela dhe mjete të tjera që e nxisin negativisht femrën, familjen dhe shoqërinë tonë, e nuk mërzhiten aspak se e bëjnë këtë. Ndërsa në anën tjetër, një motër muslimane turpërohet të shpërndajë udhëzime apo ligjërata fetare. Atëherë si mendon ti, që veprat e mira të përhapen në mesin e grave, kur ti nuk ke bërë asgjë për të ndihmuar që kjo të realizohet?

- Unë po të ftoj të dëgjosh ajetet kuranore për të ta përkujtuar detyrën tënde dhe se aktivitetet e davetit nuk janë vetëm për burrat. Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja është detyrim për çdo burrë dhe grua muslimane.

***“Besimtarët dhe besimtare të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Të tillët do t’i mëshirojë Allahu. Allahu është Ngadhënjyes i Urtë. Besimtarëve dhe besimtareve Allahu i premtton xhenete nën të cilët rrjedhin lumenj, në të do të jenë përgjithmonë dhe (u premtton) vendbanime të bukura dhe xhenetin e Adnit, edhe një disponim nga Allahu që është mbi të gjitha. Ky, pra është ai shpëtim i madh.”*** Teube, 71.

## “Organizo me motrat muslimane ndonjë aktivitet bamirës, shkoni dhe vizitoni qendrat për përkujdesjen e fëmijëve jetimë...”

- Të thërras duke shpresuar që xhamitë dhe qendrat e davetit të organizojnë kurse të veçanta për gratë, duke diskutuar çështje që i brengosin dhe që kanë të bëjnë me ato, të tilla si: roli i saj në familje dhe shoqëri, cikli menstrual dhe rregullat e lindjes, mbi shëndetin e saj dhe këshillat mjekësore, martesat, trajtimi i bashkëshortit dhe jeta martesore, shkurorëzimi, rritja dhe edukimi i fëmijëve, daveti i saj, kodi i saj Islam i veshjes, qëndrimi i tyre kundrejt çështjeve muslimane dhe shumë tema të tjera. Këto kurse le të përfshijnë diskutime, duke përmbledhur edhe libra e hulumtime të rëndësishme dhe çdo gjë tjetër lidhur me gratë, në mënyrë që ato të përfitojnë nga kjo dhe ta shfrytëzojnë sa më mirë kohën e tyre. Gjithashtu ftoji edhe shoqet e tua të marrin pjesë në këto tubime.

Me këtë do të jepet mundësia të takohesh me motrat që bëjnë vepra të mira dhe që shfrytëzojnë kohën e tyre, ku për to koha është shumë e shtrenjtë. Aty edhe mund të bashkëpunoni në thirrjen islame, duke këmbyer përvoja dhe mësimet të hairit. Mos e privo veten tënde nga shpërblimet që t’i ka premtuar Allahu. Shfrytëzoje kohën e verës dhe mundohu që sa më shumë të përfitosh nga kjo. E largohu nga mbledhjet në të cilat me të vërtetë ata mund jenë të rrethuar me shejtanë, thashetheme, përgojime dhe keqinterpretime të nderit të njerëzve.

Ti ke dinjitetin dhe personalitetin tënd të pavarur që dallon nga të tjerët. Nëse duhet të ndjekësh një shembull ajo duhet të gjendet te biografite e grave sahabe, të cilat ishin të larta dhe të pastra, gratë që ishin të inspiruara nga më i dashuri i tyre, bashkëkohësit e të Dërguarit të Allahut, *salallahu alejhi ue selem*.

- Organizo me motrat muslimane ndonjë aktivitet bamirës, shkoni dhe vizitoni qendrat për përkujdesjen e fëmijëve jetimë. Shpërndani dhurata modeste! Nëse nuk mundesh t'u ofrosh diçka, fundja të paktën kalo andej, me siguri që kjo do të ndikojë t'i vlerësosh ato të mira që t'i ka dhënë Allahu. Nëse kalon atypari do të vësh se si murgeshat realizojnë aktivitetet e tyre, duke e vënë këtë në rend të parë. Po neve, a nuk na porositi i Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, -siç transmetohet nga Ebu Umame, i cili rrëfen, se i Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Kush ia ledhaton kokën një jetimi për hir të Allahut do të marr shpërblim për çdo qime floku që i përshkon dora e tij, si dhe do të qëndrojë afër me mua në xhenet”*.

- Asnjë moment mos rri pa menduar se çfarë punë të hairit mund të bësh gjatë kohës së verës. E gjithë ajo ditë e gjatë, shko vizito familjarët e tu të moshuar. Gjithashtu një të sprovuar, një të sëmurë, një të varfër, një me të meta, një të vejë, familje që kanë humbur më të dashurit e tyre, e të tjerë të cilët i ka zgjedhur Allahu për ta sprovuar dashurinë e tyre ndaj Tij. Shiko se si ata qëndrojnë ndaj sprovave, ndërsa ti mendon se ato të tuat kanë arritur majat e maleve. Mundohu të kontribuosh në iniciativa të tilla, që kanë si qëllim ndihmën apo përkrahjen ndaj njerëzve të nderuar para Allahut, por edhe mësim për ty prej qëndrimit dhe sabrit të tyre.

- Organizo në lagjen tënde një grup fëmijësh dhe mësoji atyre hapat e parë të

## “Zakonisht fëmijët pasi kryejnë vitin shkollor janë shumë të interesuar të merren me ndonjë aktivitet të lirë, le të jetë ky mësimi i fesë, ahlakut apo mësimi i shkronjave të Kuranit...”

Islamit. Zakonisht fëmijët pasi kryejnë vitin shkollor janë shumë të interesuar të merren me ndonjë aktivitet të lirë, le të jetë ky mësimi i fesë, ahlakut apo mësimi i shkronjave të Kuranit. Motivoji ata, nxiti dhe inkurajoji të thërrasin edhe të tjerë fëmijë që t’ju bashkëngjiten grupit të tyre.

- Kohën e verës shfrytëzoje edhe në të mbjella. Mbill lule në kopshtin tënd, e po pate gjithashtu edhe perime e pemë. Zbukuroje kopshtin tënd me lule, kjo do të jetë një shembull i mirë për të tjerët në mirëmbajtjen e tij, por edhe mësim dhe mundësi e mirë ta shfrytëzosh mirë kohën. Me këtë trego kujdesin tënd ndaj të bukurës, ambientit dhe do të përfitosh nga urtësitë që ka gjelbërimi. Po të drejtohem edhe ty motër, që nuk ke kopsht. Gjeje një hapësirë qoftë edhe një skutë në shtëpinë apo banesën tënde, mbille qoftë edhe një saksi. Le të jetë nga prioritetet e tua sipas mundësisë edhe qëndrimi në fusha dhe vende malore, në gjelbërime dhe medito rreth këtij ajeti: **“O Allah, Ti këtë nuk e ke krijuar kot!”**. Ajo farë, ai filiz nuk del pa lejen dhe urdhrin e Allahut. Përcillet se i Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Nuk ka asnjë nga muslimanët që mbjell një pemë ose farë dhe pastaj një zog, një person apo një kafshë kur ushqehet nga*

## “Ibën Kajimi, në lidhje me këtë thotë se katër gjëra të kënaqin: shikimi i gjelbërimit, shikimi i ujëvarës, shikimi i të dashurit dhe shikimi i frutave ...”

*ajo, dhe të mos konsiderohet si një dhuratë bamirësie për te.”* (Buhariu). Pas gjithë këtij mësimi dhe mundësie për të shfrytëzuar kohën, ja, a nuk paska edhe shumë shpërblime për këtë?! Kurse Ibën Kajimi, në lidhje me këtë thotë se katër gjëra të kënaqin: shikimi i gjelbërimit, shikimi i ujëvarës, shikimi i të dashurit dhe shikimi i frutave.

- Largoju serialeve! Urgjentisht po të thërras për këtë. Të lutem largoju! Frenoje veten dhe ruaju nga komploti i hapët, që po mundohet të të prishi ty dhe familjen tënde. Ki kujdes, mos u bë pavëmendshme e të biesh në kurthin e përgatitur për ty. Në ditët e sotme dukshëm po rritet numri i shkurorezimeve, devijimeve, mosrespektimi i familjes, dhuna në familje, biseda të pahijshme dhe të turpshme në mesin e të rejave, imitime të serialeve dhe shumë veprime të tjera të ndryshme për të cilat turpërohem t'i mendoj. Thjesht largoje veten nga shikimi i tyre, edhe nëse disa nga ato në parim të duken se kanë porosi edukative. Po ti ke mënyra të tjera të marrësh dituri dhe arsimim. Ato orë që i humb aty më mirë shfrytëzoji në punë të hairit, që Allahu është i kënaqur, se sa të jetosh brenda asaj kohe në një botë imagjinare dhe të rrejshme.

- Kujdes, kujdes, kujdes nga ambienti ku jeton, nga ballafaqimet që të ndodhin ty si

motër muslimane. Kujdes nga ajo që nga jashtë duket e pastër, e dëlirë apo e padjallëzuar, ndërsa brenda është e pistë dhe e ndyrë. Largohu prej aty ku nuk të ka hije, ku nuk të takon si motër muslimane dhe përgjigju shkurt “Unë kam frikë Allahun!”.

- Lëri arsyetimet, sikur vetëm ti ke brenat e umetit mbi kokën tënde, sikur vetëm ti po brengosesh, por ja që s'ke me kë të bësh davet. Lëri kritikën dhe paragjykimet ndaj të tjerave, ankesat. Mos u merr me të metat e tyre, frenoje veten me këto, nëse dëshiron ta bësh terbiye veten tënde. Fillo me projekte individuale, bëje listën gati, listën e aktiviteteve gjatë verës, koha kalon shpejt. Puno për këtë dinë, edhe nëse të duket se ke hedhur një pikë uji në oqean. Të kujtohet rasti kur Ibrahimit a.s e hodhën në zjarr, e një buhbrec po u mundonte të hedh ujë, po ti cka bën, kur e din se smundesh ta shuash, ndërsa ai iu përgjigj “Të paktën po bëj dicka”.

### **Motër e dashur muslimane..!**

Unë jam e bindur se ti mund ta realizosh këtë projekt, të cilin e kam hartuar edhe për veten time. Ti duhet t'i përvishesh kësaj, ngase je e zonja, e Allahu të ka ngritur e të ka begatuar me shumë të mira. Të gjitha këto le të jenë si këshilla dhe përkujtim motra motrës së saj në Islam. Krejt në fund kujtoje shpesh atë që kujtoj edhe unë, këshillën e Ibën Kajimit, Allahu e mëshiroftë, që thotë se: “Çdo frymëmarrje dhe çdo pikë djerse që del në këtë botë për vepra që nuk e kënaqin Zotin, atëherë do të dalin sërish edhe në Ditën e Kiametit, mirëpo nga pikëllimi dhe sikleti!” ■



# KËMBËNGULJA NË VEPRA TË MIRA

Sa herë jemi ulur në tokë nga vështirësitë, të lodhura, të rraskapitura, të zhgënjyera për mosp suksesin e edukimit tonë... Por e gjatë është rruga... I vështirë është krijimi i institucionit evlad...

SHKRUAN: GJYLSIME ZENUNI-JASHARI

**N**jë nga thesaret mbi dituritë Islame është ajo për të cilat na ka njoftuar Muhamedi s.a.v.s. dhe ai në një rast ka thënë: *“Çdo fëmijë lind në fitre (natyrshmëri të pastër), mandej prindërit e bëjnë të krishterë, çifut apo zjarrputist.”* D.m.th. puna e nënës ka një fillim të lehtësuar, fillon me një fitre, e cila i është dorëzuar si amanet nga Ai që ka deklaruar:

*“I Allahut është pushteti mbi qiej dhe mbi Tokë. Ai krijon çka të dojë! Ai, i dhuron kujt të dojë vajza, e kujt të dojë i dhuron djem ose u dhuron dy gjinitë-djem e vajza, e kë të dojë e bën steril, Ai në të vërtetë është i Gjithëdijshëm dhe i pushtetshëm.”* (Shuara, 49-50).

Madhështia e një amaneti të tillë fillon me madhërinë e pushtetit të Allahut mbi qiejt dhe tokën, ku që në fillim të leximit të këtij ajeti na bën që të përgatitemi për diçka shumë të madhe e të rëndësishme. Nga vetë dëshira e Këtij Pronari absolut të qiejve e tokës, nënave u vijnë në dorë evladi - një



krijesë e vogël, e butë, e njomë, e nevojshme për ndihmë në të ushqyer, mandej edhe e nevojshme për ndihmë në të edukuar. Në këtë mënyrë Allahu ka bërë që ky detyrim të

vendoset mbi supet e prindërve në mënyrë të lehtësuar - në fitre, për të vazhduar mandej me dëshminim e edukimit, që edhe vetë kemi marrë, duke filluar 20 vite më parë. **“Fëmija edukohet 20 vjet para se të lindë”** D.m.th. kur është edukuar nëna, do të dijë të edukojë edhe fëmijën e saj. Me vetë fjalën edukim në fjalorët e literaturës gjuhësore nënkuptohet tërësia e vetive shpirtërore dhe fizike (botëkuptimi, cilësitë morale, tiparet e karakterit e të vullnetit), që fillon njeriu nën ndikimin sistematik të familjes e të shoqërisë dhe nëpërmjet të veprimtarisë së vet të vetëdijshme dhe mësim mbi tërë atë që është e dobishme për njeriun në dunja dhe në ahiret.

Ajo krijesë e vogël, e butë, e njomë dhe e ndjeshme duhet të synohet që pasi të rritet nën hijen e edukimit, që i Dërguari s.a.v.s. na ka mësuar, të ngjajë me palmën nga e cila nuk hidhet asgjë - d.m.th. të edukuarit nënkupton një sërë konceptesh, mësimesh dhe sjelljesh dhe asnjëra prej tyre nuk duhet të jetë në kundërshtim me atë që Allahu ka urdhëruar dhe Pejgamberi i Tij e ka praktikuar. Dhe me të vërtetë asgjë prej këtyre mësimëve nuk është për t'u hedhur, mu ashtu si pema e palmës. Një edukim i tillë është argument i sinqeritetit të fesë, që kemi zgjedhur me dëshirën që ta pasojmë, sepse **“Në fe nuk dhunë”** dhe i imanit - besimit që vetë me pëlqimin tonë kemi vendosur ta përmbushim.

Mësimet e para që duhet t'u japim evladëve në moshën më të hershme është ajo nga e cila kemi filluar edhe vetë ne:

Njësimi i Allahut duke ua mësuar suren Ihlas: **“Thuaj: Ai, Allahu është një! Allahu është Ai, që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kënd, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.”**

Ku është Allahu? A qëndron mbi qiej? Kë do më shumë në këtë botë? Janë një sërë

**“Ai që i ikën mëshirës së Allahut është ai që nuk dëshiron nxënien e diturisë, nuk dëshiron që të marrë pjesë në tubimet e dijes...”**

pyetjesh, të cilat fëmijët, posa fillojnë t'i shqiptojnë fjalët e para, u përgjigjen me dëshirë, por është nëna ajo që duhet të përgjigjet dhe t'ua mësojë butësisht e me këmbëngulje. Madje këto janë përgjigje, të cilat do t'u gdhenden në vetëdijen e tyre për të tërë jetën. Pra, a mos është punë e vogël kjo?!

Mandej t'i krijohet një dashuri e mirëfilltë ndaj Pejgamberit s.a.v.s., duke iu treguar tregime nga jeta e tij e pasur dhe shembullore, me qëllim që ai të bëhet heroi i tyre fëminor dhe i jetës, që do ta përjetojnë realisht e jo si ndonjë fantazmë apo gënjeshtër, e cila mund t'ju servohet me të madhe fëmijëve qysh në moshën më të hershme.

Argument tjetër i sinqeritetit në shfaqjen e Fesë Islame është kryerja me përkushtim e namazit dhe mësimi i evladëve për të.

Për këtë Amir ibën Abdullah ka thënë: **“O Zot, po të lus të më vdesësh me një vdekje të mirë.”** Njerëzit e pyetën: **“E si është ajo vdekje e mirë?”** Ai tha: **“Që Allahu të më vdesë kur jam në sexhde.”** Allahu i Gjithëdijshëm, i është përgjigjur lutjes së tij dhe ka bërë që atij t'i vijë vdekja kur ka qenë në sexhde. Allahu *subhanehu ue teala*, ka thënë: **“E ata që u munduan për hir Tonë, Ne me siguri do t'i orientojmë rrugës për te Ne, e nuk ka dyshim se Allahu është në krahun e bamirësve.”** (Ankebut, 69) Nuk është fe e

vërtetë ajo në të cilën lutja nuk kryhet me përkushtim, përlulje dhe modesti. Po qe se fëmija mësohet me tregime të këtilla kurrsesi nuk do të ketë nevojë të praktikohet rrahja e lehtë, sepse vetë tregimi e bën fëmijën të lakmojë:

Vdekjen e mirë,  
Sexhden ndaj Allahut dhe  
Realizimin e duave.

E këto janë tri fakte kryesore nga të cilët fëmijët ose frikësohen (nga vdekja) ose trimërohen; ose ushqehen (me namaz) ose ndjejnë uri pa të; dhe ose vetëdijësohen (me dua), ose ngelin në botën e fantazisë fëmijërore në mungesë të saj.

Argument tjetër për këmbënguljen në vepra të mira është përkushtimi i prindërve në mësimin e shkronjave të para të leximit të Kuranit, po edhe të mësimin të vetë shkronjave të gjuhës amtare. Kjo është një punë e vështirë dhe lodhëse, por kryhet me kënaqësi, kur dihen premtimet e Krijuesit në Kuran. Allahu i Lartmadhëruar ka thënë: **“Kush bën një vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.”** (Nahël, 97).

Ibrahim ibën Ed’hemi, asket dhe njeri shumë i devotshëm, ka thënë: “Duke i bërë ibadetet ne përjetojmë kënaqësi të atilla që po të kishin ditur sunduesit për këtë, do të tentonin, që të na i marrin me shpata ato.”

Mësimi i fëmijës me vlera të këtilla e bën atë të krijojë në vetvete një siguri në këmbënguljen e kryerjes së veprave të mira, krijon në të seriozitet për t’u përgatitur për diçka tejet serioze, siç është bota tjetër dhe e bën atë të shpresojë në shpërblimin e vetë Krijuesit, Allahut a.xh. Ndërsa në anën tjetër e bën nënën të vetëdijshme, se gjërat e mëdha nuk arrihen lehtë, por me mund e vështirësi, po edhe Xheneti është i rrethuar me vështirësi e megjithatë është një

**“Pra, çdo nënë le të zgjedhë vetë, se në ç’mënyrë do ta vadisë frytin e jetës së saj. Çdo nënë është e lirë të zgjedhë tokën pjellore - Dinin Islam apo baltën e fëlliqur të dalaletit...”**

përjetësi e këndshme, e cila nuk mbaron kurrë, ashtu si edhe edukimi i mirëfilltë i evladit tonë mirësia e të cilit vulozet me duart e tua sot dhe përgjithmonë.

Nga jeta e këndshme do të privohet ai që është larguar nga Allahu *subhanehu ue teala*, do të jetë i privuar nga çdo kënaqësi dhe rehati. Një irritim më i madh se sa largimi nga udhëzimi drejt rrugës së Islamit, as që mund të mendohet! Edhe për këtë na ka mësuar vetë Allahu i Madhëruar kur ka thënë: **“E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në Ditën e Kiametit do ta ringjall të verbër. Ai (që nuk besoi) do të thotë: “Zoti im, përse më ngrite të verbër, kur unë isha me sy?” Ai (Allahu) thotë: “Ashtu si i harrove ti argumentet Tona, që t’i ofruam, ashtu je ti i harruar sot.”** (Ta Ha, 124-126).

Mësimi butësisht i evladëve tanë i bën ata që ta duan fenë, Islamin, udhëzimin në rrugë të Allahut dhe krijojnë tek ata urrejtje ndaj errësirës së verbër, ndaj lajthitjes dhe mos-lakmimit ndaj të shfrenuarve dhe shfrenimit.

Mirëpo, këmbëngulja e prindërve në realizimin e edukimit të mirëfilltë kërkon durim të hatashëm në përbalimin e vështirësive të shumta. Çdo nënë e di dhe çdo lloj femre do ta mësojë, se baticat dhe zbaticat që dikur vetëm i ka lexuar nëpër

libra, sot, gjatë rritjes së fëmijëve i kemi përjetuar mbi shpinën tonë. Sa herë jemi ulur në tokë nga vështirësitë, të lodhura, të rraskapitura, të zhgënjyera për mossuksesin e edukimit tonë... Por e gjatë është rruga... I vështirë është krijimi i institucionit evlad... Dhe padyshim se gjërat e mëdha nuk arrihen lehtë... Por një garanci është e padyshimtë: **“Pas vështirësisë vjen lehtësimi.”**

Sa për ilustrim po sjell shembullin e dhënë nga Pejgamberi *sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem*, i cili ka thënë: *“Shembulli i asaj me të cilën më ka dërguar Allahu prej udhëzimit dhe dijes është sikurse shembulli i shiut, i cili bie mbi tokë. Një pjesë e tokës është e mirë dhe e thith ujin, e mbijnë bimët dhe bari. Një pjesë tjetër është e fortë dhe e grumbullon ujin, me këtë u bën dobi njerëzve, pinë, u japin ujë të tjerëve dhe vadisin. Kurse një pjesë tjetër, as nuk e thith ujin, as nuk e grumbullon. “Ky është shembulli i atij që e ka kuptuar fenë, ka pasur dobi nga ajo dije me të cilën më ka dërguar Allahu, ka mësuar vetë dhe i ka mësuar të tjerët, dhe shembulli i atij që s’ka fituar asgjë nga dija dhe nuk e ka pranuar udhëzimin e Allahut me të cilin jam dërguar”.”<sup>1</sup>*

Pejgamberi *sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem*, në këtë hadith i ndan jo pa qëllim njerëzit në tre grupe:

**Grupi i parë** janë ata që kanë nxënë dituri dhe i kanë mësuar të tjerët me atë dhe të tillët janë në shkallë menjëherë pas Pejgamberëve.

**Grupi i dytë** janë ata që kanë nxënë dituri vetëm për të pasur dobi dhe ata janë sikurse kopshti i bujshëm, burimi i ujit ose lugina, e cila përmban në vetvete një sasi të madhe uji e njerëzit i ujin të mbjellat e tyre dhe pinë ujë. Nga të këtyllët mund të dëgjosh

vetëm fjalë të mira, në qoftë se e viziton me mirëseardhje do të pranojë, do të japë këshillë, do të udhëzojë, do të ofrojë mbrojtje. Të tillin duhet ta lavdërojmë dhe ta falënderojmë përderisa u bën njerëzve mirë.

**Grupi i tretë** janë ata që nuk i bëjnë dobi, as vetes, as të tjerëve. Familja dhe fëmijët e tyre nuk kanë kurrfarë dobie prej tyre, nuk i nxisin dhe nuk i mësojnë fëmijët e tyre për mësimin e fesë dhe parimeve fetare. Të tillët janë sikurse toka me gurë, sikurse bregu i detit uji i njelmët i të cilit i shkatërron të gjitha bimët, që edhe nëse do të binte shi ditën dhe natën asnjë bimë nuk do të mbetej në jetë, sepse kjo është tokë krejtësisht jopjellore. E lusim Allahun *subhanehu ue teala*, që të na bëjë sikurse toka pjellore dhe të na udhëzojë në kryerjen e veprave të mira. Pejgamberi *sal-lAll-llahu alejhi ue sel-lem*, ka thënë: *“Kujt ia dëshiron Allahu mirësinë i jep kuptim të thellë në fe.”<sup>2</sup>*

Çdo krijesë është e lirë në vullnetin për zgjedhjen e rrugës apo përcaktimin e vetes në grupin që ai e pëlqen vetë dhe të zotët e mendjes dinë se çfarë zgjedhin.

Ai që i ikën mëshirës së Allahut është ai që nuk dëshiron nxënien e diturisë, nuk dëshiron që të marrë pjesë në tubimet e dijes, dhe për një njeri të tillë janë fjalët e Allahut *subhanehu ue teala*, kur na thotë: **“E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në Ditën e Kijametit do ta ringjall të verbër. Ai (që nuk besoi) do të thotë: “Zoti im, përse më ngrite të verbër, kur unë isha me sy?” Ai (Allahu) thotë: “Ashtu si i harrove ti argumentet Tona që t’i ofruam, ashtu je ti i harruar sot”.**” (Ta Ha, 124-126).

Pra, çdo nënë le të zgjedhë vetë, se në ç’mënyrë do ta vadisë frytin e jetës së saj. Çdo nënë është e lirë të zgjedhë tokën

<sup>1</sup> Transmeton Buhariu, 79 dhe Muslimi, 5906.

<sup>2</sup> E përcjell Buhariu, 71, 3048, 7148 dhe Muslimi, 2345, 4912.

pjellore - Dinin Islam apo baltën e fëlliqur të dalaletit.

Dije se në një rast Ibën Tejmijje *rahimehull-llah*, është pyetur për shkujdesjen (pamaturinë), e cila vjen si rezultat i pasimit të epsheve dhe cili është ilaçi për të e ai është përgjigjur:

**E para:** duhet të largohesh nga të gjitha situatat e dyshimta.

**E dyta:** duhet që sa më shpesh dhe sa më shumë ta përmendësh Allahun.

**E treta:** duhet sa më shpesh, në kohën kur je në sexhde ta bësh këtë dua (lutje): *O Ti që je rrotullues i zemrave dhe i shikimeve, përforcoi zemrat tona kah nënshtrimi ndaj Teje.*” Dhe ky është një mësim tejet i bukur për ne, jetën tonë dhe rregullsi e padyshimtë e lutjeve tona në çdo situatë.

Në Ditën e Arafatit, Sufjan Theuriu *rahimehull-llah*, ka qarë, kur ajo është dita në të cilën Allahu i kaplon besimtarët me një mëshirë të veçantë. Duke bërë dua (lutje) ka thënë: **“O Allahu im! Ti ia fal njeriut vetëm për shkak se gjendet në shoqëri të mirë. O Allahu im, unë nuk njoh ndonjë mëkatar më të madh sesa veten në këtë tubim, për këtë po të lus që të më falësh.”** Sepse çdo njeri është mëkatar e mëkatar i mirë është ai që pendohet sinqerisht te Zoti i Tij, mandej Ai lëshon rahmet mbi të dhe jep bereqet në veprat e tij. Njeriu i urtë duhet të zgjedhë më të mirën për veten, që të ketë mundësi t'i mësojë edhe të tjerët. Çdo nënë duhet të ketë kujdes, se me kë shoqërohet dhe të kontrollojë se si rrethi i saj ndikon tek ajo. Shumë më mirë është kur ke pranë ndonjë shoqe, kolege apo motër, e cila ndikon pozitivisht tek ti, në imanin tënd dhe në sjelljet e tua, prandaj *“Më thuaj me kë shoqërohesh, të të them se kush je.”*

Ameshi, një njeri i devotshëm i ka thënë vajzës së vet: *“Pasha Allahun, dyzet vite me radhë nuk jam vonuar në tekbinin fillestar të*

*namazit.”*

I theksoj këto raste për ta këshilluar së pari veten, mandej këdo që i lexon apo i dëgjon këto këshilla, ngaqë këmbëngulja në të mirë kërkon durim në sprova dhe durim në kohë për të arritur në derexhetë, që Allahu i ka përgatitur për nënat me respektimin e trefishtë të nënës krahas babait dhe njerëzve të tjerë. Dhe vetë Allahu e di, se po të mos ishte garancia e Tij për këtë, shumë nëna do të kishin hequr dorë nga mëmësia e tyre, për shkak të vështirësive. Allahu na ruajt nga kjo.

E që sukcesi të jetë më i lehtë për t'u realizuar po ju përkujtoj, se çelësi për zgjidhjen e këtij mundimi qëndron te ne vetë, sepse prindi është pasqyra më reale për foshnjën e tij, e që mandej e bën atë të rritet në bazë të hapave, ku kanë ecur vetë prindërit e tyre. Kështu çdo prind le të kujdeset se ku shkel, si shkel dhe kur do të bëhet i vetëdijshëm për këtë mudi i tij do të pasqyrohet te mburrja me pasardhësit e bukur të tij, apo te turpi nga ata dhe nga puna e tyre. Mirëpo shërimi i sjelljeve nuk mund të fillojë pa u shëruar zemrat. Prandaj dijetarët muslimanë pajtohen se ilaçi më i madh për sëmundjet e zemrës është përmendja e Allahut të Lartësuar. Për këtë shkak përpiquni që ta përmendni sa më shumë Allahun *subhanehu ue teala*, në mëngjes dhe në mbrëmje, duke qenë në këmbë, ulur ose të shtrirë anash. Allahu *subhanehu ue teala*, në Kuranin Famëlartë thotë: **“Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit!”** (Ali Imran, 191).

Po ashtu ka thënë: **“...me të përmendur Allahun zemrat qetësohen.”** (Rad, 28). ■

## FLIRTI DHE TRADHTIA BASHKËSHORTORE (3/4)

# FAMILJE QË U DOGJËN ME KËTË ZJARR

ishim duke ecur bashkë dhe ai shikonte gratë e huaja, unë i thashë: 'Ule shikimin dhe ki frikë Allahun', ndërsa ai më rrahu aq shumë, sa që u desh t'i telefonojmë ndihmës së shpejtë

DR. IBRAHIM NUKEJTHAN

Lavd-falënderimi i takon Allahut, që na mjafton, ndërsa lavdërimi dhe paqja qoftë mbi pejgamberin e përzgjedhur, Muhamedin.

Në dy numrat e kaluar përkufizuam problemin në fjalë duke paraqitur faktorët që ndihmojnë në përhapjen e këtij problemi, si dhe treguam për disa dukuri dhe pasoja të këtij problemi. Në këtë numër do të përqendrohemi për t'ju paraqitur shembuj të njerëzve që u dogjën me zjarrin e fliritit.

Po ju sjellim disa raste dhe shembuj të bashkëshorteve, që janë sprovuar të kenë burra flirtues, këtë po e bëjmë me fjalët dhe shkronjat e vetë atyre, edhe pse për disa shprehje unë kam rezerva, por qëllimi është që të dali në pah qartësisht ajo vuajtje dhe ajo djegje nga çka po vuajnë:

A) Nuk kam besuar kurrë dhe asnjëherë se një ditë burri im do të bëhet flirtues dhe njeri i egër, që dëshiron të bëjë për vete çdo femër, e cila do t'i jepte fjalë të ëmbla dhe do t'i lejonte ta rrepte. E gjithë kjo, pasi ai ishte një burrë i drejtë, falte pesë kohët e namazit në kohën e vet dhe kujdesej të shoqërohej me njerëz që ia kujtonin vlerat dhe e largonin nga poshtërsitë. Vazhdoi ashtu jeta jonë duke shijuar ëmbëlsinë e saj me pesë fëmijët tanë, derisa burrit tim i shkoi ndërmend të hapë një biznes në një prej tregjeve më të njohur. Ajo ide na gëzoi, ah sikur të mos ishim gëzuar. Nejse, burri merrej me tregtinë, sa që fillova të befasohej me faktin se ai dëshironte të shkojë te dyqani edhe pse kishim punëtorë, madje shkonte shumë herët, më herët sesa orari i punës tjetër që kishte paradite. Kaluan ditët për të filluar jeta e problemeve dhe e kokëçarjeve. Fillova të gjej në celularin e tij letra dashurie nga femra, në praninë time nuk i përgjigjej ca thirrjeve, ndërsa kur e kishte doemos të përgjigjej dilte me shpejtësi nga shtëpia që të



përgjigjet! E tëra kjo është e lehtë në krahasim me atë që burri im bëri kohëve të fundit. Vitin e kaluar ai udhëtoi jashtë shtetit dhe unë e zbulova se udhëtimin e tij e kishte aranzhuar së bashku me një femër, me qëllim që të takohen atje. Ai tani po bëhet gati të udhëtojë për së dyti. Dua të them se jeta dhe fëmijët e mi janë bërë të rënda për mua, po mendoj për divorc, sepse xhelozia nuk duron më. Deri tani këtë mendim ma ndalonte dhimbja për pesë fëmijët e mi, mirëpo tashti e mendoj seriozisht, sepse nuk kam zgjidhje tjetër.

B) Burri im e kishte njohur një femër nëpërmjet internetit dhe filloi me orë të tëra të bisedonte me te me kompjuter. Kjo e bëri dalëngadalë që të braktisë edhe namazin me xhemat. Ai tashmë është zhytur në dashuri pas saj – siç pretendon – dhe dëshiron të udhëtojë së bashku me te!

C) Unë jam një femër që jam martuar para tre vitesh, kur isha 20 vjeç. E falënderoj Allahun që jam e lumtur me bashkëshortin, e dua dhe më do. Problemi është se unë kam zemër të mirë me të gjithë, si dhe bashkëshorti është njeri me nder dhe i respekton të gjithë. Problemi filloi kur shoku i burrit – të cilin e ka shumë të afërt – nisi të flirtojë me mua, saqë arriti situata të më takojë në rrugë, të bisedojë me mua dhe më thotë t'i lajmërohem. Shkurt, unë jam e huaj në këtë vend ku jam e martuar, ndërsa gruan e këtij personi tashmë e kam mike, mirëpo nuk e di si t'ia bëj, a t'i tregoj burrit tim? A t'i tregoj gruas së tij? A ta përçmoj atë? Kam frikë se çështja do të kthehet kundër meje! Ju lutem, më ndihmoni!

Ç) Unë jam një grua 26 vjeçe, jam fetare dhe praktikante. Jam martuar para 19 muajve dhe nuk kam fëmijë. Kam problem me burrin tim, ai është shumë i egër ndaj meje, më ka rrahur disa herë për gjëra shumë të thjeshta! P.sh. ishim duke ecur bashkë dhe ai shikonte gratë e huaja, unë i

## “Madje çështja ka mbërritur deri aty, saqë njëra nga ato me të cilat flirton në telefon është mësuese e Kuranit ...”

thashë: ‘Ule shikimin dhe ki frikë Allahun’, ndërsa ai më rrahu aq shumë, saqë u desh t'i telefonojmë ndihmës së shpejtë. Madje një ditë prej ditësh më rrahu me egërsi, në fytyrë dhe në tërë trupin pastaj me rrobat e gjumit me nxori nga shtëpia. Nëna ime më bindi që të kthehem dhe unë u ktheva tek ai. Disa ditë më vonë zbulova se ai i shkruante letra një femre që dashuronte dhe ia thashë troç, se unë e di për këtë. Ai më tha se nuk ka asgjë në këtë dhe se nuk e dashuron atë. Për këtë ai më bojkotoi tetë muaj, nuk më fliste dhe as që mund ta shihja pa ndonjë arsye të bindshme. Jetonim në një shtëpi, por në dhoma të ndryshme, derën e mbyllte me çelës gjithmonë. U mundova shumë të bisedoj me të, por refuzonte me ashpërsi. I thashë: Haram është të më bojkotosh për kaq shumë kohë, por nuk i interesonte. Marrëdhënie nuk kemi pasur që nga martesja jonë, përveçse rrallë. Ai parapëlqen masturbimin duke shikuar filma pornografikë, siç e kishte pasur zakon për vite me radhë. Megjithëse jam munduar t'ia largoj këtë zakon, por pa sukses. Ai më urdhëron të kujdesem për shtëpinë, përndryshe do të më hedhë jashtë. Ai e paguan qiranë ndërsa harxhimet e përditshme dëshiron që unë t'i marr përsipër, edhe pse e di mirë se ai ka mundësi t'i paguajë të gjitha. Me plot siguri mund të them se unë atë njeri tashmë e urrej, sepse e ndjej se ai nuk ka rahmet ndaj meje dhe nuk e ka frikë Allahun për mua. Allahun e kam dëshmitar se jam munduar shumë që jeta jonë të shijojë lumturinë, por nuk e di cili është vendimi i saktë. Më ndihmoni, Allahu



ju ndihmoftë.

D) Jam martuar para katër muajve me një djalë që ishte rritur në Evropë. Familja e tij është shumë e mirë. Para disa javëve kam zbuluar se ai mban një lidhje të ndaluar fetarisht me një evropiane, tashmë një vit. Ai nuk paska mundur të ndahej nga ajo, edhe kur u fejua e u martua. Unë me këmbëngulje menjëherë kërkova divorcin, por ai nuk dëshiron të ndahet nga unë dhe më gënjen kur më thotë se është ndarë me të. Megjithatë ai me gojën e tij më ka thënë se ende e dashuron atë vajzë, çka të bëj, a të kërkoj divorcin për shkak të tradhtisë? Apo duhet të duroj?

DH) Jetoj me një burrë tradhtar, që për detyrat bashkëshortore nuk do t'ia dijë. Ato nuk kanë ndonjë peshë apo vlerë tek ai. Te celulari i tij lexoj letra erotike skandaloze nga femrat e tij. Madje goditja më e madhe për mua është kur ato lajmërohen për të këmbyer me këtë njeri fjalë dashurie, paturpësie, erotike dhe kurvërie, ndërsa unë duroj dhe shpresoj shpërbelimin tek Allahu. Lutem për të natë e ditë, që ta udhëzojë dhe ta përmirësojë. Megjithatë ai është një bashkëshort i sjellshëm, mirëpo epshit të tij ia ka lëshuar dizginët që të notojë në tokë e në qiell, të përqafojë gratë e shfrenuara, të mos ketë frikë nga Zoti i tokës dhe i qiellit, biseda djallëzore, flirte çmendurie, ndezje të epshit dhe ndjekje të tekave dhe shpirtit që urdhëron nga e keqja. Madje çështja ka mbërritur deri aty, sa që njëra nga ato me të cilat flirton në telefon është mësuese e Kuranit – sipas saj – dhe është e martuar me një burrë që cigaret i ndez një pas një dhe pi alkoolin. Kur ai e thërret në shtrat ajo i jep të holla, madje ai shpesh i thotë asaj: Më braktis mua dhe gjeje dikë tjetër. Ajo që ka iman të dobët padyshim do të zhytet në gjynahe dhe poshtërsi. Nejse, burrit të saj alkooli ia ka bllokuar trurin, ia ka humbur epshin,

kohën, pasurinë, shëndetin, jetën, madje fenë dhe nderin. Në listën e burrit tim nuk është vetëm kjo “mësuese e Kuranit”, por ka një numër të madh grash. Një herë e zura duke biseduar me një femër, së cilës i prezantohej si profesor në universitet. Kjo më shtyu të qesh, por edhe të qaj, sepse ajo ishte një nga shoqet e mia. Që nga ajo ditë zjarri i zemrës sime nuk shuhet, në celular kam gjetur shumë letra paturpësie dhe shprehje të fëlliqura femrash, ndërsa të gjitha ato janë të martuara, madje kanë fëmijë të rritur. Disa nga ato janë mësuese në zë. Unë u sprovova me këtë burrë tradhtar, por fatkeqësia është se kam një vajzë me te, si të kërkoj divorcin?! Ai sillet mirë ndaj meje, më shpreh fjalë dashurie dhe afërsie dhe më flet për ndjenjat e tij, por thotë: Shejtani bën një pjesë të punëve të këqija, ndërsa ato gratë shejtanë bëjnë pjesën tjetër. Ai supozon se mes tij dhe atyre nuk ka asgjë përpos fjalëve, bisedave telefonike, mesazheve të shkurtra dhe mund të ndodhë ndonjë takim, por nuk e prek atë që e ka të ndaluar. Ai thotë kështu, por dija e plotë është tek Allahu. Unë po jetoj e dëshpëruar jetën time, jam midis dy skajeve të hidhura, ose ndarje me divorc, ose ndarje shpirtërore, duke qëndruar në një shtëpi me këtë tradhtar. Ai e pranon krimin para meje, i vjen shumë keq për atë që ka ndodhur, qan për këtë dhe premton se nuk do ta bëjë më, por ai sërish e bën, sërish e bën, sërish e bën. Ai ma ka copëtuar zemrën, nuk po mundem t'i them asnjë fjalë të bukur, por edhe nëse ndodh t'i them ndonjë fjalë brenda meje them: O rrenacak, o dyfytirësh, sa femra sot prej teje kanë dëgjuar të njëjtat fjalë? Tashmë, nuk po mundem ta shikoj në fytyrë dhe më duket sikur ka një mur të madh midis nesh. Oh, sa jetë e rëndë që nuk mund të përballohet.

E) U kthjella një ditë për të parë atë që nuk e kam paramenduar, as imagjinuar

ndonjë ditë. Burri im, të cilin e dua pas një martese që vazhdon prej pesëmbëdhjetë vitesh kryen në telefon biseda të çuditshme... pëshpërit... zgërdhiet... shprehje të flakëruara dashurie, celularin e tij e merr kudo që lëviz... e mban nën jastëk kur fle, rri natën pa gjumë, krihet shumë, largohet nga unë pak nga pak. Kjo është bërë përditshmëria e tij, nuk është i kujdesshëm për namazet, përcjell filmat dhe satelitin... kur e shoh tërë këtë ndryshim nuk u besoj veshëve çfarë po dëgjoj, e as syve çfarë po shoh, ç'ndodhi? Kush është shkak? Ah unë, e pavëmendshmja dhe e gjora, e kuptova se burri im dashuron një tjetër, madje lidhja e tyre kishte kaluar kufirin e bisedave me telefon!

Këto ishin disa vuajtje që po përjetojnë disa bashkëshorte të gjora, ndërsa burrat nuk shkruajnë, por me vendosmëri çështjen e përfundojnë me divorc kur e kuptojnë se gratë e tyre flirtojnë. Ndërkohë prindërit vuajnë edhe më shumë, kur kuptojnë se djemtë apo vajzat e tyre kanë rënë në këtë moçal. ■

**Nga arabishtja: Omer B.**

# ZËRA TË MOHUAR

NGA: BURBUQE REXHA

Flasim e s'na dëgjojnë,  
Shfaqemi e s'na vënë re,  
Shprehemi e na injorojnë,  
Klithim!, e zëri të mos kumbojë?!

Heshtje..., nuk përgjigjet as nuk sheh njeri!  
Apo më mirë, askush nuk do të di...  
Zhurmë..., e zëri ynë nuk arrin të jehojë!  
Veç Zoti e di edhe sa kohë kështu do të kalojë?!...

O i Plotfuqishëm, dëshmitar të kemi Ty,  
Ne as më pak e as më shumë nuk kërkojmë  
Të frymojmë, veprojmë të lira...  
Duam edhe ne të jetojmë!

Fjalë, vargje e shkronja buçisni,  
Shami e hixhabe valëvisni,  
Islami me a pa të drejta do të lulëzojë,  
Allahun kemi ndihmë, do të na mjaftojë...

*P.S.: Kushtuar të gjitha motrave në Islam që përballen me mohim të të drejtave tyre...vetëm dhe vetëm për shkak të shamisë. Allahu jua lehtësoftë sfidat të gjithë muslimanëve. AMIN!*



# A MUND TË KËNAQEN JEHUDITË DHE TË KRISHTERËT ME NE?

*“As jehuditë, e as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty deri sa të pasosh fenë e tyre. Thuaju: “Udhëzimi i Allahut është udhëzim i drejtë. E nëse pasi të ka ardhur ty e vërteta shkon pas mendimeve të tyre, nuk ka kush të të ndihmojë e as të mbrojë nga Allahu.”* Bekare, 120.

SHKRUAN: ALI SHABANI

Allahu i Madhëruar me fjalët: **“As jehuditë, as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty deri sa të pasosh fenë e tyre...”**, d.m.th.- O Muhamed, as çifutët, as të krishterët nuk do të jenë të kënaqur me ty asnjëherë derisa të pasosh atë që ata i kënaq dhe është në përputhje me ata, prandaj ti (o i Dërguari Im), kërkoje kënaqësinë e Allahut në atë që të ka dërguar me të vërtetën. Thënia e Allahut të Madhëruar: **“Thuaju: “Udhëzimi i Allahut është udhëzim i drejtë...”**, d.m.th.- thuaj o Muhamed, se me të vërtetë, udhëzimi me të cilin më ka dërguar Allahu, ai është udhëzimi i drejtë, gjegjësisht feja e drejtë. **“E nëse pasi të ka ardhur ty e vërteta shkon pas mendimeve të tyre, nuk ka kush të të ndihmojë e as të mbrojë nga Allahu”**, në këtë pjesë të ajetit ka kërcënim dhe frikësim për umetin nga pasimi i rrugës së jehudëve dhe të krishterëve, pasi ta kenë mësuar Kuranin dhe Sunetin, Allahu na ruajt. Në

këtë ajet Allahu i drejtohet të Dërguarit të Tij Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, por ky urdhër përfshin të gjithë umetin. Imam Sheukani në tefsirin e tij “Fet’hul-Kadir” thotë: **“...Udhëzimi i Allahut është udhëzim i drejtë...”**, pra udhëzimi është ky udhëzim në të cilën është Muhamedi e jo ai lloj udhëzimi në të cilin janë jehuditë dhe të krishterët me librat e tyre të ndryshuar. Ky ajet po ashtu tërheq vëmendjen ndaj asaj, që umeti i Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, mos të përpiket t’i përngajë as jehudëve, as krishterëve, mos të kërkojnë kënaqësinë e tyre dhe po ashtu as mos të veprojnë si bidatçinjtë dhe epshorët.

Imam Sheukani po ashtu thekson edhe shkaku e zbritjes së këtij ajeti me të cilin bëhet edhe më e qartë kjo çështje. Ka thënë: Thalebiu përcjell nga Ibën Abasi, i cili ka thënë: Jehuditë e Medinës dhe të krishterët e Nexhranit kanë shpresuar, që Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, të falet në drejtim të kibles së tyre, mirëpo pasi Allahu e orientoi të falet në drejtim të Qabesë, kjo i



mërziti ata dhe ata u dëshpëruan, i humbën shpresat, se Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, do t'i nënshtrohet fesë së tyre. Për këtë Allahu i Madhëruar e zbriti ajetin: **“As jehuditë, as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty deri sa të pasosh fenë e tyre”**.

Kurtubiu rahimehullah në tefsirin e tij Xhamiul Ahkam: ka thënë: Në lidhje me thënien e Allahut: **“As jehuditë, as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty deri sa ta pasosh fenë e tyre”** ka dy çështje: **E para**: se ata nuk e kanë qëllimin se cilat prej ajeteve do t'i dallojnë për t'u besuar, por edhe nëse krejt ato që i kërkojnë do t'ua sillte Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*,

**“...Ebu Hanifeja, Shafiu, Ahmed ibën Hanbeli thonë, se i gjithë kufri është një fe e njëjtë...”**

ata përsëri nuk do të jenë të kënaqur. Ajo që do t'i kënaqte ata është ta braktisë fenë Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe t'i pasonte ata. **E dyta**: një grup dijetarësh, si Ebu Hanifeja, Shafiu, Ahmed ibën Hanbeli thonë, se i gjithë kufri është një fe e njëjtë, pasi Allahu e ka theksuar “fenë e tyre” në njëjës për të dy palët, ashtu siç ka thënë në suren Kafirun **“Ju keni fenë tuaj** (që i përmbaheni), **e unë kam fenë time** (që i përmbahem).” Kafirun 6. Po ashtu edhe Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, fetë e tjera përpos Islamit i ka përfshirë në hadithin: **“Nuk trashëgohen trashëgimtarët me fe të ndryshme.”** (shënojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibën Maxhe dhe Ahmed), d.m.th. aludon për Islamit dhe kufirin, gjegjësisht feja islame në vetvete dhe fetë e tjera si një tërësi.

Në këtë ajet madhështor hasim në dobi tejet të rëndësishme për ata që dëshirojnë të përfitojnë nga Kurani. Allahu i

**“Unë do të thërras: Umeti im, Umeti Im!- Allahu do të dërgojë një melek dhe do të më lajmërojë duke thënë: Ti nuk e di, se çfarë kanë bërë ata pas teje. Pastaj unë do t’u them: “Larg, larg!” ...”**

Madhërishëm ka thënë: *“Në të gjitha këto, për atë që ka mendje të shëndoshë dhe që i ka vënë veshin me vëmendje, ka argumente.”* Kaf 37. Prej atyre dobive:

Qëndrimi i jehudive dhe të krishterëve ndaj Islamit dhe muslimanëve. Ata akoma shtiren, se janë në rrugë të vërtetë dhe këmbëngulin që muslimanët ta braktisin Islamit në tërësi dhe të pranojnë fenë e tyre.

Kufri është fe e përbashkët e të gjitha feve jashtë Islamit.

Udhëzimi i vërtetë është vetëm në Islam, udhëzimi i Allahut që e kumtoi Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*.

Allahu i Gjithëdijshëm i merr në llogari robërit e Tij pasi t’ua bëjë me dije të vërtetën.

Ata që pasojnë rrugën e jehudive dhe të krishterëve, meqë Kuranin dhe Sunetin e kemi para duarve tona do të dështojë dhe nuk do të ketë ndihmës në Ditën e Gjykimit për të shpëtuar nga dënimi i Allahut Fuqiptotë.

Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, na ka paralajmëruar se do të dalin njerëz të atillë, që do t’i kenë lakmi veprat e jehudive dhe të krishterëve. Ai ka thënë: *“Do t’i pasoni ata që ishin para jush llërë pas llëre, pëllëmbë pas pëllëmbë derisa edhe po të*

*futen në vrimën e hardhucës, ju do tentoni të hynit.”* Të pranishmit e pyetën: A mos vallë ke si qëllim jehuditë dhe të krishterët?- Tha: *Po kush tjetër?!- Nga kjo retorikë nënkuptohet, se mu ata do të jenë. Shembuj konkret janë kremtimi i ditëlindjes së Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ue selem, që bëjnë bidatçinjtë të ndikuar nga të krishterët, të cilët kremtojnë ditëlindjen e Isait, alejhi selam; prerja e kurbaneve në themelet e ndërtesave kur fillon ndërtimi etj.*

Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, për sa i përket pjesës së fundit të ajetit *“...E nëse pasi të ka ardhur ty e vërteta shkon pas mendimeve të tyre, nuk ka kush të ndihmojë e as të mbrojë nga Allahu.”*, na paraqet një pasqyrë të Ditës së Gjykimit, thotë: Unë do t’u pres tek Hauzi (pishina e mbushur me ujë të Keutherit). Aty ka gastare sa numri i yjeve në qiell. Do t’i jap të pijë nga ai hauz secilit me dorën time. Ai që do të pijë nga ai ujë, nuk do të etet kurrë më. Disa do të paraqiten aty, por nuk do të munden të afrohen. Unë do të thërras: Umeti im, Umeti Im!- Allahu do të dërgojë një melek dhe do të më lajmërojë duke thënë: Ti nuk e di, se çfarë kanë bërë ata pas teje. Pastaj unë do t’u them: *“Larg, larg!”*

Pra, ata që lakmojnë në fetë e të tjerëve, jehuditë dhe të krishterët, braktisin udhëzimin e Allahut të Madhëruar, do t’i kenë këto pasoja nënçmuese, nuk shpëtojnë nga dënimi i Allahut, dhe nuk ka kush t’i ndihmojë dhe po ashtu do të privohen nga pirja e ujit tek hauzi, Allahu na ruajt.

E lusim Allahun e Madhëruar, që të na udhëzojë në rrugën e drejtë dhe të na i përforcojë këmbët në këtë rrugë, ta duam këtë fe dhe ta praktikojmë, e mos të lakmojmë në atë që nuk është e jona, Amin. ■

# JAM DALLUAR NGA PROFETËT E TJERË

Xhabir ibën Abdullahi tregon se Profeti i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Më janë dhënë pesë veçori, të cilat nuk i janë dhënë asnjë Profeti para meje: Jam ndihmuar me frikën (e armikut) në largësi një muaj, toka më është bërë xhami (vend-falje) dhe e pastër, prandaj çdo besimtar kudo që e zë namazi le ta falë atë (në këtë tokë), më është lejuar plaçka e luftës, e cila nuk i ishte lejuar askujt para meje, më është dhënë ndërmjetësimi (shefati) dhe çdo Profet është dërguar vetëm tek populli i tij, kurse unë jam dërguar për mbarë njerëzimin.”

## SHKRUAN: LULZIM SUSURI

**Zinxhiri i hadithit:** Hadithin me këtë tekst e përcjell Xhabir ibën Abdullahi, të cilin e përmend në Sahihun e tij imam Buhariu me nr. 335 dhe 438, 3122.

### Komenti i hadithit:

**“Më janë dhënë pesë veçori, të cilat nuk i janë dhënë asnjë Profeti para meje”**

Nga fjalia kuptohet qartë, se Allahu i Lartësuar e dalloi Profetin tonë, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nga Profetët e tjerë me disa veçori. Kjo është prej





mirësive të Zotit, të cilat Ai ia jep kujt të dojë. Ai thotë: **“Kjo është dhuntia e Allahut; Ai ia jep atë kujt të dojë. Allahu zotëron dhunti të madhe.”** (Xhumua, 4).

Allahu gjithashtu thotë: **“Nga këta të dërguar, disa syresh i ngritëm mbi të tjerët. Disave Allahu u foli drejtpërdrejt, kurse të tjerët i ngriti në shkallë të larta.”** (Bekare, 253).

Në fjalinë: **“Më janë dhënë pesë veçori”** nuk përmendet dhënësi, por dijetarët thonë se Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk e përmendi Allahun, ngaqë ai kur fliste për ndonjë të mirë dihej se kush ia kishte dhënë, po ashtu këto mirësi të mëdha logjikisht kuptohet, se ishin nga Allahu pasi mundësia të keqkuptohej nga dëgjuesit ishte e pamundur pasi ato të mira nuk i zotëron askush tjetër përveç të Lartësuarit. Gjithashtu ekziston mundësia që të mos e përmendte Allahun pasi të mos kuptohej nga dikush se Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, po lavdërohej me përmendjen e këtyre veçorive e duke thënë gjithmonë Allahu më dalloi mua me këtë e këtë gjë, ku përmendja e tyre sa më thjesht njëherësh nënkupton modesti nga ai, veti kjo e cila gjithmonë është e pranishme nëpër hadithet e tij, në të cilat ai përmend ndonjë mirësi të veçantë të tij të dhënë nga Zoti.

**“Jam ndihmuar me frikën (e armikut) në largësi një muaj”**

Allahu e ndihmon të Dërguarin e Tij me forma nga më të ndryshmet dhe ndoshta më të pazakonta. Ai e ndihmon me erë me shi, me melek, kafshë etj. Çdo krijesë e Zotit njëherësh është edhe ushtar i Tij, i cili ishte në shërbim të Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Prej këtyre ushtarëve të Zotit është edhe futja e frikës në zemrat e armiqve, të cilët siç përmendet në hadith edhe po të jenë në largësi një muaj nga Profeti, *sal-lallahu*

**“Në momentin që ata filluan të largoheshin nga Suneti, të bënë mēkate apo edhe të mbështeteshin në fuqitë e veta Allahu e largoi këtë frikë nga zemrat e armiqve të tyre dhe e futi në zemrat e këtyre muslimanëve...”**

alejhi ue selem, dhe ushtria e tij ata fillon t'i kapë frika prej tij. Frikë kjo e cila normalisht pasohet me dështim në betejë. Ushtria zakonisht frikësohet nga armiku i vet, kur afrohen në fushëbetejë e shtohet apo pakësohet kjo frikë sipas rastit dhe forcës së palëve. Kurse në rastin e Profetit tonë, alejhi salatu ue selam, nuk është ashtu, nga ai janë frikësuar armiqtë në largësi të madhe, akoma pa e parë dhe pa ditur asgjë për numrin dhe përgatitjen e ushtrisë së tij, e cila zakonisht thuajse në të gjitha betejat ishte më e dobët, si në numër ashtu edhe në armë nga armiku, por kjo nuk ishte shkak për të mos u frikësuar prej tij armiqtë. Cekja e largësisë një muaj sipas mendimit më të saktë të shumicës së dijetarëve nuk ka si qëllim kufizimin e largësisë, por vetëm si shembull i largësisë me të cilin Profeti dëshiroi të ishte sa më konkret në bisedë. Kjo është e vërtetë pasi atij iu frikësuan të gjithë armiqtë edhe në largësi më të mëdha, kur dëgjuan për të, bile u frikësuan si njerëzit ashtu edhe armiqtë prej xhinëve.

Kjo frikë nuk është e posaçme vetëm për Profetin tonë, *sal-lallahu alejhi ue*



*selem*, por ajo është edhe për pasuesit e tij, të cilët sadopak afër që janë udhëzimit të tij, aq më shumë do t'u frikësohen armiqtë, gjë e cila është realitet i pamohueshëm i këtij umeti, i cili ishte i pranishëm gjatë gjithë historisë Islame dhe kjo na dëshmon se muslimanët kanë udhëhequr në çdo luftë dhe të tjerët u janë frikësuar akoma pa i parë për derisa kanë qenë pasues të Sunetit dhe larg mëkateve. Në momentin që ata filluan të largoheshin nga Suneti, të bënin mëkate apo edhe të mbështeteshin në fuqitë e veta Allahu e largoi këtë frikë nga zemrat e armiqve të tyre dhe e futi në zemrat e këtyre muslimanëve. Dëshmi për këtë kemi edhe nga vetë koha e sahabëve, të cilët dështuan në luftën e Uhudit vetëm pse nuk i pasuan udhëzimet e Muhamedit *sal-lallahu alejhi ue selem*.

Realiteti tregon se edhe sot qafirët frikësohen, por në të njëjtën kohë ata frikën nuk e kanë nga muslimanët pasi shumica e tyre janë larg Islamit, por frika e armiqve sot pothuajse është e përqendruar vetëm nga Islami si fe dhe mundohen me çdo kusht ta mbajnë atë larg praktikës së muslimanëve, sepse sikur muslimanët të bëheshin të denjë në zbatimin e kësaj feje, atëherë frika e armiqve do të dyfishohej.

*“toka më është bërë xhami (vend-falje) dhe e pastër, prandaj çdo besimtar kudo që e zë namazi le ta falë atë (në këtë tokë)”*

**Kjo veçori është e qartë se i takon edhe umetit të tij pasi edhe ata tërë tokën e kanë xhami, d.m.th. vendfalje në të cilin mund të falen kur iu vjen koha e namazit. Mirëpo kjo nuk nënkupton se falja në ato vende është më e mirë apo njësoj si falja në xhami e kështu të mos i kushtohet rëndësi faljes nëpër xhami. Për sa i përket**

**Profetëve të tjerë ata nuk kanë pasur të drejtë të falen askund tjetër përveç nëpër vendfaljet e tyre të posaçme, kështu që ishin të detyruar të mos largoheshin shumë nga ato vende apo nëse ndodhte të largohen dhe të mos gjejnë xhami për t'u falur, atëherë e vononin namazin derisa gjenin xhami për falje. Kurse pastërtia e tokës do të thotë se toka për besimtarin është e pastër dhe e luan njësoj rolin si të ujit, nëse ky i fundit nuk gjendet ose mungon mundësia e përdorimit të tij.**

Dheu nuk luan rolin vetëm të abdesit, por edhe të guslit dhe me të kryhet çdo adhurim. Ai e luan rolin e ujit edhe nëse këtë të fundit nuk e gjen me vite të tëra. Nga Ebu Dherri, *radijallahu anhu*, përmendet të ketë transmetuar nga i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, se ka thënë: *“Dheu i pastër është pastrues për besimtarin, edhe nëse ai nuk gjen ujë dhjetë vite, e nëse gjen ujë atëherë lage me të lëkurën tënde, ngaqë kjo është më e mirë për ty.”* (Sahih, shiko Irvaul galil, nr. 153).

*“më është lejuar plaçka e luftës, e cila nuk i ishte lejuar askujt para meje”*

Plaçkë e luftës quhet ajo pasuri, të cilën besimtarët e marrin pas fitores në betejë kundër armiqve të tyre. Përmendet se profetët para Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e kishin të lejuar xhihadin, por atyre nuk u lejohej plaçka e luftës, që ta shfrytëzonin për interesat e tyre. Në ato kohë muslimanët pas betejës e tubonin çdo pasuri të armikut në një vend e pastaj zbriste zjarr nga qielli dhe e digte të gjithë atë pasuri, duke mos lënë asgjë. Ky zakon nuk vazhdoi edhe me umetin e Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, mirëpo atyre iu lejua shfrytëzimi i asaj pasurie, duke e ndarë fillimisht në pesë pjesë, një të pestën e shfrytëzojnë për

## “Dheu i pastër është pas-trues për besimtarin, edhe nëse ai nuk gjen ujë dhjetë vite, e nëse gjen ujë atëherë lage me të lëkurën tënde, ngaqë kjo është më e mirë për ty...”

interesat e fesë e katër të tjerat i ndajnë mes ushtarëve, këmbësori merr një pjesë kurse kalorësi tri pjesë.

“*më është dhënë ndërmjetësimi (shefati)*”

Me fjalën “shefat” kihet si qëllim ndërmjetësimi i Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, që do të bëjë për njerëzimin Ditën e Gjykimit, që Allahu ta fillojë gjykimin. Ky ndërmjetësim ndryshe njihet edhe me shprehjen: “Ndërmjetësimi i madh”, pasi Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, do të ndërmjetësojë edhe në disa raste të tjera, por ky u quajt i madhi, ngaqë është më i madhi i llojit të vet dhe është i përgjithshëm për të gjithë njerëzit. Në Ditën e Gjykimit njerëzit do të kërkojnë nga Profetët e mëdhenj, që të ndërmjetësojnë tek Allahu për të filluar gjykimi, por ata do të arsyetohen, duke u frikësuar për mëkatet e veta, derisa kjo kërkesë të arrijë tek Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e ai do ta pranojë këtë kërkesë të njerëzve dhe duke rënë në sexhde do të fillojë t’i lutet Allahut derisa Ai t’ia pranojë lutjen për të filluar llogaria. Ky rast ndryshe quhet edhe “Mekami mahmud” apo “pozita e lavdëruar” dhe e lakmuar nga të tjerët.

“*çdo Profet është dërguar vetëm tek populli i tij kurse unë jam dërguar për mbarë njerëzimin*”

Veçori e Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem* është fakti se ai u dërgua profet për mbarë njerëzimin, madje ai u dërgua edhe për xhinët. Për sa i përket profetëve të tjerë ata ishin të dërguar vetëm tek populli i tyre d.m.th. thirrja e tyre ishte detyrim për ta, që ta përhapnin vetëm tek populli i vet e jo më gjerë. Pati disa njerëz që menduan se edhe profeti Nuh, *alejhi selam*, ishte i dërguar për mbarë njerëzimin, pasi sipas tyre për shkak të mos-pranimit të thirrjes së tij të gjithë njerëzit e botës u shfarosën dhe pastaj ai pas tufanit ishte i vetmi profet në botë dhe besimtarët që e shoqëruan atë ishin e tërë raca njerëzore. Por kjo nuk qëndron për vet faktin se Allahu në Kuran thotë të kundërtën, Ai i Lartësuar thotë: **“Ne e dërguam Nuhun te populli i tij.”** (Nuh, 1).

Kurse sa i përket asaj se për shkak se nuk e pranuan thirrjen e tij u shkatërrua e tërë bota kjo nuk do të thotë, se ai ishte i dërguar tek të gjithë ata, por pasi ai thirri në rrugë të Allahut nëntëqind e pesëdhjetë vite atëherë pa dyshim kjo jetëgjatësi e tij në thirrje do të arrinte tek të gjithë njerëzit, edhe pse ai nuk ishte i dërguar për të gjithë ata. Kurse arsyetimi se ai ishte i vetmi profet pas tufanit dhe pasuesit e tij ishin të vetmit njerëz në fytyrë të tokës kjo nuk nënkupton asgjë tjetër përveç faktit, se diçka e tillë nuk ishte qëllim në vetvete, por ishte si pasojë e tufanit rast i cili nuk i jep atij epitelin “Profet i mbarë njerëzimit”. ■

# FIKU, NË KURAN DHE NË SHKENCË



Fiku nuk këshillohet të përdoret nga persona që vuajnë prej sëmundjes së sheqerit, kurse duhet ta përdorin ata që vuajnë nga hemorroidet, dhembjet reumatike, nga ata që kanë sasi të shtuar të kolesterolit në gjak

**SHKRUAN: PRIM. DR. MED. SC. ALI ILJAZI**

**A**llahu i Madhërishëm në Kuranin Fisnik betohet e thotë: **“Pasha fikun...”** (Tin, 1). Fiku është një pemë e këndshme dhe e ushqyeshme. Përmban shumë karbohidrate, që në fiqtë e thatë arrijnë mbi 60% (glukozë dhe fruktozë), si dhe albumina e yndyrna. Në krahasim me pemët e tjera, përmban më shumë kalcium, bakër, magnez, kalium dhe sulfur. Fiku përmban më shumë kalcium se qumështi. Vlen të përmendim se 100 gr. fiq

përmbajnë 126-280 mg kalcium, kurse 100 ml qumësht 120 gr. Përveç kësaj fiku përmban mjaft vitamina A, B1, B2, niacinë, B6, C etj. Fiku përmban sasi të konsiderueshme hekuri, si element i rëndësishëm i organizmit tek anemitë. Në 100 gr. fiq ka 250 kalori. Bakri, si mikroelement te fiku gjendet në një sasi prej 0,3 mg. në 100 gr. Fiku përdoret i freskët, i tharë dhe i përpunuar në produkte të ndryshme, si marmelatë, reçel, pekmez etj. Fiqtë rekomandohen të përdoren nga persona të dobësuar, nga anemikët dhe nga ata që ndjejnë shumë të

## “Qumështi i fikut të egër përdoret me efekt për zhdukjen e lythave nga sipërfaqja e duarve ose e këmbëve...” ”

ftohtë, ngase i japin organizmit forcë dhe nxehtësi.

Fiku nuk këshillohet të përdoret nga persona që vuajnë prej sëmundjes së sheqerit, kurse duhet ta përdorin ata që vuajnë nga hemorroidet, dhembjet reumatike, nga ata që kanë sasi të shtuar të kolesterolit në gjak. Fiku gjithashtu parandalon rënien e flokëve, mënjanon erën e rëndë të gojës (fedor ex ore), pastron mushkëritë nga këlbaza. Kohët e fundit thuhet se ka edhe veti antikancerogjene. Në rastet e acarimit të faringut, të mishrave të dhëmbëve dhe të rrugëve të frymëmarrjes, lëngu i përgatitur nga zierja e fiqve jep rezultate shumë të mira.

Fiqtë përdoren me sukses në mjekësinë popullore kundër kapllëkut. Për këtë çdo mëngjes pasi të kemi pirë më parë një gotë ujë të freskët hahen esëll disa kokrra fiq. Kjo nuk rekomandohet për ata që vuajnë nga diarreja. Qumështi i fikut përdoret me sukses për heqjen e kallove, si dhe kundër reumatizmit e dhembjeve të tjera artritike. Qumështi i fikut të egër përdoret me efekt për zhdukjen e lythave nga sipërfaqja e duarve ose e këmbëve. Përgatitet në këtë mënyrë: Lythat lahen me qumësht fiku të egër 3-4 herë në ditë. Kjo kurë zgjat 4-5 ditë radhazi, derisa të bien vetë.

Gjethet e njoma të fikut kanë veti terapeutike shumë të mira kundër sëmundjes së astmës. Për këtë preferohet të merren 1-2 gjethe të freskëta dhe të

zihen në ujë derisa të mbetet gjysma e sasisë së ujit. Lëngu i fituar pihet në mbrëmje para se të flemë, ose esëll në mëngjes.

Edhe për këtë pemë Allahu i Madhërishëm betohet në kaptinën e fikut (Suren Tin). Këtë pemë e preferonte mjaft edhe Muhammedi *sal-lallahu alejhi ue selem*. Tregojnë se një herë Muhamedit *sal-lallahu alejhi ue selem*, i ofruan një pjatë me fiq. Duke ngrënë ai ua ofroi edhe shokëve të vet dhe u tha: *“Se po të kisha thënë për ndonjë pemë se ka zbritur nga Xheneti, ajo pemë do të ishte fiku, ngaqë pemët e xhenetit janë pa bërthama.”*

Ne na mbetet t’ua këshillojmë njerëzve këtë pemë të rëndësishme, e cila është përmendur në Kuranin Famëmadh dhe të cilën jo vetëm që e ka preferuar Muhamedi, por edhe e ka krahasuar me pemët e Xhenetit. Duke përkujtuar këtu, se Allahu i Madhërishëm fjalën e mirë **“La ilahe il-lallah Muhammedu Resulullah”** e tha me pemën e mirë të fikut. Këtë e vërtetojnë shumica e komentuesve. Fjala “e mirë” në të vërtetë është autori i fjalës së mirë, besimtari, i cili është si pema që prodhon fryte vazhdimisht, që është i qëndrueshëm, i fortë, me rrënjët e ngulura thellë në tokë e me degët lart, siç bën aluzion verseti kuranor në vijim: **“A nuk e ke kuptuar se si Allahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë, që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lart, e që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frytin e vet në çdo kohë. Allahu, pra u parashtron njerëzve shembuj, ashtu që ata të mendojnë.”** (Ibrahim, 24-25). ■

# PËRHAPNI HARENË DHE LAJMET E MIRA

Të gjithë ankohen, gjëmojnë dhe murmurojnë sikur jeta është bërë pa të mira, pa gëzime dhe pa rehati, deri në atë shkallë, sa edhe dasmat janë bërë vend ku shpalosen humbjet, thyerjet dhe pakënaqësitë, bile edhe këngët që këndohen në raste gëzimesh kanë filluar të përmbajnë tekste pikëllimi dhe dëshpërimi.

## ABDULKERIM BEKKAR

**N**uk kemi qenë kurrë më në nevojë për t'u ngazëllyer dhe për lajme të mira, sesa gjatë këtyre ditëve, ngaqë takimet tona gëlojnë nga kritikak ndaj çdo gjëje, me ose pa dije. Jemi bërë të sofistikuar për të lënduar veten deri në ekstrem, edhe pse te njerëzit ka akoma hair shumë më të madh, se ç'kanë pasur baballarët dhe gjyshërit e tyre. Të gjithë ankohen, gjëmojnë dhe murmurojnë sikur jeta është bërë pa të mira, pa gëzime dhe pa rehati, deri në atë shkallë, sa edhe dasmat janë bërë vend ku shpalosen humbjet, thyerjet dhe pakënaqësitë, bile edhe këngët që këndohen në raste gëzimesh kanë filluar të përmbajnë tekste pikëllimi dhe dëshpërimi. Kërkoj nga, ju o bijtë dhe

bijat e mia, që të kujtoni thëniet që flasin për mëshirën e Allahut ndaj krijesave të Tij, ato që shfaqin madhësitinë e begatisë së besimit dhe që përshkruajnë qartë shpërblimet e mëdha, që ka përgatitur Allahu për robërit e Tij të singertë. Kujtoni gjithashtu edhe transmetimet e sakta, që porosisin për prirje dhe anim nga butësia, lehtësia dhe largimi i vështirësive, që me këto të mposhtni ndjenjat e dëshpërimit, të frikës dhe të pikëllimit. Prej këtyre thënieve mund të përmendim kalimthi këto:

*“Vërtet Allahu është i kënaqur për këtë umet me lehtësinë dhe urren vështirësinë.”* (Taberaniu)

*“Allahu nuk më dërgoi si shqetësues e as si kryeneç, mirëpo më dërgoi si mësues dhe lehtësues.”* (Muslimi)

*“Zoti juaj është i turpshëm dhe bujar,*

*turpërohet nëse robi i ngre duart për t'iu lutur e t'ia kthejë bosh.” (Ebu Davudi)*

*“Allahu e do butësinë në të gjitha çështjet.” (Buhariu)*

*“Lehtësoni e mos vështirësoni dhe përgëzoni e mos tmerroni.” (Ahmedi)*

*“Përgëzojeni këtë umet me lavdinë, fetarinë, dinjitetin, suksesin dhe triumfin në tokë.” (Buhariu dhe Muslimi)*

Begatia e besimit dhe e udhëzimit - që është rruga drejt suksesit të lumturisë së përhershme - na nxit që ta ndiejmë gjithnjë veten mirë dhe të presim nderimin dhe shpërblimin e Allahut të Madhërishëm. Kam përshtypjen se disa thënie synojnë ta thyejnë monotoninë e bashkëjetesës me këtë mirësi, e cila arrin deri në atë shkallë, sa që në shpirtat tanë nuk ngacmon ndjenjën e falënderimit dhe mirënjohjes ndaj Allahut.

*“Allahun e mrekullon bariu i deleve rrëzë majës së malit, kur thërret ezanin dhe fal namazin, pastaj Allahu thotë: **“Shikojeni robin tim, thërret ezanin dhe fal namazin dhe më ka frikën Mua. Ia kam falur mëkatet robin Tim dhe do ta fus në xhenet.”** (Ebu Davudi)*

Nëse nuk i sjellim ndër mend këto tekste dhe kuptime për të krahasuar gjendjen tonë me gjendjen e popujve të tjerë në rrafshin e prodhimit, teknikës, administratës dhe organizimit, rezultati përfundimtar është ajo që vërejmë sot: ankime dhe gjëmime ndaj çdo gjëje. Këto përmbajnë një lloj mohimi për atë me të cilën na ka begatuar Allahu, si imani dhe bindja, nga të cilat janë privuar shumë popuj. Nuk arrij të kuptoj çfarë fitojnë ata që humbasin besimin dhe shpërfillin Krijuesin e tyre dhe i harrojnë objektivat për të cilat ekzistojnë!

**Çfarë do të thotë kjo për bijtë dhe bijat e mia?**

1- Mësohuni të fusni gëzim dhe rehati në zemrat e të gjithë atyre që kanë kontakt

## “Mundohuni që njerëzit përreth jush të ndiejnë se jeta është e bukur, kur qëndrojnë afër jush...”

me ju. Mundohuni që njerëzit përreth jush të ndiejnë se jeta është e bukur, kur qëndrojnë afër jush, por për ta arritur këtë punoni në mënyrë të zgjuara, duke përdorur fjalë të ëmbla dhe lajka të sinqerta dhe duke zbuluar specifikat e kolegëve dhe miqve tuaj. Urojini për sukseset që kanë arritur dhe festoni së bashku me ta.

2- Kur njerëzit flasin për humbjet, kujtojeni fitimet; kur flasin për disfata, flisni për fitoret; nëse flasin për rrugët pa shtegdalje, silluani ndërmend rrugët e hapura. Orvatuni gjithmonë, që të shihni anën e ndritshme të gjërave dhe shihni gjysmën e mbushur të gotës e jo të kundërtën.

3- Përfitoni nga pafajësia e fëmijëve. Mësoni prej tyre gëzimin, i cili e përfshin shpirtin e tyre, kur fitojnë një ëmbëlsirë ose rrobë të re.

4- Kënaquni me atë që keni para vetes dhe falënderojeni Allahun për to. Mos u merrni me gjërat që Allahu ua ka dhuruar të tjerëve e të pini helmin e xhelozisë dhe urrejtjes, duke mohuar begatitë e Allahut.

5- Përdorni fjalë të mira, të buta dhe shpresëdhënëse, kur shprehni ndjenjat, gjendjen dhe punët tuaja. Fjalët e zgjedhura kanë ndikim të madh në shpirtin e atij që i flet dhe i dëgjon. Shpesh toni lavdërimin e Allahut, sepse Ai e meriton për të gjitha favorët që na ka dhuruar, pasi është Dhuruesi i të gjitha dhuntive dhe Pronari i çdo të mire. ■

*Nga arabishtja: Agron TERZIQI*



# MISHI I BËN MUSLIMANËT AGRESIVË?!

PËRGJIGJE NGA: DR. ZAKIR NAIK

**Pyetja 1: Vrasja e kafshës është një akt dhe vepër e pamëshirshme. Atëherë përse muslimanët konsumojnë ushqim jo-vegjetativ?**

**Përgjigje:** ‘Vegetarianizmi’ tashmë është një lëvizje e njohur në botë. Madje ka shumë prej atyre që këtë lëvizje e ndër-lidhin me të drejtat e kafshëve. Ç’është e vërteta një numër i madh i njerëzve konsumimin e mishit dhe të produkteve të tjera jo-vegjetative e konsiderojnë si shkelje të të drejtave të kafshëve. Feja Islame urdhëron falje dhe mëshirë për të gjitha krijesat e gjalla. Në të njëjtën kohë Islami është ai që mbron faktin, se Allahu e ka krijuar tokën si dhe mrekullitë e saj; florën dhe faunën, për t’i sjellë dobi mbarë njerëzimit. Njerëzimi duhet t’i shfrytëzojë me maturi të gjitha resurset në këtë botë, si begati hyjnore dhe amanet nga Allahu. Le të shikojmë në disa aspekte të tjera të këtij argumenti.

**1. Muslimani mund të jetë vegetarian i pastër**

Muslimani pavarësisht nga të qenit vegetarian i pastër mund të jetë një musliman i mirë. Nuk është e domosdoshme për një musliman që të ushqehet me



Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.  
Pyetjet mund t'i dërgoni në [albislam@gmail.com](mailto:albislam@gmail.com)



ushqime jo-vegjetative.

## 2. Kurani u lejon muslimanëve që të ushqehen me ushqime jo-vegjetariane

Sidoqoftë Kurani e lejon muslimanin, që të ushqehet me ushqime jo-vegjetative. Vargjet kuranore në vijim janë argument ndaj këtij realiteti:

*“O besimtarë! Plotësoni detyrimet! Ju është lejuar ngrënia e kafshëve, përveç atyre që do t’ju njoftohen. Kur jeni në Ihram gjatë haxhit, nuk ju lejohet gjuetia. Me të vërtetë, Allahu vendos çfarë të dëshirojë.”<sup>1</sup>*

*“Ai i ka krijuar kafshët për ju. Nëpërmjet tyre ju siguroni rroba të ngrohta dhe dobi të tjera. Dhe prej tyre ju ushqeheni.”<sup>2</sup>*

*“Vërtet, edhe te bagëtitë për ju ka shenja (për të medituar): ju pini atë që gjendet në barkun e tyre, hani mishin e tyre dhe nxirrni shumë dobi të tjera.”<sup>3</sup>*

## 3. Mishi është ushqyes dhe i pasur me proteina

Ushqimi jo-vegjetativ është një burim i shkëlqyeshëm proteinash. Biologjikisht ai përmban proteina të plota, d.m.th. tetë aminoacidet thelbësore, të cilat nuk janë të sintetizuara nga trupi dhe si të tillë duhet të bëjnë pjesë në dietë. Mishi gjithashtu përmban hekur, vitaminën B1 dhe niacin.

## 4. Njerëzit zotërojnë dhëmbë që hanë gjithçka

Nëse i vrojtoni dhëmbët e kafshëve barngrënëse (*herbivorous animals*), si fjala vjen, lopa, dhia dhe delja do të gjeni diçka të ngjashme dhe të habitshme tek të gjitha ato. Të gjitha këto kafshë zotërojnë një grup dhëmbësh, të cilët janë të rrafshët, me fjalë të tjera, këta dhëmbë janë të përshtatshëm për ushqime bimore.

Nëse i studioni dhëmbët e kafshëve mishngrënëse (*carnivorous animals*), si luani, tigri, leopardi, të gjithë këta zotërojnë një grup dhëmbësh të mprehtë, të përshtatshëm për të përthypur mish. Nëse analizoni grupin e dhëmbëve të njerëzve do të vëreni se ata kanë dhëmbë të rrafshët dhe në të njëjtën kohë edhe të mprehtë. Si rrjedhojë, ata zotërojnë dhëmbë, të cilët përshtaten për të dy llojet e ushqimeve barishtoret dhe mishin e që quhen “omnivorous”, dhëmbë që përthypin gjithçka.

Dikush mund të parashtrojë pyetjen, nëse Allahu i Madhërisëm ka dashur që njerëzit të ushqehen vetëm me perime, atëherë përse na pajisi me dhëmbë të mprehtë? Është më se e logjikshme, që Allahu ka planifikuar, që ne mund të ushqehemi dhe të kemi nevojë për të dy llojet e ushqimeve, vegjetative dhe jo-vegjetative.

## 5. Qeniet njerëzore mund të tretin ushqimet vegjetative dhe jo-vegjetative

Sistemi tretës i kafshëve barngrënëse mund të tretë vetëm barishtoret. Sistemi tretës i kafshëve mishngrënëse mund të tretë vetëm mishin. Mirëpo për sa i përket sistemit tretës të qenieve njerëzore, ai ka mundësi dhe fuqi të hajë dhe të tretë të dyja ushqimet, vegjetative dhe jo-vegjetative.

## 6. Edhe bimët madje kanë jetë

Disa religjione e kanë pranuar dhe miratuar sistemin vegjetativ, si një normë të dietës për faktin se ata janë krejtësisht kundër vrasjes së gjallesave. Po qe se një person mund të mbijetonte pa mbytur asnjë gjallesë, atëherë unë do të isha personi i parë që do të miratoja një mënyrë

<sup>1</sup>Maide, 1.

<sup>2</sup>Nahl, 5.

<sup>3</sup>Muminun, 21.

të tillë jetese. Në të kaluarën njerëzit mendonin se bimët nuk kanë jetë, me fjalë të tjera, ato janë qenie të pajetë. Sot, është fakt mbarëbotëror, se edhe bimët kanë jetën e tyre. Prandaj logjika e tyre për të mos mbytur gjallesa nuk mund të realizohet e as të përmbushet madje edhe duke qenë vegjetarian i pastër.

### 7. Edhe bimët ndiejnë dhimbje

Ata argumentojnë se bimët nuk mund të ndiejnë dhimbje, kështu që të vrasësh një bimë krimi është më i vogël në krahasim me vrasjen e një kafshe.

Sot shkencë na tregon se madje edhe bimët ndiejnë dhimbje. Mirëpo të qarët e bimëve nuk mund të dëgjohet nga qeniet njerëzore. Kjo ndodh për shkak të pamundësisë së veshit njerëzor për të dëgjuar zëra të cilët nuk janë në nivelin e zërave të dëgjueshëm d.m.th. 20 Herc-20.000 Herc.

Çdo gjë që është më poshtë dhe mbi këtë nivel nuk mund të dëgjohet nga krijesa e quajtur njeri. Një qen mund të dëgjojë deri në 40,000 Herc. Prandaj ekzistojnë fishkëllima të qenve të heshtur, të cilët kanë frekuencë prej më shumë se 20.000 Herc dhe më pak se 40.000 Herc. Fishkëllima të tilla mund të dëgjoen vetëm nga qentë dhe kurrsesi nga qeniet njerëzore. Qeni është në gjendje të njohë fishkëllimën e pronarit dhe menjëherë shkon tek ai. Në SHBA, një fermer kishte bërë një hulumtim, i cili kishte zbuluar një instrument, përmes të cilit konvertonte të qarët e bimëve në mënyrë që të dëgjohej nga qeniet njerëzore. Ai ishte në gjendje që të kuptojë menjëherë kur bimët qanin për ujë. Hulumtimet e fundit tregojnë, se bimët mund të ndihen të lumtura dhe të

pikëlluara, ato gjithashtu edhe qajnë.

### 8. Mbytja e një krijese/gjallese me dy shqisa më pak nuk është krim më i vogël

Një vegjetarian argumentonte mendimin e tij duke thënë se bimët zotërojnë vetëm dy ose tri shqisa, ndërsa kafshët kanë pesë shqisa. Kështu që të mbytësh një bimë është një krim më i vogël, sesa të vrasësh një kafshë. Le të supozojmë, se vëllai juaj ka lindur shurdhmemec, me fjalë të tjera, ai ka dy shqisa më pak, krahasuar me krijesat e tjera njerëzore. Pasi ai të ketë arritur moshën e pjekurisë dikush e vret atë. A do të kërkonit nga gjykatësi që vrasësit t'i japë dënim më të vogël për shkak se vëllai juaj kishte dy shqisa më pak? Në fakt, ju do të thoshit se ai ka vrarë një person të pafajshëm dhe si rrjedhojë gjykatësi domosdo duhet t'i jepte vrasësit një dënim edhe më të madh.

Në Kuranin Famëlartë thuhet: *“O njerëz! Ushqehuni me të gjitha gjërat e lejuara e të mira që gjenden në Tokë dhe mos ndiqni gjurmët e djallit, sepse ai është armiku juaj i hapur.”*<sup>4</sup>

### 11. Stërshumimi i bagëtisë

Sikur çdo qenie njerëzore të ishte vegjetariane kjo do të çonte në shumimin e tepruar të bagëtisë në botë pasi riprodhimi dhe shtimi i tyre është shumë i shpejtë. Allahu i Madhërishtëm me urtësinë e Tij hyjnore është i Dijshëm, se si duhet të mbajë ekuilibrin e krijesave të Tij në mënyrën e duhur. Nuk është çudi, se pse Ai na ka lejuar neve të ushqehemi me mishin e bagëtisë.

### 12. Kostoja e mishit është e arsyeshme pasi jo të gjithë janë jo-vegjetarianë

Unë nuk kam ndonjë kundërshtim nëse

<sup>4</sup> Bekare, 168.

disa njerëz janë vegjetarianë të pastër. Megjithatë ata nuk duhet t'i bojkotojnë jo-vegjetarianët si të pamëshirshëm. Në fakt, nëse të gjithë indianët bëhen jo-vegjetarianë, atëherë jo-vegjetarianët aktualë do të humbasin shumë pasi çmimet e mishit do të rriteshin.

**Pyetja 2: Shkenca na mëson se me çfarëdo gjëje që të ushqehet njeriu ajo do të ketë ndikim në sjelljet e tij. Atëherë përse Islami i lejon muslimanët që të konsumojnë ushqim jo-vegjetativ pasi ngrënia e kafshëve mund ta bëjë njeriun agresiv, mizor dhe të egër?**

**Përgjigje:**

1. Vetëm kafshët barngrënëse janë të lejuara për t'u ngrënë.

Pajtohem me atë se çfarëdo ushqimi që konsumon njeriu ajo ka efekt në sjelljet e tij. Kjo është njëra prej arsyeve që Islami e ndalon ngrënien e kafshëve mishngrënëse, siç janë: luani, tigri, leopardi, etj., kafshë të cilat janë të egra dhe mizore. Konsumimi i mishit të këtyre kafshëve mesa duket mund ta bëjë njeriun të rebeluar dhe agresiv. Feja islame lejon vetëm të ngrënit e kafshëve barngrënëse, si: lopa, dhia, delja, etj. Këto kafshë janë të urta dhe të qeta. Muslimanët ushqehen me mishin e kafshëve të buta dhe të qeta për arsye se muslimanët janë paqedashës dhe njerëz kundër dhunës dhe terrorit.

2. Kurani thotë se Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem*, e ndalon atë që është e dëmshme

Lavdiploti në Kuranin Famëlartë thotë: **“...Ai do t'i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t'i ndalojë nga të këqijat; do t'ua lejojë të mirat e do t'ua ndalojë të këqijat, duke i liruar nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur.”**

**“Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë**

**prej saj.”**

Për muslimanin, thënia e Muhamedit, alejhi salatu ue selam, është e mjaftueshme për ta bindur atë se Allahu xh.sh., nuk dëshiron që qeniet njerëzore të hanë disa lloje mishi, ndërkohë që atyre u lejon disa lloje të tjera.

3. Hadithi i Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e ndalon që të ushqehemi me mishin e kafshëve mishngrënëse

Bazuar në shumë hadithe autentike të transmetuara në Sahihun e Buhariut dhe të Muslimit duke përfshirë këtu edhe hadithin, të cilin e transmeton i biri i Abasit në Sahihun e Muslimit, kapitulli i gjuetisë dhe therjes, hadithi nr. 4752 dhe Suneni i Ibni Maxhes, kapitulli 13, hadithi nr. 3232 dhe 3234.

Muhamedi alejhi selam e ka ndaluar të ngrënit e këtyre llojeve:

a. Kafshët e egra, të cilat kanë dhëmbë shqyes, fjala vjen mishi i kafshëve mishngrënëse. Këto kafshë i takojnë familjes së maceve, siç janë: luani, tigri, macet, qentë, ujçit, hienat.

b. Disa kafshë të fëlliqura të cilat sjellin sëmundje, si minjtë dhe lepujt me kthetra (me thonj të mëdhenj).

c. Disa zvarranikë, si gjarpërinjtë, krokodilët, etj.

d. Zogjtë grabitqarë me kthetra, si për shembull, huti, shqiponja, sorrat, qukapiku, etj.

Si rrjedhojë, deri më tani nuk kemi hasur në ndonjë të dhënë shkencore e cila argumenton se të ushqyerit me mish (ushqime jo-vegjetative) mund të shkaktojë agresivitet te njeriu.

Burimi: ANSWERS TO NON-MUSLIMS' COMMON QUESTIONS ABOUT ISLAM (Spreading the Truth of Islam) ■

**nga gjuha angleze: Mr. Feim DRAGUSHA**